



INDEKSI I REFORMËS SË SISTEMIT GJYQËSOR

PËR

KOSOVË

Tetor 2004

© American Bar Association

VËLLIMI II

Përfundimet dhe analizat e paraqitura në këtë material janë rezultat i punës së Shoqatës së Avokatëve Amerikanë dhe Iniciativës Ligjore për Europën Qëndrore dhe Euro-Azinë (ABA/CEELI), e cila është e vetmja përgjegjëse për përmbajtjen e këtij materiali. Bordi i Drejtuesve të Shoqatës së Avokatëve Amerikanë nuk e ka shqyrtuar dhe as miratuar përmbajtjen e tij. Gjithashtu, pikëpamjet e shprehura në këtë material nuk duhet të kuptohen se përfaqësojnë politikën e Shoqatës së Avokatëve Amerikanë (ABA). Për më tepër, asgjë në këtë raport nuk duhet të konsiderohet se përbën këshilla juridike për raste të veçanta dhe lexuesit duhet të marrin këshilla të tilla nga avokatët e tyre. Ky botim u mundësua me ndihmën dhe mbështetjen e dhënë nga Misioni në Kosovë i Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar, sipas kushteve të Marrëveshjes së Asociimit për Bashkëpunim Nr. 167-A-00-04-00103-00 dhe Marrëveshjes Kryesore të Bashkëpunimit Nr. ENI-A-00-00-00003-00. Mendimet e shprehura këtu janë të autorit (autorëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

ISBN: 1-59031-508-1

Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Copyright © 2004 nga

Shoqata e Avokatëve Amerikanë dhe Iniciativa Ligjore për Europën Qëndrore dhe Euro-Azinë
American Bar Association and Central European and Eurasian Law Initiative

740 15th Street, NW, Washington, DC 20005

PËRMBAJTA

| | |
|------------|---|
| Hyrje..... | i |
|------------|---|

Historia e Shkurtër e Zhvillimeve në Kosovë

| | |
|--------------------------------------|---|
| Konteksti Juridik..... | 1 |
| Historia e Gjyqësisë..... | 3 |
| Organizimi i Gjykatave..... | 3 |
| Kushtet e Shërbimit në Gjyqësi | 4 |
| <i>Kualifikimet</i> | 4 |
| Emërimi dhe Mandatet | 5 |
| <i>Trajnimi</i> | 5 |

Indeksi i Reformës së Sistemit Gjyqësor (IRSGJ) Analiza 2004

| | |
|---|---|
| Tabela e Korrelacioneve Midis Faktorëve | 7 |
|---|---|

| | |
|--|-----------|
| I. Kualiteti, Arsimimi, dhe Diversiteti | 8 |
| 1. Kualifikimi dhe Përgatitja e Gjyqtarëve..... | 8 |
| 2. Procesi i Përzgjedhjes/Emërimi..... | 10 |
| 3. Arsmimi i Vazhdueshëm Ligjor..... | 12 |
| 4. Përfaqësimi Gjinator dhe i Pakicave | 14 |
| II. Pushteti Gjyqësor | 16 |
| 5. Shqyrtimi Gjyqësor i Legjislacionit..... | 17 |
| 6. Mbikqyrja Gjyqësore e Veprimtarisë Administrative | 17 |
| 7. Juridiksioni Gjyqësor ndaj Lirive Qytetare | 19 |
| 8. Sistemi i Vendorsjes sipas Ankesës..... | 21 |
| 9. Mospërfilljet/Thirrjet/Ekzekutimet | 23 |
| III. Burimet Financiare | 26 |
| 10. Të Hyrat Buxhetore | 26 |
| 11. Mjaftueshmëria e Pagave të Gjyqësorit | 28 |
| 12. Ndërtesat (Objektet) e Gjykatave | 29 |
| 13. Siguria e Gjyqësorit | 30 |
| IV. Masat Mbrojtëse Strukturale | 32 |
| 14. Mandati i Garantuar | 32 |
| 15. Kriteret Objektive për Avansim në Gjyqësi | 33 |
| 16. Imuniteti i Gjyqtarëve për Veprimet në Kapacitet Zyrtar | 34 |
| 17. Shkarkimi nga Detyra dhe Masat Disiplinore ndaj Gjyqtarëve | 34 |
| 18. Caktimi i Lëndëve | 37 |
| 19. Shoqatat e Gjyqtarëve..... | 39 |

| | | |
|------------|--|----|
| V. | Përgjegjshmëria dhe Transparenca | 40 |
| 20. | Vendimet Gjyqësore dhe Ndikimet Jokorrekte | 40 |
| 21. | Kodi i Etikës | 41 |
| 22. | Procesi i paraqitjes së Ankesës ndaj Sjelljeve të Organeve Gjyqësore | 42 |
| 23. | Qasja e Publikut dhe e Mediave në Procedurë | 43 |
| 24. | Publikimi i Vendimeve Gjyqësore | 44 |
| 25. | Mirëmbajtja e Procesverbalit Gjyqësor | 45 |
| VI. | Efikasiteti | 46 |
| 26. | Personeli Ndhmës i Gjykatave..... | 46 |
| 27. | Postet Gjyqësore | 49 |
| 28. | Sistemet e Regjistrimit dhe Përcjelljes së Lëndëve..... | 51 |
| 29. | Kompjuterët dhe Pajisjet për Zyrë | 52 |
| 30. | Shpërndarja dhe Rradhitja e Llegjislacionit Aktual | 53 |

Hyrje

Indeksi i Reformës së Sistemit Gjyqësor (IRSGJ) është një instrument i përgatitur nga Shoqata e Avokatëve Amerikane /Iniciativa Ligjore për Europën Qëndrore dhe Euro-Azinë. Synimi i këtij Indeksi është vlerësimi i faktorëve kyç për reformën e sistemit gjyqësor në demokracitë e sapolindura. Në një kohë kur përpjekjet për reformën ligjore dhe gjyqësore janë në qendër të vëmendjes më shumë se kurrë, IRSGJ përbën një mekanizëm të përshtatshëm dhe të rëndësishëm vlerësimi. IRSGJ do t'i jap mundësi ABA/CEELI-t, financuesve të saj dhe vetë demokracive të sapolindura, për të synuar programe më të mira të reformës gjyqësore dhe për të ndjekur nga afër progresin drejt formimit të një sistemi gjyqësor të përgjegjshëm, efektiv dhe të pavarur.

ABA/CEELI i hyri këtij projekti me mendimin që nuk ka një kuptim të njëjtë për gjithë veçoritë që bashkëveprojnë e ndërthuren në reformën e sistemit gjyqësor. Veçanërisht, ABA/CEELI ka parasysh ndryshimet që ekzistojnë në kulturat juridike që, në një kontekst të veçantë, mund t'i shohin disa çështje si më shumë ose më pak të rëndësishme. Megjithatë, pas një dekade pune në vendet e Europës Lindore dhe Qendrore, ABA/CEELI ka arritur në përfundim që secili nga tridhjetë faktorët e shqyrtuar këtu mund të ketë një ndikim të ndjeshëm në procesin e reformës së sistemit gjyqësor. Kështu, shqyrtimi i këtyre faktorëve krijon një bazë mbi të cilën mund të strukturohet programimi i asistencës teknike dhe të vlerësohen elementet e rëndësishme të procesit të reformës.

Natyra teknike e IRSGJ e dallon këtë lloj mjeti vlerësimi nga vlerësime të tjera të pavarura të një natyre të ngjashme, të tilla si *Raporti për të Drejtat e Njeriut* i Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara dhe *Kombet në Tranzicion* nga Freedom House. Ky vlerësim nuk jep një komentari përshkruar të gjendjes së sistemit gjyqësor në një vend. Përkundrazi, vlerësimi identifikon kushtet specifike, dispozitat ligjore dhe mekanizmat që janë të pranishëm në sistemin gjyqësor të një vendi dhe vlerëson, se në ç'masë këto lidhen me kritere specifike të reformës, në periudhën e vlerësimit. Veç kësaj, ky proces analitik nuk është një vëzhgim shkencor statistikor. IRSGJ është së pari dhe kryesisht një studim ligjor, që rezulton në informacion që përshkruan sistemin gjyqësor të një vendi.

Vlerësimi i Përpjekjeve për Reformë

Vlerësimi i progresit të një vendi drejt reformës së sistemit gjyqësor është plot sfida. Asnjë kriter nuk mund të shërbejë si talisman dhe shumë faktorë të vlerësuar përgjithësisht është e vështirë të maten. Për shembull, koncepti kyç i një sistemi gjyqësor të pavarur në thelb priret drejt anës cilësore dhe nuk mund të matet thjeshtë me numrin e gjyqtarëve ose gjykatave në një vend. Është e vështirë të gjesh dhe interpretosh "provën e paanësisë, mosndikimin, dhe fushën e veprimit të një autoriteti gjyqësor si institucion." Larkins, *Judicial Independence and Democratization (Pavarësia e Sistemit Gjyqësor dhe Demokratizimi): A Theoretical and Conceptual Analysis (Një Analizë Teorike dhe Konceptuale)*, 44 AM. J. COMP. L. 611 (1996). Larkins citon gabimet e mëposhtme në përpjekjet e mëparëshme për të matur pavarësinë e sistemit gjyqësor:

(1) bazimi në treguesit formal të pavarësisë së sistemit gjyqësor, të cilat nuk përputhen me realitetin, (2) mungesa e informacionit të duhur në gjykatat i cili është i zakonshëm në studimet gjyqësore krahasuese, (3) vështirësitë e natyrshme për të interpretuar kuptimin e konkluzioneve gjyqësore, ose (4) natyra arbitrare e vlerësimit numerik të disa attributeve të pavarësisë së sistemit gjyqësor.

Id. at 615.

Larkins kritikon veçanërisht një studim të vitit 1975 nga David S. Clark, i cili kërkonte të maste numerikisht autonominë e Gjykatave Supreme në Amerikën Latine. Në përgatitjen e sistemit të tij të “pikëve të efektivitetit të sistemit gjyqësor”, Clark përfshinte tregues të tillë si garancitë e mbajtjes së detyrës, metodën e largimit nga detyra, metodën e emërimit, dhe garancat e pagës. Clark, *Judicial Protection of the Constitution in Latin America (Mbrojtja Gjyqësore e Kushtetutës në Amerikën Latine)*, 2 HASTINGS CONST. L. Q. 405 – 442 (1975).

Problemi, megjithatë, qëndron në faktin se këta tregues formal të pavarësisë së sistemit gjyqësor shpesh nuk përputheshin me realitetin. Për shembull, megjithëse gjykatësit e Gjykatës Supreme të Argjentinës i kishin garancitë e mbajtjes së detyrës, Gjykata Supreme që nga 1940-a ishte spastruar të paktën pesë herë. Në bazë të këtyre faktorëve, Clark mbivlerësonte...pavarësinë e gjykatave të disa vendeve, duke vendosur gjykata të tilla të varura si ajo e Brazilit para asaj të Kosta Rikas, vend që është parë pothuajse universalisht si vend me sistem gjyqësor më të pavarur në Amerikën Latine.

Larkins, *supra*, at 615.

Bazimi në kriteret subjektive në vend të kriterëve objektive, mund gjithashtu të bëhet objekt kritike. Për shembull, Larkins, *supra*, at 618 (kritikonte metodologjinë e sondazhit të 84 shkencëtarëve sociologë lidhur me gjykatat në Amerikën Latine si pak më shumë se thashetheme). Për më tepër, nuk mund të përfitohet informacion i besueshëm duke intervistuar gjyqtarët: “[gj]yqtarët nuk mund të pranojnë që ata arrijnë në një përfundim të caktuar sepse janë vënë nën presionin e një personi të caktuar; përkundrazi, ata janë të prirur të fshehin mungesën e autonomisë së tyre.” Larkins, *supra*, at 616.

Metodologjia e ABA/CEELI-t

ABA/CEELI është përpjekur t’iu shmanget këtyre problemeve dhe vështirësive duke iu përmbajtur si kriterëve subjektive ashtu edhe atyre objektive dhe duke i bazuar këto kriteret në disa norma themelore ndërkombëtare, të tilla si ato të përcaktuara në *Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara në Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor; Rekomandimin e Këshillit të Europës R(94)12 “Për Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve”*; dhe *Këshilli i Europës “Karta Europiane për Statutin për Gjyqtarët.”* Referencë i është bërë gjithashtu një Dokumenti Konceptual për Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor, përgatitur nga ABA/CEELI dhe kriterëve të përdorura nga Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve për vlerësimin e kërkesave për anëtarësim.

Në bazë të këtyre normave, ABA/CEELI përgatiti një seri prej 30 deklarimesh që përcaktojnë faktorët që lehtësojnë zhvillimin e një sistemi gjyqësor të përgjegjshëm, efektiv dhe të pavarur. Për të ndihmuar vlerësuesit në vlerësimin e tyre për këta faktorë, ABA/CEELI përgatiti komentarin korrespondues, duke cituar bazat mbi të cilat u bë deklarimi dhe duke diskutuar rëndësinë e tij. Një përpjekje e veçantë u bë për të shmangur vlerësimin më të madh, ndaj koncepteve amerikane në raport me konceptet europiane lidhur me strukturën dhe funksionin e sistemit gjyqësor. Kështu, u përfshinë disa faktorë, që një gjyqtar amerikan ose evropian mund t’i konsiderojë si të panjohura për të, dhe kjo duhet kuptuar që synimi ka qenë nxënia e më të mirës, të ofruar nga kulturat gjyqësore. Për më tepër, ABA/CEELI shqyrtoi secilin faktor nën dritën e përvojës së saj dhjetë vjeçare dhe arriti në përfundimin që secili faktor mund të ketë ndikim në procesin e reformës së sistemit gjyqësor. Për pasojë, edhe nëse disa faktorë nuk janë pranuar nga të gjithë si elemente bazë, ABA/CEELI e përcaktoi vlerësimin e tyre si të dobishëm dhe të justifikuar në aspektin e programit. Kategoritë e përfshira trajtojnë cilësinë, arsimimin, dhe ndryshimet ndërmjet gjyqtarëve; juridiksionin dhe kompetencat gjyqësore; mbrojtësit financiarë dhe strukturorë; përgjegjshmërinë dhe transparencën; dhe çështje që ndikojnë në efikasitetin e sistemit gjyqësor.

Çështja e përdorimit të një mekanizmi të “poentimit” ishte një nga aspektet më të vështira dhe kontradiktore të këtij projekti, dhe ABA/CEELI mes veti diskutoi nëse duhej përfshirë një mekanizëm i tillë. Gjatë periudhës 1999-2001, ABA/CEELI testoi mekanizma të ndryshëm poentimi. Pas një diskutimi intensiv me anëtarët e Bordeve Ekzekutive dhe Këshilluese të ABA/CEELI-t, si edhe me ekspertë të jashtëm, ABA/CEELI vendosi të braktisë çdo përpjekje për të dhënë një pikësim të përgjithshëm të progresit të reformës së një vendi për të bërë plotësisht të qartë që IRSGJ nuk është menduar të jetë një vlerësim i plotë i një sistemi gjyqësor.

Megjithë këtë konkluzion të përgjithshëm, ABA/CEELI arriti në përfundim që për faktorë të veçantë mund të bëheshin vlerësime cilësore. Kështu, secili faktor, ose deklaram, lidhet me një nga tre vlerat: *pozitive*, *neutrale*, ose *negative*. Keto vlera pasqyrojnë vetëm marrëdhënien e një deklarimi të caktuar me një sistem gjyqësor të një vendi të caktuar. Kur deklarimi përputhet plotësisht me realitetin në një vend të dhënë, vendit i jepet një pikë “pozitive” për atë deklaram. Ndërsa, kur deklarimi nuk përfaqëson aspak kushtet e një vendi të dhënë, atij vendi i jepet një pikë “negative”. Nëse kushtet brenda vendit korrespondojnë në disa aspekte por jo në të tjera, i jepet një pikë “neutrale”. Cf. Cohen, *The Chinese Communist Party and ‘Judicial Independence’ (Partia Komuniste Kineze dhe ‘Pavarësia e Sistemit Gjyqësor’: 1949-59*, 82 HARV. L. REV. 972 (1969), (që sugjeron se shkalla e pavarësisë së sistemit gjyqësor ekziston në një spektër nga “një system gjyqësor plotësisht i lirë në një system gjyqësor që është plotësisht i varur”). Sërish, si theksohet më sipër, ABA/CEELI ka vendosur të mos japë një poentim të përmbledhur, ose të përgjithshëm, sepse në përputhje me kritikën e Larkin, ABA/CEELI arriti në përfundimin që një përpjekje e tillë për të dhënë një pikësim të përgjithshëm do të ishte frenuese.

Përkundrazi, rezultatet e 30 vlerësimeve të veçanta u mblodhën në një format të standardizuar për vlerësimin e IRSGJ të çdo vendi. Pas çdo faktori, jepet lidhja e vlerësuar dhe një përshkrim i bazës për këtë konkluzion. Përpos kësaj, përfshihet një analizë më e thellë, që detajon çështjet e ndryshme të përfshira. Klasifikimi i të dhënave në këtë mënyrë lehtëson përfshirjen e tyre në një database, dhe i lejon përdoruesit të fundit të krahasojë më lehtë ecurinë e vendeve të ndryshme në fusha të caktuara dhe – pas plotësimit të IRSGJ-së me të dhëna të reja–brenda një vendi të caktuar në kohë të ndryshme.

Implementimi i rrethit të dytë dhe vijues i IRSGJ-së do të bëhet për disa qëllime. Së pari, ky do ta ofrojë një raport të azhuruar për sistemet gjyqësore të Evropës Qëndrore dhe Lindore dhe Euroazisë duke nënvizuar zhvillime të rëndësishme ligjore, gjyqësore dhe politike dhe mënyrën se si këto zhvillime ndikojnë në përgjegjshmërinë, efikasitetin dhe pavarësinë gjyqësore. Poashtu ky raport do ta identifikojë masën deri në të cilën kufizimet e paraqitura në vlerësimin e IRSGJ-së të rrethit të parë, janë trajtuar nga autoritetet qeveritare, anëtarët e gjyqësisë dhe të tjerët. Implementimi periodik i procesit të vlerësimit të IRSGJ-së do ti shënojë ato sfera, në të cilat ka pasë ngecje në aspektin e pavarësisë gjyqësore, poashtu edhe përpjekjet e vonuara për reformimin e sistemit gjyqësor, që kanë pasë pak ose fare pak ndikim, si dhe do t'i dallojë ngjarjet e suksesshme dhe përmirësimet në lëminë e reformës së sistemit gjyqësor. Së fundi, me vlerësimin e IRSGJ-së në mënyrë të rregullt, ABA/CEELI do të vazhdoj të shërbejë si burim i informatave aktuale dhe analizave të gjendjes së pavarësisë gjyqësore dhe reformimit në vendet me demokraci të posaçmërisht dhe në tranzicion.

Struktura e përgjithshme e raportimit të rrethit të dytë të IRSGJ-së, si edhe metodologjia do të mbesin të pandryshuara për të mundësuar një analizë të saktë historike dhe krahasim të besueshëm përgjatë kohës. Sidoqoftë, mësimet e mësuara kanë rezultuar në disa ndryshime të hulumtimeve vlerësuese, të cilat janë dizajnuar për të përparuar uniformitetin dhe një mbledhje të detajzuar të të dhënave. Një pjesë e këtij ndryshimi përfshinë zhvillimin e një hulumtimi vlerësues më të strukturuar, që do të udhëzonte grumbullimin dhe raportimin e informatave dhe të dhënave.

Raporti i rrethit të dytë dhe vijes i IRSGJ-së do të vlerësojë të gjithë 30 faktorët. Ky proces përfshinë ekzaminimin e të gjitha ligjeve, akteve normative dhe dispozitave, si dhe burimeve tjera autoritative, të cilat i përkasin organizimit dhe funksionimit të gjyqësorit, dhe prapë do të përdorë

procesin e intervistimit të informatorëve kyç, duke u mbështetur në perspektivat e disa dhjetra ose më shumë gjykatësve, avokatëve, profesorëve të fakultetit juridik, udhëheqësve të OJQ-ve dhe gazetarëve të cilët kanë një ekspertizë dhe pasqyrë për funksionimin e gjyqësisë. Me mbajtjen e vlerësimeve të rrethit të dytë dhe vijues, vëmendje e veçantë do t'ju kushtohet atyre faktorëve të cilët kanë marrë një vlerësim negativ në vlerësimin e parë të IRSGJ-së.

Secilit faktor prapë do t'i caktohen vlerat pozitive, neutrale ose negative të korrelacionit, si pjesë e implementimit të rrethit të dytë dhe vijues të IRSGJ-së. Pos kësaj, raportet për rrethin e dytë dhe të gjithë rrethët vijues, poashtu do të identifikojnë natyrën e ndryshimit në korrelacion ose trend që nga vlerësimi i mëparshëm. Ky trend do të tregohet në Tabelën e Korrelacioneve të Faktorëve që paraqitet si çështje kryesore e raporteve të IRSGJ-së dhe poashtu do të shënohet në katorrin e konkluzionit i cili është format standard i raporteve të IRSGJ-së. Do të përdoren simbolet në vijim: ↑ (trendi lartë, përmirësim), ↓ (l drejtuar poshtë; ngecje), dhe ↔ (pa ndryshim; pak ose fare ndikim).

Shkencëtarët e shkencave shoqërore mund të argumentojnë që disa nga këto kritere kanë mund të përcaktohen më mirë nëpërmjet sondazheve të opinionit publik, ose nëpërmjet intervistave më të gjera me avokatë dhe personelin e gjykatave. I ndjeshëm ndaj kostos së lartë dhe mungesës së kohës së mjaftueshme, ABA/CEELI vendosi t'i strukturojë këto çështje në mënyrë të tillë që atyre të mund t'iu përgjigjeshin me efikasitet një numër gjyqtarësh, avokatësh, gazetarësh dhe vëzhguesish të jashtëm me njohuri të detajuara mbi sistemin gjyqësor të intervistuar vetëm një herë. Përgjithësisht, IRSGJ është menduar të zbatohet shpejt nga një ose më shumë specialistë ligjorë të cilët janë përgjithësisht të njoftuar me vendin dhe rajonin dhe të cilët mbledhin informacion objektiv dhe kryejnë intervistat e nevojshme për të bërë vlerësimin e secilit faktor.

Një nga qëllimet e vlerësimit është të ndihmojë ABA/CEELI-n — dhe financuesit e tij dhe organizatat kolegjiale – të përcaktojnë efikasitetin e programeve të tyre, të reformave të sistemit gjyqësor dhe të ndihmojë në përcaktimin e ndihmës në të ardhmen. Shumë nga çështjet e ngritura (të tilla si pagat e gjyqtarëve dhe ndikimet e parregullta nga jashtë) natyrisht, nuk mund të trajtohen direkt dhe me efektivitet nga ofruesit e jashtëm të asistencës teknike. ABA/CEELI gjithashtu pranon që ato fusha të reformës së sistemit gjyqësor që mund të ndikohen nga të jashtëmit, të tilla si trajnimi gjyqësor, nuk janë më të rëndësishmet. Të kesh gjyqtarët më të zgjedhur dhe të arsimuar në botë, nuk është garanci për të pasur një sistem gjyqësor të përgjegjshëm, efektiv dhe të pavarur; dhe akoma, çdo gjyqtar është e nevojshme të jetë i trajnuar mirë. Për më tepër, lidhja ndërmjet ndihmës së jashtme dhe sistemit gjyqësor të vendit mund të jetë shumë delikate; ndërtimi i një sistemi gjyqësor vërtet kompetent kërkon një vullnet politik real dhe përkushtim nga ana e vendit që reformohet. Gjithashtu, është e rëndësishme të analizohen fusha të rëndësishme me kritere të provuara të padiskutueshme, në mënyrë që përpjekjet e reformës të mund të përqëndrohen më mirë në elementet progresive. ABA/CEELI ofron këtë produkt si një hap konstruktiv në këtë drejtim dhe mirëpret kritika konstruktive.

Mirënjohe

Lisa Dickieson, Drejtor, Programi i Reformës së Gjyqësorit, Shoqata e Avokatëve Amerikanë për Iniciativën Ligjore në Europën Lindore dhe Qendrore (ABA/CEELI) (1995-2000), dhe Mark Dietrich, Anëtar, Avokat i Shtetit të New York dhe Këshilltar i ABA/CEELI-t zhvilluan konceptin original dhe dizanjuan IRSGJ-në. Scott Carlson, Drejtor, Programet e Reformës së Gjyqësorit në ABA/CEELI (2000-2003) drejtoi përfundimin e IRSGJ-së. Ndihmë në kërkimet dhe përmbledhjet e IRSGJ-së u dha nga Jenner Bryce Edelman, Bashkëpunëtorë Programi në ABA/CEELI, dhe James McConkie, Student Praktikant, ABA/CEELI.

Gjatë përgatitjes të IRSGJ-së, ABA/CEELI përfitoi shumë nga dy grupe ekspertësh këshillues. ABA/CEELI do të donte të falenderonte anëtarët e Bordit të Parë Këshillues Gjyqësor të ABA/CEELI-t, duke përfshirë Tony Fisser, Marcel Lemonde, Ernst Markel, Joseph Nadeau, Mary

Noel Pepys dhe Larry Stone, të cilët shqyrtuan variantet e hershme të këtij indeksi. Përpos kësaj, ABA/CEELI do të donte të falenderonte anëtarët e Bordit të Dytë Këshillues Gjyqësor të saj, duke përfshirë Luke Bierman, Macarena Calabrese, Elizabeth Dahl, Elizabeth Lacy, Paul Magnuson, Nicholas Mansfield, Aimee Skrzekut-Torres, Roy T. Stuckey, Robert Utter dhe Russell Wheeler të cilët organizuan përmbledhjen e tij. Së fundi, ABA/CEELI gjithashtu shpreh vlerësimin e saj për ekspertët të cilët kontribuan në Dokumentin Konceptual për Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor të ABA/CEELI-t: James Apple, Dorothy Beasley, Nicholas Georgakopolous, George Katrougalos, Giovanni Longo, Kenneth Lysyk, Roy Schotland, Terry Shupe, Patricia Wald dhe Markus Zimmer.

Ekipi Vlerësues

Ekipi vlerësues i analizës IRSGJ 2004 për Kosovë, u udhëhoq nga Beth C. Miller me mbështetje të konsiderueshme dhe ndihmë nga Jehona Hyseni, Jetish Jashari dhe Aurora Balaj. Ky ekip gjeti mbështetje të madhe nga anëtarët e tjerë të stafit të ABA/CEELI-t në Prishtinë, përfshirë edhe Drejtorin e Zyrës së ABA/CEELI-t në Kosovë, Z. John Porter dhe Juristin Z. Jack Dougherty. Anëtarët e stafit të ABA/CEELI-t në Washington Julie Broome, Melissa Zelikoff dhe Analistja Olga Ruda ishin redaktues dhe përgatitën raportin për publikim. Përfundimet dhe analizat janë bazuar në intervistat e bëra në Kosovë, gjatë Shtatorit të vitit 2004 dhe në dokumentet relevante që janë shqyrtuar në të njejtën kohë. Në arkivat e ABA/CEELI-t ekzistojnë shënimet mbi personat dhe autoritetet e intervistuarat për këtë.

Historia e Shkurtër e Kosovës

Konteksti Juridik

Kosova ka qenë regjion administrativ në kuadër të Jugosllavisë për shumicën e kohës gjatë shekullit të njëzetë, qoftë si pjesë e “Serbisë Jugore” në kuadër të Mbretërisë së Jugosllavisë, gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, ose si krahinë e Serbisë, brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ-së), të krijuar më 1944. Gjatë gjithë kësaj periudhe, regjioni i Kosovës ishte i banuar me shumicë etnike shqiptare. Që nga viti 1989, kur kryetari i Serbisë, Slobodan Millosheviqi e kishte marrë kontrollin mbi “krahinën autonome”, më shumë se 80% të banorëve që ishin shqiptarë etnik, jetonin nën kushtet e ligjeve ushtarake. Në vitet 1997-1998 shpërtheu lufta në Kosovën e kontrolluar nga Serbia, kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK-ja) e filloi luftën politike dhe ushtarake për një Kosovë autonome, gjersa ushtria serbe dhe policia paraushtarake reagan duke u përjekur ta thyejnë lëvizjen separatiste të UÇK-së. Pas një periudhe të konfliktit të ashpër lokal në vitin 1998, dhe periudhave të negociatave ndërkombëtare, në mars të vitit 1999, NATO-ja filloi luftën ajrore kundër Jugosllavisë. Pas luftës 78 ditëshe, forcat jugosllave u tërhoqën nga Kosova.

Që nga ndërprerja e armiqësive të mëdha në qershor të vitit 1999, si protektorat ndërkombëtar i KB-së, Kosova është administruar nga administrata civile ndërkombëtare dhe prania ushtarake në pajtim me autorizimet e dhëna nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (10 qershor 1999) (më tutje në tekst Rezoluta 1244). Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, e udhëheq administratën civile ndërkombëtare – Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Janë tri organizata ndërkombëtare që bashkëpunojnë në udhëheqjen e katër shtyllave të strukturës së UNMIK-ut: Shtylla I “Policia dhe Drejtësi” (KB); Shtylla II “Administratë Civile” (KB); Shtylla III “Demokratizim dhe Ngritje Institucionale” (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Europian (OSBE)); dhe Shtylla IV “Rindërtimi Ekonomik” (Unioni Europian (UE)). UNMIK-u ngarkohet me administrimin e Kosovës gjithnjë në pajtim me Rezolutën 1244 dhe Rregulloren Nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (15 maj 2001) [më tutje në tekst Kornizë Kushtetuese]. UNMIK-u vazhdon të mbajë edhe më tutje, deri në zgjidhjen e statusit të Kosovës, disa kompetenca, siç janë funksionet e policisë, mbrojtjes, punëve të jashtme dhe disa çështje të drejtësisë.

Prania ndërkombëtare e sigurisë, Forcat e NATO-së në Kosovë (KFOR-i), veprojnë nën strukturën unike komanduese të kontrollit ushtarak, veçmas nga UNMIK-u. Mandati i KFOR-it është të arrijë deri te ndërprerja e qëndrueshme e armiqësive, të ofrojë mjedis të sigurtë për të gjithë njerëzit në Kosovë, dhe ta lehtësojë kthimin e sigurtë të personave të zhvendosur dhe refugjatëve. Trupat e KFOR-it dhe personeli i tij ndërkombëtar, nuk i nënshtrohen autoritetit të UNMIK-ut, dhe gëzojnë imunitet ndaj sistemit të drejtësisë kosovare, sikurse edhe personeli i UNMIK-ut.

Ligji në Fuqi i Kosovës, përbëhet nga: rregulloret e UNMIK-ut (përfshirë këtu edhe Kornizën Kushtetuese) dhe aktet nënligjore; ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës; dhe ligjit në fuqi në Kosovë deri më 22 mars 1989 – deri në ditën e fundit kur Kosova e kishte statusin e autonomisë në kuadër të ish-RSFJ-së; ish-ligjet Krahinore të Kosovës; sikurse edhe disa ligje të ish Republikës Socialiste të Serbisë. Ligjet e aplikueshme në Kosovë pas 24 marsit 1989, mund të zbatohen vetëm nëse i rregullojnë çështjet ose situatat që nuk kanë qenë të rregulluara me ligjet e mëparshme dhe nëse të njëjtat nuk janë diskriminuese. Rregulloret dhe aktet nënligjore të UNMIK-ut kanë përparësi zbatimi në raport me ligjet e mëparshme dhe të cilat janë në kundërshtim me to. Përveç kësaj, Korniza Kushtetuese i ka inkuorporuar duke i bërë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë edhe disa instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë këtu Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (së bashku me protokolet e saj); Paktin Ndërkombëtar

për të Drejtat Civile dhe Politike (së bashku me protokolet); Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës; Kartën evropiane për gjuhët regionale ose të pakicave, dhe Konventën kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

UNMIK-u gradualisht i ka bartur shumë prej kompetencave tek organet vendore. Herët në vitin 2001, në pajtim me udhëheqësit politik të vendit, UNMIK-u i kishte formuar njëzet departamente administrative të nivelit qendror, *kuazi* ministritë, të cilat janë udhëhequr bashkarisht nga bashkudhëheqësit vendës dhe ndërkombëtar. Në tetor të vitit 2000, u mbajtën zgjedhjet lokale të cilat kanë rezultuar me krijimin e tridhjetë kuvendeve komunale anekënd Kosovës. Korniza Kushtetuese dhe aktet tjera nënligjore, parashikonin krijimin e Institucioneve të Përkohshme për vetëqeverisje në Kosovë (IPVQ), ku përfshihen, Kuvendi i Kosovës, Kryeministri dhe Kryetari i Kosovës, si dhe nëntë resore ministrore të qeverisë qendrore. Në nëntor të vitit 2001 është zgjedhur Kuvendi me 120 deputetë, ndërsa Qeveria u formua në mars 2002. Pas zgjedhjeve për Kuvend, të vitit 2004, UNMIK-u i kishte bartur përgjegjësitë edhe për tri ministritë më të reja. Grupi punues i UNMIK-ut dhe Qeverisë për Sundim të së Drejtës, në kuadër të Planit për Zbatimin e standardeve për Kosovën është duke e ndihmuar procesin e kalimit të kompetencave nga UNMIK-u tek institucionet e Kosovës.

Pa marrë parasysh dorëzimin e përgjegjësiave tek akterët vendor, PSSP-ja megjithatë ka ruajtur kompetenca të gjëra dhe është autoriteti i fundit legjislativ dhe ekzekutiv me qëllim të sigurimit të zbatimit të plotë të Rezolutës 1244. PSSP-ja i ka ruajtur veçanërisht funksionet ekzekutive në fushën e zbatimit të ligjit dhe në fushën e drejtësisë. Korniza Kushtetuese i ka bartur vetëm disa kompetenca të kufizuara nga fusha e drejtësisë tek IPVQ-të, konkretisht, pjesëmarrjen e tyre në emërimin dhe trajnimin, organizimin e provimeve kualifikuese për gjyqësi, organizim dhe mirëmbajtje të gjykatave, sigurimin e mjeteve materiale për gjyqësorin, si dhe çështjet e punësimit, procedurës disiplinore dhe largimin nga puna të personelit mbështetës të gjykatave. Meqë, nuk ka ministri të drejtësisë në mesin e dymbëdhjetë ministrive kosovare, atëherë detyrat e ministrisë së zakonshme të drejtësisë janë ndarë ndërmjet Shtyllës I të UNMIK-ut – **Departamenti i Drejtësisë (DD)**, i udhëhequr nga ndërkombëtarët, trashëgimtarit të Departamentit të Përbashkët Administrativ të Drejtësisë, dhe **Departamentit për Administratë Gjyqësore (DAGJ)** të Ministrisë së Shërbimeve Publike (MSHP). Përderisa, DAGJ-i e luan rolin ekzekutiv në administrimin e sistemit gjyqësor të vendit, DD-ja mbetet përgjegjëse për politikat strategjike dhe marrjen e vendimeve qenësore ligjore. Mandati i DD-së për ndërtimin e gjyqësië shumetnike, të pavarur, të paanshme dhe kompetente, e bën atë të përgjegjshëm për projektimin dhe drejtimin e një sistemi efikas gjyqësor, integrues për pakicat etnike dhe i cili i heton veprimet e pahijshme gjyqësore. Krahas kësaj, **Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës (KGJPK)**, një organ i pavarur dhe i emëruar nga PSSP-ja, i përbërë prej anëtarëve vendor dhe ndërkombëtar, shërben si organ këshillues për çështjet që kanë të bëjnë me emërimet në gjyqësor, shkarkimet dhe çështjet disiplinore.

UNMIK-u dhe KFOR-i gjithashtu e kanë themeluar Grupin Konsultativ të Ekspertëve në Sektorin e Gjyqësorit (GKESGJ), i cili shërben si "forum konsultativ ndërmjet UNMIK-ut dhe palëve tjera të intersuara, për çështjet e zhvillimit të sektorit gjyqësor të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm pas tërheqjes së bashkësisë ndërkombëtare." *Lexo DETYRAT E PROJEKTIT PËR GRUPIN KONSULTATIV TË EKSPERTËVE TË SEKTORIT*. Anëtarët janë caktuar në "Detyrat e Projektit"(Terms of Reference) dhe përfshijnë shumë organizata vendore dhe ndërkombëtare nga fusha e drejtësisë, siç janë: Oda e Avokatëve të Kosovës, Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës, dhe në mes tjerëve edhe Fakulteti Juridik i Prishtinës. Ky grup takohet rregullisht me qëllim të dhënjes së kontributit për procesin e tranzicionit.

Historia e Gjyqësisë

Kosova e ka të njëjtën traditë juridike sikurse ajo e ish-RSFJ-së, përfshirë këtu edhe ndikimin e fuqishëm të cilin e ka lënë prapa Perandoria e Austro-Hungarisë. Bazuar në Kushtetutën e RSFJ-së të v. 1974, Kosova gëzonte statusin e “krahinës autonome” në kuadër të Republikës Socialiste të Serbisë, dhe si e tillë, gëzonte të drejta sovraane substanciale. Përderisa me Kushtetutën e vitit 1974 të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, ashtu edhe me Kushtetutën e RSFJ-së, Kosova ishte pjesë përbërëse e Republikës Socialiste të Serbisë, shumë njerëz në Kosovë ende e kontestojnë këtë dhe e vëjnë në pikëpyetje legjitimitetin e aneksimit të Kosovës nga RSFJ-ja në vitin 1945.

Si një krahinë autonome në kuadër të RSFJ-së, Kosova e kishte Kuvendin, sistemin gjyqësor, Gjykatën Supreme dhe Gjykatën Kushtetuese. Kosova i kishte të përbashkëta ligjet federative të procedurës penale dhe kontestimore sikurse edhe pjesët tjera të RSFJ-së, por e kishte ligjin e vet penal (të plotësuar me disa dispozita penale nga ligji federativ dhe i Serbisë). Sikurse zakonisht edhe në sistemet tjera socialiste, pushteti ekzekutiv dhe struktura partiake kanë ndikuar në gjyqësi.

Gjatë vitit 1989, autonomia e Kosovës ishte cunuar rëndë, duke ia marrë Serbia kompetencat mbi policinë, gjykatat, mbrojtjen civile, por edhe ato mbi politikën ekonomike, sociale dhe të arsimit. Praktikisht të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët shqiptarë të Kosovës ishin shkarkuar nga detyra. Gjersa disa prej tyre kishin filluar të punojnë si avokatë privat, shumë të tjerë ishin detyruar ta braktisin tërësisht profesionin. Në vitin 1992, pushteti i Serbisë e kishte ndërprerë organizimin e provimit të jurisprudencës¹ në Kosovë, dhe me këtë e kishte kufizuar edhe më tej qasjen e shqiptarëve etnik në profesionin ligjor. Me përpjekjet e UNMIK-ut, OSBE-së dhe disa OJQ-ve ndërkombëtare, provimi i jurisprudencës ka rifilluar të organizohet në Kosovë me 14 dhjetor 2001 dhe organizohet çdo tre muaj.

Menjëherë pas mbarimit të luftës në qershor 1999, objektet ishin të gjysmërrënuara dhe në gjendje të pariparueshme. Shumë prej atyre që kishin shërbyer në gjyqësi gjatë dhjetë viteve të kaluara, tanimë e kishin braktisur krahinën. Atyre profesionistëve të judikaturës që kishin mbetur në Kosovë, ju mungonte përvoja më e re gjyqësore dhe shumë prej tyre nuk kishin punuar në profesion mëse një dekadë. Për më tepër, përvoja nga sistemi i mëparshëm socialist shërbente si një përgatitje e dobët për punën në sistemin e ri demokratik. Shumë pak prej tyre kishin njohuri të drejtpërdrejta mbi standardet ligjore moderne, demokratike dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Organizimi i Gjykatave

Sistemi i gjykatave të rregullta të Kosovës, përbëhet nga njëzet e pesë gjykata komunale, pesë gjykata të qarkut, një gjykatë Ekonomike e Qarkut dhe nga Gjykata Supreme. Sistemi i gjykatave për kundërvajtje përfshin njëzet e pesë gjykata komunale për kundërvajtje dhe Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje që nga tetori 2004, në gjyqësi janë të punësuar 313 gjyqtarë, të shpërndarë në, 14 gjyqtarë në Gjykatën Supreme, pesë gjyqtarë në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje, 46 gjyqtarë në gjykatat e qarkut, 9 gjyqtarë në Gjykatën Ekonomike të Qarkut, 139 gjyqtarë në gjykatat komunale dhe 100 gjyqtarë në gjykatat për kundërvajtje.

Gjykatat Komunale veprojnë në secilën prej komunave të Kosovës dhe shërbejnë si gjykata të shkallës së parë për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim deri në pesë vjet; për kontestet pasurore juridike dhe të punës; çështjet e trashëgimisë dhe çështjet tjera civile juridike.

¹ Provimit të jurisprudencës nganjëherë i referohemi edhe si Provimi i Judikaturës/për avokat etj. Për të qenë konsistent, ky IRSGj do t’i referohet këtij provimi vetëm si “provimi i jurisprudencës”.

Gjykatat e Qarkut, janë të vendosura nëpër secilën nga pesë qytetet më të mëdha regjionale të Kosovës (Prishtinë, Gjiçan, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë), dhe i shqyrtojnë ankesat kundër vendimeve të gjykatave komunale. Gjithashtu shërbejnë si gjykata të shkallës së parë për veprat penale për të cilat parashikohet dënimi me burg për më gjatë se pesë vjet, kontestet e mëdha pasurore juridike, kontestet nga të drejtat e pronës intelektuale dhe çështjet tjera. **Gjykata Ekonomike e Qarkut** në Prishtinë ka kompetencë ekskluzive të shkallës së parë për kontestet ndërmjet dy personave juridik-ekonomik, për procedurën e falimentimit dhe për delikte të caktuara ekonomike.

Gjykata Supreme e Kosovës është gjykata e shkallës më të lartë në Kosovë. Ajo vepron si gjykatë e shkallës së tretë për një numër të caktuar të veprave penale, dëgjon drejtpërdrejt ankesat kundër vendimeve të gjykatave të qarkut, dhe shërben si gjykatë e shkallës së parë për disa çështje të konfliktit administrativ. Në kuadër të Gjykatës Supreme është themeluar Kolegji i Veçantë për Shqyrtimin e Ankesave ndaj vendimeve për privatizim të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). Me Kornizë Kushtetuese parashikohet themelimi i Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme për shqyrtimin e konfliktit ndërmjet ligjeve të miratuara nga Kuvendi dhe Kornizës Kushtetuese, por ende nuk është themeluar. Gjithashtu Gjykata Supreme është përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të njëjtë të ligjit nga të gjitha gjykatat dhe gjykatave më të ulëta mund t'iu japë udhëzime.

Gjykatat për Kundërvajtje janë të vendosura çdo komunë dhe janë kompetente për shqyrtimin e rasteve të dënueshme me gjobë ose me më së gjati 60 ditë burgim. Ankesa kundër vendimeve të gjykatave për kundërvajtje i paraqitet **Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje**, kompetenca e së cilës shtrihet në tërë territorin e Kosovës.

Gjyqtarët Porotë, shërbejnë bashkë me gjyqtarët profesionistë nëpër trupat gjykues me përbërje prej tre ose pesë gjyqtarëve nëpër gjykatat komunale dhe të qarkut. Që nga tetori 2004, janë emëruar 543 gjyqtarë porotë për gjykatat e Kosovës, prej tyre 178 janë angazhuar në gjykatat e qarkut ndërsa 365 në gjykatat komunale. Gjyqtarë porotë do të ketë edhe në Kolegjin Ekonomik të Gjykatës Supreme, por ende nuk janë emëruar. Gjyqtarët porotë nuk kanë përgatitje juridike të veçantë dhe kanë të drejtë të barabartë të votës me gjyqtarët profesionistë.

Gjyqtarët Ndërkombëtarë, i emëron UNMIK-u për të shërbyer nëpër gjykatat e qarkut të Kosovës dhe në Gjykatën Supreme. Që nga tetori 2004, në gjykatat e Kosovës janë angazhuar 15 gjyqtarë ndërkombëtar, përfshirë këtu dy gjyqtarë të angazhuar në Kolegjin e Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështjet e AKM-së. Gjyqtarët ndërkombëtarë punojnë ekskluzivisht në lëndët e ndjeshme penale, kur rrethanat sygjerojnë për rrezikun substancial për gabim gjyqësor, për rastet që kanë të bëjnë me krimet e luftës, ose dhunën ndëretnike ose politike.

Trazirat e dhunshme që ndodhën anekënd Kosovës me 17-18 mars 2004, kanë bërë që të rishfaqen **gjykatat paralele**. Këto gjykata, të udhëhequra nga serbët etnik dhe të përkrahura nga pushteti i Serbisë, vazhdojnë të funksionojnë, pa autorizimin e UNMIK-ut, nëpër enklavat serbe në Kosovë. Për më shumë, disa raste të serbëve të Kosovës dhe me juridiksion të Kosovës, janë dëgjuar në gjykatat në territorin e Serbisë.

Kushtet e Shërbimit

Kualifikimet

Për t'u emëruar si gjyqtar profesionist në Kosovë, kandidati duhet: (1) ta ketë të kryer fakultetin juridik; (2) ta ketë të dhënë provimin e jurisprudencës; (3) të ketë integritet të lartë moral; (4) të mos ketë qenë aktivisht i involvuar në praktikat diskriminuese; dhe (5) të mos ketë qenë i ndjekur penalisht. Për të hyrë në provimin e jurisprudencës kandidati duhet ta ketë kryer fakultetin juridik, ta ketë kryer praktikën një vjeçare në gjykatë, prokurori ose në zyrën e avokatit, ose praktikën dy vjeçare në punët tjera si jurist. Përveç kësaj, kandidatët duhet të kenë përvojë paraprake të

punës profesionale si në vijim: tri vjet për vendin në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje ose gjykatën komunale; shtatë vjet për vendin në gjykatën e qarkut, dhe katër vjet për vendin në Gjykatën ekonomike të qarkut. Kandidatët për gjyqtarë në gjykatat për kundërvajtje, nuk kanë nevojë të kenë përvojë plotësuese ligjore (përveç përvojës së nevojshme për dhënjen e provimit të jurisprudencës). Me ligj nuk përcaktohet veçanërisht përvoja e nevojshme për emërim në Gjykatën Supreme.

Për të shërbyer si gjyqtar porot, personi duhet: (1) t'i ketë së paku njëzet e pesë vjet; (2) të kenë integritet të lartë moral, dhe (3) të mos kenë qenë të ndjekur penalisht. Krahas kësaj, për gjyqtarin porot në lëndët për të mitur, kandidati duhet të ketë kualifikime profesionale ose përvojë për çështjet që kanë të bëjnë me të miturit.

Gjyqtarët ndërkombëtarë duhet: (1) ta kenë të kryer fakultetin juridik; (2) të kenë pesë vite përvojë si gjyqtar profesionist ose si prokuror në vendin e vet; (3) të kenë integritet të lartë moral; dhe (4) të mos kenë qenë të ndjekur penalisht.

Emërimi dhe Mandati

KGJPK-ja e bën rekomandimin për gjyqtarët profesionistë dhe porot, për emërimin e tyre nga PSSP. PSSP-ja e bën emërimin përfundimtar nga lista e kandidatëve të propozuar nga KGJPK-ja dhe e miratuar nga Kuvendi. Emërimet e mëparshme bëheshin për mandat afatshkurtër (tre, gjashtë dhe nëntë muajsh). Në muajin dhjetor 2001, të gjitha emërimet gjyqësore u ishte zgjidhur mandati deri në fund të mandatit të UNMIK-ut në Kosovë. Prandaj, për shkak se mandati i vet UNMIK-ut është i pacaktuar, gjyqtarët e kanë të garantuar mandatin vetëm për kohë të pacaktuar. Gjyqtarët në detyrë mund të shkarkohen nga funksioni vetëm për shkelje disiplinore. Mandati gjyqësor, i nështrohet gjithashtu edhe dispozitave për pensionim, që momentalisht mosha e caktuar për pension është 65 vjet.

Gjyqtarët ndërkombëtarë zgjedhen përmes procesit të rekrutimit të stafit nga UNMIK-u pa ndërhyrjen e KGJPK-së. Ata i emëron PSSP-ja për mandat gjashtë mujor me mundësi të vazhdimit.

Trajnimi

Pas uzurpimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989, shumica, ndoshta të gjithë, shqiptarët etnik, ose e kanë braktisur ose janë dëbuar nga Fakulteti Juridik i Prishtinës. Pas kësaj, ata kanë marrë pjesë në sistemin paralel të arsimit të udhëhequr nga profesorët shqiptarë dhe profesionistët ligjor nëpër shtëpi private. Sistemi i shkollimit ligjor nëpër shtëpi, ishte nën çdo standard dhe gjërisht pranohet se kësaj gjenerate i është ofruar cilësi joadekuate e shkollimit juridik, bazuar në rrethanat e asaj periudhe. Gjersa, tani shqiptarët etnik janë kthyer në Fakultetin Juridik të Prishtinës, serbët e Kosovës (të izoluar kryesisht në rajonet e Kosovës Veriore dhe enklavat e mbrojtura nga KFOR-i) nuk mund t'i vijojnë mësimet në Fakultetin Juridik të Prishtinës për shkak të mungesës së sigurisë, dhe pengesave gjuhësore. Serbët etnikë që dëshirojnë ta fillojnë ose kryejnë Fakultetin Juridik në gjuhën e tyre amtare, e vijojnë Universitetin Serb i cili funksionon në pjesën veriore të Mitrovicës (në të cilin aplikohet planprogrami mësimor i Beogradit), pastaj në universitetin në Beograd, ose ndoshta në një nga ish-republikat e RSFJ-së. Gjersa, mund të thuhet se në Fakultetin Juridik të Prishtinës ka pasur përparime të konsiderueshme nën administrimin e UNMIK-ut, pa dyshim ekziston një pajtueshmëri e përgjithshme se nevojiten reforma plotësuese.

Që nga shtatori 1999, Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK), një organizatë e administruar nga OSBE-ja dhe e financuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, si dhe nga Këshilli i Europës, bashkë me ABA/CEELI-n dhe partnerët tjerë, ka ofruar shumë programe trajnuese për gjyqtarë. Këto trajnime kanë mbuluar tema të ndryshme që nga e drejta penale, e deri te procedura për ekzekutimin e aktgjyqimeve, pastaj, etikën gjyqësore, Standardet Ndërkombëtare për të Drejtat e

Njeriut etj. Edhepse, këto seminare përgjithësisht janë të çmuara dhe përcillen mirë nga gjyqtarët, prapë këto seminare nuk janë të obligueshme për gjyqtarët në detyrë. Megjithatë, IGJK mban kurse obligative dhe njoftuese për gjyqtarët e rinj të emëruar dhe për gjyqtarë ndërkombëtar.

Tani në proces të shqyrtimit nga Kuvendi, gjendet projektligji i cili do t'i ndryshojë këto kushte dhe do ta përcaktojë programin obligativ për trajnimin para emërimit që do të mbahet në IGJK. Sipas këtij projektligji, kandidatët e interesuar të punojnë si gjyqtarë, së pari duhet ta kalojnë provimin e jurisprudencës dhe pas kësaj duhet të aplikojnë pranë IGJK-së për programin trajnues, duke iu nështruar provimit pranues me shkrim. Ata që pranohen i nënshtrohen trajnimit klasor dhjetë muajsh në IGJK dhe trajnimit dy mujor të punës praktike në gjykatë. Pastaj KGJPK-ja i rekomandon PSSP-së për emërim si gjyqtarë, personat e diplomuar në IGJK.

Analiza e IRSGJ të Kosovës – 2004

Analiza e IRGJ të Kosovës – 2004, tregon se, që nga viti 2002 ka pasur përmirësime minimale në reformën e gjyqësisë. Siç demonstron nga korrelacionet faktoriale, përparimet fundamentale janë duke shkuar ngadalë, me një brez përmbajtësor të faktorëve të cilët kërkojnë vëmendje plotësuese. Përderisa korrelacionet faktoriale mund të paraqesin një sens të peshës relative të çështjeve të caktuara, ABA/CEELI-i nënvizon faktin se këto korrelacione si dhe konkluzionet e IRSGJ-së të Kosovës – 2004, janë mëse të përdorshme në masë të madhe kur të shikohen së bashku me analizat pasuese dhe të krahasuara me IRSGJ e Kosovës – 2002. Në këtë drejtim, ABA/CEELI bën thirrje për komente dhe informata të cilat do ta mundësonin zhvillimin më të mirë dhe më të hollësishëm të përgjigjeve ndaj vlerësimeve të ardhshme të IRSGJ-së. ABA/CEELI e shikon procesin vlerësues të IRSGJ-së, si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për përcjelljen dhe vlerësimin e përpjekjeve reformuese.

Tabela e Korrelacioneve të Faktorëve

| Faktori i Indeksit për Reformë Gjyqësore | | Korrelacioni 2002 | Korrelacioni 2004 | Trendi |
|--|---|-------------------|-------------------|--------|
| I. Cilësia, Arsimit dhe Diversiteti | | | | |
| Faktori 1 | Kualifikimi dhe përgatitja e gjyqtarëve | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 2 | Procesi i përzgjedhjes/emërimit | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 3 | Arsimimi i vazhdueshëm ligjor | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 4 | Përfaqësimi gjinor dhe i pakicave | Negativ | Neutral | ↑ |
| II. Pushteti Gjyqësor | | | | |
| Faktori 5 | Shqyrtimi gjyqësor i legjislacionit | Negativ | Negativ | ↔ |
| Faktori 6 | Mbikqyrja gjyqësore e veprimtarisë administrative | Negativ | Negativ | ↔ |
| Faktori 7 | Juridiksioni gjyqësor ndaj lirive qytetare | Negativ | Negativ | ↔ |
| Faktori 8 | Sistemi i vendosjes sipas ankesës | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 9 | Mospërfilljet/thirrjet/ekzekutimet | Negativ | Negativ | ↔ |
| III. Resurset Financiare | | | | |
| Faktori 10 | Të hyrat buxhetore | Negativ | Negativ | ↔ |
| Faktori 11 | Mjaftueshmëria e rrogave të gjyqësorit | Negativ | Negativ | ↔ |
| Faktori 12 | Ndërtesat (objektet) e gjykatave | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 13 | Siguria e gjyqësorit | Negativ | Neutral | ↑ |
| IV. Masat Mbrojtëse Strukturore | | | | |
| Faktori 14 | Mandati i garantuar | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 15 | Kriteret objektive për avansim në gjyqësi | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 16 | Imuniteti i gjyqtarëve për veprimet zyrtare | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 17 | Shkarkimi dhe disiplina për gjyqtarë | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 18 | Caktimi i lëndës | Negativ | Negativ | ↔ |
| Faktori 19 | Shoqatat e gjyqtarëve | Neutral | Neutral | ↔ |
| V. Përgjegjshmëria dhe Transparenca | | | | |
| Faktori 20 | Vendimet gjyqësore dhe ndikimi jo i duhur | Negativ | Negativ | ↔ |
| Faktori 21 | Kodi i etikës | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 22 | Procesi ankimor për sjellje gjyqësore | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 23 | Qasja e publikut dhe mediave në procedurë | Pozitiv | Pozitiv | ↔ |
| Faktori 24 | Publikimi i vendimeve gjyqësore | Negativ | Negativ | ↔ |
| Faktori 25 | Mirëmbajtja e procesverbaleve gjyqësore | Negativ | Negativ | ↔ |
| VI. Efikasiteti | | | | |
| Faktori 26 | Stafi përkrahës i gjykatave | Negativ | Negativ | ↔ |
| Faktori 27 | Pozitat gjyqësore | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 28 | Depozitimi i lëndëve dhe sistemi i përcjelljes | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 29 | Kompjutorët dhe pajisjet për zyrë | Neutral | Neutral | ↔ |
| Faktori 30 | Shpërndarja dhe rradhitja e ligjit të tanishëm | Negativ | Neutral | ↑ |

Cilësia, Arsimimi dhe Diversiteti

Faktori 1: Kualifikimi dhe Përgatitja e Gjyqtarëve

Gjyqtarët e kanë të kryer fakultetin juridik dhe e ushtrojnë detyrën pranë tribunaleve (gjykatave) ose, para se ta marrin detyrën, nga ata kërkohet që t'i përcjellin kurset relevante që kanë të bëjnë me të drejtën materiale dhe procedurale të fushave të drejtësisë, pastaj, për rolin e gjyqtarit në shoqëri dhe ndjeshmërinë kulturore.

| Përfundimi | Korrelacioni: Neutral | Trendi : ↔ |
|--|------------------------------|-------------------|
| <p>Nga gjyqtarët profesionistë kërkohet ta kenë të kryer shkollimin e rangut universitar në fushën e drejtësisë, ta kenë të kryer përvojën e praktikantit, ta kenë dhënë provimin e jurisprudencës dhe të demonstrojnë se janë të përshtatshëm moralisht, por nuk kërkohet të kenë ushtruar ligjin para tribunaleve, para se të emërohen për gjyqtarë. Është hartuar një ligj me të cilin kërkohet që kandidatët e ardhshëm për gjyqësi, t'i nënshtrohen trajnimit plotësues pas dhënjes së provimit të jurisprudencës. Për ndihmës-gjyqtarë nuk është paraparë t'i nënshtrohen ndonjë trajnimi e as të kenë ndonjë kualifikim të caktuar.</p> | | |

Analiza/Sfondi:

Para emërimit, të gjithë gjyqtarët profesionistë, përfshirë edhe gjyqtarë e procedurës kundërvajtëse, duhet ta kenë të kryer fakultetin juridik, një vit të përvojës së praktikantit dhe ta kenë dhënë provimin e jurisprudencës. Lexo RREGULLOREN E UNMIK-ut 2001/8 PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT GJYQËSOR DHE PROKURORIAL TË KOSOVËS, [më tutje në tekst, RREGULLORJA MBI KGJPK-në]. Si parakusht për t'u regjistruar për provim të jurisprudencës, juristi i diplomuar duhet ta ketë kryer përvojën njëvjeçare të praktikantit në zyrën e avokatit, prokurorit ose gjyqtarit. Lexo LIGJIN PËR PROVIMIN E JURISPRUDENCËS, neni 2, G.Z. 10/77 KSA e Kosovës. Juristët e diplomuar të cilët kryejnë punë tjera juridike nevojitet të kenë përvojë dy vjeçare për të hyrë në provim. *Id.*

Krahas shërbimit si praktikantë, gjyqtarët e ardhshëm (duke përjashtuar këtu gjyqtarët e gjykatave kundërvajtëse) nevojiten të kenë përvojë relevante në lëminë e drejtësisë, por kjo nuk do të thotë të përfshijë shërbimin si gjyqtarë pranë tribunaleve (gjykatave). Për emërim në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje ose gjykatat komunale nevojiten tri vite përvojë pune në gjykatë, shtatë vite për kandidatët për gjykatat e qarkut dhe katër vite për kandidatët për gjykatën ekonomike. LEXO RREGULLOREN MBI KGJPK-në Id. § 6.2. Nuk është e specifikuar përvoja e nevojshme për të shërbyer në Gjykatën Supreme edhe pse për gjyqtarët që shërbejnë në Kolegjin e Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështjet e Agjencisë kosovare të Mirëbesimit, nevojitet të kenë "përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile, ekonomike dhe të ndërmarrjeve". URDHËRESA ADMINISTRATIVE NR. 2003/13, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 PËR THEMELIMIN E DHOMËS SË VEÇANTË TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS, PËR ÇËSHTJET E AKM-së § 3 (më tutje në tekst, UDHËRESA ADMINISTRATIVE PËR DHOMËN E VEÇANTË PËR ÇËSHTJET E AKM-SË). Edhe pse shumica e gjyqtarëve të emëruar nga administrata e UNMIK-ut, më heret kanë shërbyer në gjyqësi, disa prej tyre asnjëherë nuk kanë punuar në gjykatë ose në prokurori. Shumica e të anketuarve janë shprehur se duhet ndryshuar ligjin për t'i veçuar këto punë juridike. Gjithashtu të anketuarit janë ankuar se nuk respektohet gjithëherë kushti për përvojë paraprake juridike. Njëri nga të anketuarit e ka përmendur rastin e një kandidati i cili ishte përzgjedhur për kandidat në gjykatë të qarkut menjëherë pas kryerjes së përvojës së praktikantit.

Ende vazhdojnë të qëndrojnë shumica e problemeve të cilave u referohet IRSGJ-ja e vitit 2002, në lidhje me cilësinë e dobët të arsimimit juridik në Fakultetin Juridik të Prishtinës, siç është fjala për metodat e vjetëruara të mësimdhënjes dhe notimi subjektiv. Arsimiti praktik ligjor, përfshirë edhe arsyetimin gjyqësor, shkrimin ligjor dhe marrjen në pyetje të dëshmitarit të kombinuara me metodat moderne të mësimdhënjes, do të përmirësonin në masë të konsiderueshme sistemin e tanishëm. Përpjekjet për reforma të inicuar më heret nga Qendra Juridike e Kosovës, (një OJQ e vendit) dhe nga Ministria e Arsimit, në përgjithësi nuk kanë dhënë rezultate. Sido që të jetë, në kuadër të Fakultetit Juridik tani në rrugë e sipër janë duke u zhvilluar disa nisma të udhëhequra nga organizata të ndryshme, përfshirë këtu, klinikat ligjore dhe zhvillimi i qendrës për resurse juridike.

Instituti Gjyqësor i Kosovës, (IGJK), organizon kursin hyrës obligativ për gjyqtarët dhe prokurorët e rinj dhe një kurs të veçantë për gjyqtarët e rinj ndërkombëtar. Kursi hyrës për gjyqtarët kosovar, zakonisht zgjatë prej katër deri në pesë ditë dhe përfshin trajnime nga lëmia e Kornizës Kushtetuese, rregulloret e UNMIK-ut, e drejta penale materiale dhe procedurale, e drejta civile, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kodi i etikës profesionale për gjyqtarë dhe roli i Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës dhe Njësisë për Inspektim Gjyqësor në Administratën Gjyqësore. Pjesëmarrësve, gjithashtu u shpërndahen materiale njoftuese, sikur janë, Rregulloret e UNMIK-ut, kopjet e Kodit Penal dhe Procedurës Penale dhe kopjet e ligjeve tjera në fuqi, tekstet ligjore ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, dhe dokumentet kryesore që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore dhe të banimit. *Lexo RAPORTET VJETORE TË INSTITUTIT GJYQËSOR TË KOSOVËS, 1999-2004, (shtator 2004).* Nuk kërkohet ndonjë trajnim tjetër para emërimit.

Sipas projektligjit të tanishëm për "Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK) (më tutje në tekst, Projektligji për IGJK-në), kandidatët që e gëzojnë të drejtën e kandidimit dhe të cilët e kanë dhënë provimin e jurisprudencës, do t'i nënshtrohen edhe një provimi konkurses me shkrim. Aplikantët e suksesshëm do të përzgjedhen për Programin fillestar të Arsimit Juridik – IGJK për ta përcjellë trajnimin dhjetë muajsh në IGJK, i përcjellur me dy muaj trajnim praktik nëpër gjykata. Pas përfundimit të programit, IGJK e kryen vlerësimin final për secilin kandidat dhe ia përcjellë KGJPK-së për shqyrtim. Kryerja me sukses e këtij programi bëhet pjesë përbërëse e procesit të pranimit në gjyqësor.

Agjensioni European për Rindërtim (AER), së bashku me partnerin vendor – Qendrën Juridike të Kosovës dhe të tjerët, është duke i ndihmuar IGJK-së përmes hartimit të mostrës për planprogram si dhe duke ofruar ndihmë në zhvillimin profesional. Planprogramet janë për kursin për shqyrtim të provimit të jurisprudencës, Programin Hyrës për Arsimit Ligjor (PHAL), trajnimin e veçantë për gjyqtarët e avansuar dhe trajnimin elementar për ndihmësgjyqtarë. Për shkak se UNMIK-u e ka konsideruar përmbajtjen e këtyre trajnimeve gjyqësore si pjesë e procesit hyrës në gjyqësi, përgjegjësia për trajnimin i është ndarë KGJPK-së si arbitër i fundit ndaj mostrës së planprogramit të hartuar nga AER. Gjatë hartimit të planprogramit, AER ishte ndeshur me një situatë të çuditshme, pra është dashur të procedojë në pajtim me projektligjin për IGJK-në, e i cili mund të ndryshohet në pritje të miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës. AER kishte hasur në disa vështirësi njëra prej të cilave ishte se postet për pozitat më të larta të IGJK-së, ai i drejtorit vendor dhe koordinatorit vendor të programeve, kanë qenë të paplotësuara për më shumë se një vit (edhe pse pozita e fundit është plotësuar tani vonë). Shumica e të anketuarve, këtë situatë ia atribuonin pagave vazhdimisht të ulëta.

Edhe pse Projektligji për IGJK-në parashikon trajnimin e specializuar elementar për ndihmësgjyqtarët, për momentin nuk nevojitet ndonjë trajnim i veçantë për ta ushtruar atë detyrë, përveç për ndihmësgjyqtarët të cilët punojnë në rastet me të mitur. Këta të fundit duhet të kenë "kualifikime personale ose përvojë me të mitur" para emërimit. *Lexo RREGULLOREN MBI KGJPK-në § 6.3.*

Nga gjyqtarët ndërkombëtarë kërkohet t'i plotësojnë kriteret e shkollimit nga shtetet e tyre dhe të kenë së paku pesë vite përvojë si gjyqtarë para se të shërbejnë si gjyqtarë ndërkombëtarë në

Kosovë. Lexo RREGULLOREN E UNMIK-ut nr. 20001/6 MBI NDRYSHIMET E RREGULLORES SË UNMIK-ut, PËR EMËRIMIN DHE SHKARKIMIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTARË § 2, [më tutje në tekst RREGULLORJA PËR EMËRIMIN DHE SHKARKIMIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTARË]. Me përjashtim të kursit të përciptë hyrës, gjyqtarët ndërkombëtarë, para marrjes së detyrës, nuk i nënshtrohen asnjë trajnimi mbi sistemin juridik të Kosovës. Të anketuarit e kanë identifikuar mungesën e trajnimit si një dobësi të konsiderueshme dhe i kanë përmendur disa vendime të marra nga gjyqtarët ndërkombëtarë të cilat Gjykata Supreme e Kosovës i ka prishur. Të anketuarit kanë bërë vërejtje se vetëm pak prej gjyqtarëve ndërkombëtarë kanë kërkuar udhëzime nga gjyqtarët vendor.

Faktori 2: Procesi i Përzgjedhjes/ Emërimit

Gjyqtarët emërohen në bazë të kriterëve objektive, siç janë, provimi i dhënë, notat në fakultet, trajnimet tjera, përvoja, profesionalizmi dhe reputacioni i fituar në komunitetin e juristëve. Gjerësa mund të involvohen elementet politike, sistemi i përgjithshëm duhet të përqafojë sistemin e përzgjedhjes së gjyqtarëve të pavarur dhe të paanshëm.

| Përfundimi | Korrelacioni: Neutral | Trendi : ↔ |
|---|------------------------------|-------------------|
| Emërimi i gjyqtarëve profesionistë kryesisht kryhet mbi bazat e kriterëve objektive dhe kriteret tjera plotësuese janë të përfshira në Projektligjin për “Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës”. | | |

Analiza/Sfondi:

Përgjithësisht, gjyqtarët emërohen mbi bazat e kriterëve objektive. Rregullorja mbi KGJPK-në kërkon plotësimin e kushteve nga gjyqtarët, të cilat janë: diplomimi në fakultetin juridik dhe posedimi i cilësive të duhura morale (dhe mospërfshirjen e tyre në praktikat diskriminuese ose të mos kenë dosje penale). Lexo RREGULLOREN MBI KGJPK-në § 6.1. Për gjykatën komunale, të qarkut, ekonomike dhe atë kundërvajtëse gjyqtarët kërkohet ta kenë të dhënë provimin e juridpurdencës. Id. Projektligji për IGJK-në i diskutuar në Faktorin 1, do ta rrisë numrin e kriterëve objektive për emërimet gjyqësore përmes futjes së provimeve plotësuese dhe programeve obligative për trajnime para emërimit. Nuk kërkohet zbulimi i të dhënave financiare dhe pronësore.

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të KB-së është i autorizuar për emërimin e gjyqtarëve në Kosovë, i cili i përzgjedhë kandidatët nga lista e propozuar nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJPK-së) dhe të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Lexo RREGULLOREN E UNMIK-ut nr. 2001/9 MBI KORNIZËN KUSHTETUESE PËR VETËQEVERISJE TË PËRKOHSHME NË KOSOVË § 9.4.8 (më tutje në tekst KORNIZA KUSHTETUESE). KGJPK është themeluar për ta zëvendësuar Komisionin Konsultativ Gjyqësor të Kosovës (KKGJK) i cili ishte braktisur për shkak të perceptimit se disa emërimet ishin bërë mbi bazat e konsideratave politike.

Pas shpalljes së vendeve të lira në gjyqësor, KGJPK-ja e përgatit listën e aplikantëve dhe të njëjtën ia përcjell kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve për paraqitjen e komenteve të tyre. Këta të fundit brenda tetë ditëve të punës mund t'i paraqesin komentet me shkrim nëse aplikuesit i plotësojnë kushtet për emërim. Lexo vendimin e KGJPK-së nr. 1/2003, për Çështjet e Rekrutimit § 2. KGJPK-ja ia dorëzon listën e aplikuesve edhe Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës. Lexo në përgjithësi, vendimin e KGJPK-së nr. 8/2003, për Dërgimin e Listës së Aplikuesve Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës/Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës, Për Dhënjen e Komenteve. Më pas, KGJPK-ja i shqyrton aplikacionet ndërsa anëtarët e këshillit zhvillojnë intervista të shkurta me aplikuesit të cilët i plotësojnë kushtet minimale. Gjatë intervistave, komisionet intervistuese “duhet ta bëjnë vlerësimin e cilësive profesionale dhe personale të kandidatëve në mënyrë të

paanshme dhe të drejtë, duke respektuar synimin për zhvillimin e gjyqësisë së pavarur dhe shumetnike në Kosovë”. RREGULLAT INTERNE PROCEDURALE TË KËSHILLIT GJYQËSOR DHE PROKURORIAL TË KOSOVËS neni 37. Gjatë marrjes së vendimeve, KGJPK-ja do të “udhëhiqet nga synimi i UNMIK-ut që të krijojë gjyqësinë profesionale, të pavarur, të paanshme dhe shumetnike” RREGULLORJA MBI KGJPK-në, § 5.2. KGJPK-ja listën e ngushtë të kandidatëve ia përcjellë PSSP-së për t’ia përcjellë më tutje Kuvendit për komente. Nga Kuvendi kërkohet ta jap mendimin brenda dhjetë ditëve. Edhe pse Kuvendi mund të kërkojë informacione plotësuese, megjithatë nuk mund ta ndryshojë listën. Pas marrjes së aprovimit nga Kuvendi, PSSP-ja e merr vendimin përfundimtar për emërimet. Krahas kësaj, KGJPK-ja rishtazi ka vendosur ta mbajë listën rezervë të përkohshme të kandidatëve të kualifikuar dhe të intervistuar për detyrën e gjyqtarit/prokurorit dhe të cilët nuk janë zgjedhur për këto funksione. *Vendimi i KGJPK-së 01/2004, Për Listën Rezervë të Kandidatëve për Pozitën e Gjyqtarit dhe Prokurorit.*

Sipas disa të anketuarve, PSSP-ja dhe Kuvendi janë konfrontuar lidhur me emërimet gjyqësore. Në këtë drejtim, njëri nga rolet e KGJPK-së është të sigurojë se procesi i aprovimit nga Kuvendi të mos vonohet pa nevojë dhe që si masë të fundit, ta këshillojë PSSP-në që ta miratojë listën e shkurt të kandidatëve edhe pa aprovimin e saj nga Kuvendi “në rastet e vonesave ose mos aprovimit të paarsyeshëm”. *Lexo Nataliya Shkryada, KGJPK: Fuqizimi i Zhvillimit të Gjyqësisë së Pavarur, KOSOVA NË FOKUS (gusht 2004).*

Shumica e të anketuarve e konsiderojnë KGJPK-në si pjesërisht të suksesshëm, për atë se i ka plotësuar shumicën e vendeve të lira. Mirëpo, të anketuarit e kanë kritikuar procesin e përzgjedhjes të KGJPK-së dhe mungesës së transparencës në këtë drejtim. Shqetësimi më i rëndësishëm ishte ai se procesi i punësimit ishte padrejtësisht i ngadalshëm, duke shkaktuar kështu që vendet e lira të mbesin të paplotësuara nganjëherë edhe për më shumë se një vit. Kjo vonesë në anën tjetër shkakton rritjen e numrit të lëndëve të pazgjdhura brenda gjykatave. Disa nga bashkëbiseduesit kanë propozuar organizimin e procesit përsëritës të aplikimit kështu që vendet e lira të plotësohen më shpejtë. Veç kësaj, shumë të anketuar kanë bërë vërejtje se KGJPK-ja nuk konsultohet gjithnjë me kryetarët e gjykatave për procesin e përzgjedhjes, ndërsa kur këtë e bëjnë, shpeshherë nuk ua vë veshin komenteve të dhëna. Krahas kësaj, anëtarët e KGJPK-së pohojnë që ata bëjnë përpjekje që të konsultohen me kryetarët e gjykatave para emërimit. Njëri nga të anketuarit ka kërkuar që kryetarët e gjykatave të konsultohen nga KGJPK-ja që nga fillimi i procesit që të propozojnë kandidatët për emërim. Disa nga ata janë ankuar se kandidatëve të pazgjdhur nuk iu është dërguar madje as letra për shpjegimin e saktë për çfarë arsye nuk janë zgjedhur. Në fund, disa të anketuar kanë deklaruar se KGJPK-ja e denigron autoritetin e Kuvendit duke i emëruar kandidatët e kundërshtuar nga Kuvendi.

Procedura bazë për zgjedhjen e gjyqtarëve porotë është kryesisht e njëjtë sikur ajo për gjyqtarë profesionistë. Kriteret për t’u zgjedhur janë se duhet qenë i moshës 25 vjeçare dhe se duhet poseduar cilësi të përshtatshme morale. *Lexo RREGULLOREN MBI KGJPK-në § 6.3.* Krahas pranimi të aplikacionit individual për pozitën e gjyqtarit porot, për vendin e lirë të shpallur, KGJPK-ja mundet gjithashtu t’i pranojë “rekomandimet nga autoritetet komunale, ose gjyqësore dhe organet tjera brenda profesionit ligjor, lidhur me personin në fjalë nëse është i përshtatshëm për ta intervistuar për gjyqtar porot”. § 5.1.

Gjyqtarët ndërkombëtar përzgjedhen përmes një procesi konkures të përzgjedhjes, pa involvimin e KGJPK-së. Pozitat shpallen përmes konkursit. Intervistat zhvillohen përmes telefonit. Gjyqtarët ndërkombëtarë mund të emërohen njëkohësisht në më shumë gjykata. Disa të anketuar e kanë pranuar se vetëm pak gjyqtarë ndërkombëtarë të kualifikuar kanë shprehur interesimin të vijnë në Kosovë, për shkak të kushteve relativisht të dobëta që u ofrohen atyre.

Faktori 3: Arsimimi i Vazhdueshëm Ligjor

Gjyqtarët duhet t'i përcjellin rregullisht, kurset pa pagesë, dhe të përgatitura profesionalisht për arsimim të vazhdueshëm ligjor, lënda e të cilave në përgjithësi përcaktohet nga vetë gjyqtarët, dhe me të cilat kurse ata njoftohen për ndryshimet dhe zhvillimet në fushën e drejtësisë.

| Përfundimi | Korrelacioni: Neutral | Trendi : ↔ |
|--|------------------------------|-------------------|
| <p>Kurset për arsimim të vazhdueshëm ligjor ofrohen pa pagesë për gjyqtarët dhe në baza vullnetare, por në përgjithësi kurset disi nuk janë mirë të kordinuara. Edhe pse gjyqtarët konsultohen lidhur me temën, një bashkëpunim më i madh ndërmjet ekspertëve të huaj dhe atyre kosovarë do ta shtonte rëndësinë e këtyre kurseve. Ligji i ri me të cilin obligohet arsimimi i vazhdueshëm ligjor është i paraparë për një të ardhme të afërt.</p> | | |

Analiza/Sfondi:

Kurset për arsimim të vazhdueshëm ligjor (AVL), edhe pse pa pagesë, nuk janë të obligueshme. Ofruesi kryesor i trajnimeve për arsimim të vazhdueshëm ligjor është Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK). Për momentin, ky institut, administrohet përkohësisht nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), edhe pse OSBE-ja nuk është më financuesi kryesor i IGJK-së. IGJK, kryesisht financohet përmes buxhetit të konsoliduar të Kosovës (BKK) dhe nga donatorët tjerë, siç janë, Agjensioni Europian për Rindërtim (AER). OSBE-ja i financon vetëm tri pozita ndërkombëtare dhe këtë përkrahje do ta zvogëlojë në të ardhmen, për të financuar vetëm dy poste në vitin 2005.

Projektligji “Mbi Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës” (më tutje në tekst, Projektligji mbi IGJK-në) do ta transformojë IGJK-në në shkollë të magjistratëve², në një organ të pavarur dhe profesional, me statusin e personit juridik, të financuar nga BKK dhe i cili punon në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJPK). Sipas tekstit të projektligjit, roli i IGJK-së do të kufizohet në organizimin e kurseve dhe vlerësimin e rezultateve gjatë përgatitjes së provimit të jurisprudencës dhe kurseve. Ky rol mund të ndryshohet varësisht nga shqyrtimi përfundimtar që i bëhet ligjit, edhe pse nuk priten ndryshime të rëndësishme. Do të hartohet një rregullore e UNMIK-ut me të cilën KGJPK-së do t'i jepet përgjegjësia përfundimtare për përmbajtjen e trajnimeve dhe procedurës së vlerësimit.

Për dallim nga viti 2002, statusi i IGJK-së do të rregullohet me ligj të Kuvendit të Kosovës dhe jo me rregullore të UNMIK-ut. Edhe pse hartuesit, Shtylla I dhe III e UNMIK-ut në konsultim me KGJPK-në, Zyrës së Kryeministrit (ZK), i'a kanë dorëzuar Projektligjin për IGJK-në në shkurt të vitit 2004, dhe këtë e ka shqyrtuar grupi punues i ZK-së gjatë prillit 2004, ky projektligj ende nuk ka kaluar. Mirëpo, çështja e miratimit të këtij ligji, ka fituar në peshë në Planin për zbatimin e standardeve për Kosovën (PZSK), në të cilin parashikohet transformimi i IGJK-së të jetë prioritet për standardin e sundimit të ligjit dhe është përcaktuar afati për transformimin e IGJK-së në shkollë të magjistratëve, të jetë mesi i vitit 2004. Ky afat ka skaduar për shkak të vonesave në procesin e hartimit. Ky projektligj i është nënshtruar procesit të revidimit, ndërsa Kuvendi nuk do ta shqyrtojë këtë ligj deri në konvokimin e tij të radhës në dhjetor të vitit 2004. Përshtatshëmrisht, data e miratimit nuk mund të jetë më afër se gjatë fillimit të vitit 2005. Në dhjetor 2003, UNMIK-u e ka shpallur Urdhëresën Administrative Nr. 2003/31 për autorizimin e IGJK-së për aktivitetet e mëtutjeshme deri në miratimin e ligjeve të reja nga Kuvendi.

² Rastësisht, termi “magjistrat” është i vështirë për t'u kuptuar nga të gjithë kosovarët e të gjitha përkatësive etnike për shkak se ky term nuk është përdorur në këtë kuptim si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë serbe.

Edhe pse Projektligji për IGJK-në nuk e bën të obligueshëm AVL për gjyqësinë, një ligj tjetër do të kishte mundur këtë ta trajtoj ndarazi³. Megjithatë, Projektligji për IGJK-në e bën të obligueshëm kursin e specializuar për gjyqtarët dhe prokurorët e avansuar në detyrë. AER-i së bashku me KGJPK-në është duke e zhvilluar planprogramin për këtë lloj kursi.

IGJK-ja vazhdon të ofrojë programe dhe mundësi të llojllojshme edukative për gjyqtarë. IGJK-ja, përmes programit për arsimim të vazhdueshëm ligjor (PAVL), ka ofruar kurse të rregullta dhe *ad hoc* kurse mbi çështjet e ndryshme siç mund të jenë, drejtësia për të mitur, dhuna familjare, të drejtat pronësore, ekzekutimi i aktgjykimeve, sanksionet penale, krimi dhe trafikimi i organizuar, bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe gjyqësisë, etika gjyqësore, e drejta ndërkombëtare humanitare, dhe ligjet ndërkombëtare mbi ekstradimin. *Lexo RAPORTET VJETORE TË IGJK-së: 1999-2004, (me 2 dhe 11 shtator 2004)*. IGJK-ja ka qenë nikoqir i disa punëtorive mbi risitë dhe temat e panjohura që burojnë nga dy kodet e reja penale. Krahas kësaj, që nga viti 2002, IGJK ka bashkëpunuar me USAID dhe organizatën "International Development Laë Organization" (IDLO) për prezantimin e Programit për Trajnim në Aftësimin Profesional (PTAP). Ky program i kishte udhëzuar gjyqtarët për aftësitë e nevojshme profesionale të nevojshme për procedurën gjyqësore dhe seancat, siç janë çështjet që kanë të bëjnë me marrjen e vendimit, përpilimit dhe menaxhimit të lëndëve. Të anketuarit kanë deklaruar se programet e ardhshme trajnuese duhet t'i vëjnë theks më të veçantë aftësimin praktik, Kodit Penal dhe të Procedurës Penale të Kosovës. Më tutje, me qëllim të rritjes së qasjes dhe nxitjes së pjesëmarrjes më të madhe, IGJK është duke zhvilluar trajnime edhe nëpër regjione anekënd Kosovës. Në fund, IGJK-ja vazhdon të sponzorojë disa vizita studimore dhe programe të kryerjes së praktikës jashtë vendit.

Të anketuarit identifikuan mungesën e koordinimit ndërmjet organizatave trajnuese si një pengesë e rëndësishme ndaj formimit të një programi trajnues dhe koherent për gjyqtarë. Një numër i madh i organizatave të ndryshme ofrojnë trajnime pa pagesë. Edhe pse IGJK-ja mban takime mujore koordinuese dhe është i hapur për çdo organizatë trajnuese, duket se ka pasur efekt të vogël në koordinimin e përgjithshëm të aktivitetëve. Si rezultat disa trajnime edhe përputhen për nga përmbajtja ose orari i mbajtjes së tyre.

Në përpjekje të shtimit të rëndësisë së trajnimeve për nevojat e gjyqësisë, shumë të anketuar kanë sugjeruar se IGJK duhet të përfshijë më shumë përvojë vendëse në projektimin, organizimin dhe dhënjen e trajnimeve. Edhe pse IGJK kërkon edhe mendimin e pjesëmarrësve përmes formularëve për vlerësim të trajnimit, raporteve të ndryshme dhe burimeve tjera, por dhe konsultohet me kryetarët e gjykatave për zgjedhjen e temave për trajnim, të anketuarit besojnë se nuk është përfshirë sa duhet dituria vendëse nga trajnuesit vendës, posaçërisht kur donatori i jashtëm është i involvuar. Donatorët e jashtëm e ndjekin agjendën ekskluzivisht të vlefshme për situatën në Kosovë. Shumë trajnues të huaj janë "ekspertë" në një kuptim më të gjërë, por me pak njohuri për sistemin juridik të Kosovës apo problemeve specifike me të cilat ballafaqohet gjyqësia e Kosovës. Teorikisht, dy postet më të larta në IGJK, bashkëdrejtori vendës dhe koordinatori vendës i projekteve, do të ofronin më shumë nga "përvoja/dituria vendëse" përmes përfshirjes së tyre në projektimin e trajnimeve, por këto poste janë të lira më shumë se një vit⁴ (postet e fundit është plotësuar tani rishtazi). Edhe pse këto poste kanë ekzistuar që nga krijimi i IGJK-së, ato janë liruar që nga fillimi i procesit të ndarjes së IGJK-së prej një institucioni të formuar nga OSBE-ja, në një subjekt të pavarur dhe të financuar nga Qeveria e Kosovës. Në atë kohë, disa të punësuar, përfshirë edhe postet e lartpërmendura, u larguan për shkak të zvogëlimit radikal të rrogave të tyre.

³ Në fakt, PZSK obligon krijimin e një "programi të plotë obligativ për edukimin e vazhdueshëm profesional për gjyqtarë" deri në mars të vitit 2005.

⁴ Më heret IGJK ka përjetuar vështirësi lidhur me vazhdimësinë e stafit ndërkombëtarë të angazhuar nga OSBE, për shkak se atyre u ofroheshin kontratat 6 mujore me mundësi të zgjatjes.

Për gjyqtarët nga pakicat, vlejné ndërlikimet tjera plotësuese. Duke u mbështetur në regjistrat e IGJK-së për pjesëmarrje, vështirësitë logjistike shpesh ua pengojné pjesëmarrjen në seminare dhe trajnime. Një barrierë tjetër është edhe përkthimi në nivel në gjuhën serbe, gjë që e kufizon vlerën edukative të përvojës për gjyqtarët nga pakicat.⁵

Në qershor 2002, Divizioni për Përkrahje të Gjyqësisë Ndërkombëtare (IJSJ) i DD-së e ka inicuar programin për AVL për gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë. Deri më sot janë mbajtur disa sesione, ku në disa prej tyre në mënyrë selektive janë ftuar disa gjyqtarë kosovarë. Të anketuarit kanë sqaruar se gjuha serbe shpeshherë përkthehet nga gjuha shqipe e përkthyer nga anglishtja e pastaj në gjuhën serbe, duke e humbur kuptimin faktik. Megjithatë, IGJK-ja ka pohuar që tani ofrohet përkthim simultant nga gjuha serbe në gjuhën shqipe dhe *vice versa*.

Faktori 4: Përfaqësimi Gjinnor dhe i Pakicave

Në grupin e të nominuarve dhe në gjyqësi, pakicat etnike dhe fetare si dhe të dyja gjinitë, përgjithësisht janë të përfaqësuara.

| Përfundimi | Korrelacioni: Neutral | Trendi : ↑ |
|--|------------------------------|-------------------|
| Edhe pse përfshirja e pakicave etnike dhe religjioze është rritur, ky përfaqësim nuk është reprezentativ për komunitetet e Kosovës. Femrat në përgjithësi janë të nënpërfaqësuara. | | |

Analiza/Sfondi:

Që nga viti 2002, përfaqësimi i pakicave etnike dhe fetare në mesin e kandidatëve për gjyqësi dhe i gjyqtarëve është përmirësuar, por ende numri i përgjithshëm mbetet më i vogël se përqindja e vlerësuar e pakicave të Kosovës. Në dokumentin e përbashkët ndërmjet UNMIK-ut dhe ish Republikës së Jugosllavisë, të nënshkruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) dhe nga Qeveria e Serbisë në nëntor të vitit 2001, UNMIK-u është pajtuar ta krijojë gjyqësinë shumetnike. Ky zotim është fuqizuar edhe më tej me Kornizën Kushtetuese, sipas së cilës gjyqësia e Kosovës duhet të reflektojë diversitetin kosovar. *Lexo KORNIZËN KUSHTETUESE § 9.4.7; gjithashtu lexo RREGULLOREN MBI KGJPK-në § 5.2.* Edhe pse Kosova është e pasur me pakica të ndryshme, serbët përbëjnë pakicën më të madhe, që vlerësohet të jetë 7% e popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Pjesa e pakicave tjera, përfshirë, boshnjakët, turqit, romët, goranët, ashkalinjtë, dhe egjiptasit, vlerësohet të jetë 5% e popullsisë së përgjithshme. Që nga tetori 2004, gjyqësia ka numëruar 16 serbë dhe 16 përfaqësues të pakicave tjera nga numri i përgjithshëm prej 313 gjyqtarëve në detyrë. *Lexo Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut, Raporti Javor, java e 12-18 tetorit 2004.*

Seksioni për Integrim Gjyqësor (JIS) i Departamentit të Drejtësisë, në kuadër të UNMIK-ut, orvatet ta rrisë numrin e gjyqtarëve pjesëtarë të pakicave në gjyqësi. Pengesa kryesore për rekrutimin e gjyqtarëve nga pakicat është problemi i sigurisë. Aplikojnë vetëm disa prej tyre për shkak të pengesave të sigurisë dhe shpenzimeve financiare, frika nga ndëshkimi, kufizimet logjistike të përcjelljeve të sigurisë, ndjenja e të qenit të përjashtuar nga sitemi i KB-së dhe shpenzimet e kthimit. Gjyqtarët nga pakicat, të cilët punojnë për UNMIK-un, shërbejnë kryesisht vetëm në zonat e banuara nga pakicat, gjë që nuk është e papritur.

Një pengesë tjetër e rekrutimit është ekzistimi i gjykatave paralele. Gjykatat paralele të financuara dhe përkrahura nga Beogradi, gjinden nëpër enklavat serbe në Kosovë dhe në territorin e Serbisë. Edhe pse UNMIK-u nuk i njeh vendimet e gjykatave paralele, e ka toleruar mjaft shumë

ekzistimin e këtyre gjykatave. Mirëpo, në vitin 2002, zëvendësi i PSSP-së, shefi i shtyllës për Polici dhe Gjyqësi me ministrin serb të Drejtësisë e kanë nënshkruar deklaratën e përbashkët për integrimin e gjykatave paralele në kuadër të sistemit gjyqësor të UNMIK-ut. Në marrëveshje thuhet se gjyqtarët serbë që punojnë për UNMIK-un do të paguhen nga UNMIK-u por do të vazhdojnë ta marrin pensionin nga Serbia. Në janar 2003, gjykata komunale dhe ajo për kundërvajtje, në kuadër të gjykatave të UNMIK-ut, janë hapur në enklavën serbe të Leposaviqit dhe Zubin Potokut (Rajoni i Mitrovicës). Gjatë periudhës kohore janar-korrik 2003, gjykatat paralele të këtyre dy vendeve kishin ndërprerë funksionimin por kishin rifilluar me punë prapë gjatë muajit gusht. Është ironik fakti se gjykata paralele e Leposaviqit është e vendosur në ndërtesën e gjykatës komunale të UNMIK-ut. E ngjajshme është edhe situata në Zubin Potok, komuna është pronare e ndërtesës në të cilën është e vendosur gjykata paralele. Një i anketuar ka deklaruar se në Zubin Potok, gjykata paralele “vepron në cilësinë e Ambasadës serbe”, dhe është e autorizuar nga Qeveria e Serbisë të lëshojë dokumente të ndryshme zyrtare, pa marr parasysh faktin e pamohueshëm se UNMIK-u nuk i njeh këto dokumente. Në këtë rast, njerëzit nga fshatrat e vogla janë viktima reale në këtë luftë politike për shkak se ata nuk janë edhe aq të vetëdijshëm për pasojat e shfrytëzimit të gjykatave paralele, p/sh., se dokumentet e tyre nuk janë valide në Kosovë. Është bërë edhe një vërejtje më shpresëdhënëse, gjegjësisht të anketuarit kanë vërejtur se numri i serbëve të Kosovës që iu drejtohen gjykatave të UNMIK-ut është duke u rritur gradualisht.

Disa të anketuar serbë, të cilët i janë bashkuar sistemit të UNMIK-ut i kanë shprehur dyshimet serioze lidhur me vendimin e tyre dhe e kanë ndier një lloj braktisjeje nga administrata ndërkombëtare pas “joshjes” në të. Për gjyqtarët serbë, në vendimin e tyre ka ndikuar në masë të madhe disavantazhi financiar dhe shoqëror i punës në gjykatat e UNMIK-ut. Gjyqtarët serbë që punojnë në gjykatat e UNMIK-ut marrin rroga më të ulta se sa kolegët e tyre në gjykatat paralele. Nga aspekti shoqëror, gjyqtarët serbë dhe familjet e tyre i nënshtrohen një presioni të madh nga komuniteti i tyre, të cilët mund t'i shohin ata si tradhtarë. Në një rast, kryetari i komunës së një enklave serbe e ka akuzuar gjykatën e UNMIK-ut se punon kundër komunës, pasi që gjykata e ka qortuar atë për aplikimin e legjislacionit i cili nuk është në fuqi në Kosovë. Në një rast tjetër, komuna kryesisht serbe e ka rrënuar rrethojën e ndërtuar nga gjykata e UNMIK-ut. Sipas disa të anketuarve këto probleme ngriten për shkak të lojalitetit të dyfishtë të administratorëve komunal nëpër enklavat serbe, të cilët zakonisht i marrin rrogat si nga UNMIK-u ashtu edhe Serbia. Siç, raportohet së paku njëri nga kryetarët e komunës i përdorë dy titujt profesional dhe të dy vultat zyrtare, njërin të UNMIK-ut dhe tjetrën të Serbisë. Si rezultat të anketuarit besojnë se administrata ndërkombëtare në mënyrë të heshtur e pranon këtë situatë.

Ka pasë një ndarje gjinore në mesin e të anketuarve lidhur me atë se a janë të përfaqësuara gratë në mënyrë adekuate në kuadër të gjyqësisë. Meshkujt kanë tendenca të vërtetojnë se gratë janë të përfaqësuara sa duhet, përfshirë njërin prej të anketuarve i cili i kishte përfshirë në këtë grup edhe gratë e punësuara në administratë. Të anketuarat femra kanë vërtetuar se gratë janë të nënpërfaqësuara. Edhe pse ligji nuk i diskriminon gratë, disa të anketuar insistonin se burrat kanë përparësi gjinore gjatë punësimit.

Ligji i ri mbi barazinë gjinore, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, parashikon për organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të reflektojnë përfaqësimin gjinor në “shkallën ekzistuese të përfaqësimit të tyre në popullatën e përgjithshme të Kosovës”, duke shpjeguar se përfaqësim i barabartë gjinor nënkupton “pjesëmarrjen e gjinive në ...organet...është 40%. *Lexo* LIGJIN E KUVENDIT TË KOSOVËS nr. 2004/2, për BARAZINË GJINORE , neni 3.1-32. (*shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/18*). Me ligj parashikohet gjithashtu që Zyra për Barazi Gjinore t'i realizojë këto caqe. *Id.* § 5. Që nga tetori 2004, nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve ishin 38 gjyqtare nga gjithshejt numri prej 313 gjyqtarëve në detyrë (p.sh., 26.5% e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve). *Lexo* raportin javor të Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, për javën 12-18 tetor 2004. Para luftës, të anketuarit kanë vërejtur se më shumë femra kanë punuar si gjyqtare nëpër gjykata. Shpërndarja e grave nëpër gjykata të ndryshme mund të përmirësohet edhe më tej; përderisa disa gjykata i kanë disa gjyqtare, të tjerat nuk kanë fare.

Si pakicat ashtu edhe gratë janë të nënpërfaqësuar në pozitat e larta në kuadër të gjyqësisë. Është vetëm një gjyqtar nga pakicat dhe vetëm tri gjyqtare femra në mesin e 14 gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës. Në mesin e 46 gjyqtarëve të gjykatave të qarkut, dhjetë prej tyre janë femra, katër serb dhe katër janë përfaqësues të pakicave tjera etnike. Përderisa në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje përfaqësimi gjinor është pak a shumë i balancuar (tre meshkuj, dy femra), të gjithë pesë gjyqtarët janë shqiptarë etnik. Lexo Raportin Javor të Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, për javën 12-18 tetor 2004.

Në fund, sipas të anketuarve, pakicat dhe gratë janë njësoj të nënpërfaqësuar edhe në radhët e ndihmësgjyqtarëve. Për shembull, në mesin e 169 gjyqtarëve rishtazi të emëruar në tetor 2004, 22 prej tyre janë serbë (13%) dhe 9 përfaqësues të pakicave tjera (5.3%). Lexo komunikatën për shtyp të UNMIK-ut nr. 1238, "Para PSSP-së japin betimin 169 gjyqtarë porot (ndihmësgjyqtarë) për gjykatat e Kosovës (6 tetor 2004). Nuk ka të dhëna statistikore më gjithëpërfshirëse për këtë.

II. Pushteti Gjyqësor

Faktori 5: Shqyrtimi Gjyqësor i Legjislacionit

Organi gjyqësor është i autorizuar të vendosë për kushtetushmërinë e ligjeve dhe akteve tjera zyrtare dhe këto vendime ekzekutohen.

| Përfundimi | Korrelacioni: Negativ | Trendi: ↔ |
|---|------------------------------|------------------|
| Nuk ekziston organ gjyqësor i autorizuar për shqyrtimin e kushtetushmërisë së rregulloreve të UNMIK-ut e as të ligjeve të miratuara nga Kuvendi. Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme për shqyrtimin e ligjeve të Kuvendit nëse ato janë në harmoni me Kornizën Kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, është vonuar për së tepërmi. | | |

Analiza/Sfondi:

Në Kosovë, në këtë aspekt shumë pak ka ndryshuar që nga IRGJ-ja e vitit 2002. Siç u tha më heret, as gjyqësia e vendit sikurse edhe ajo ndërkombëtare në Kosovë, nuk kanë autorizime për shqyrtimin e kushtetutshmërisë ose ligjshmërisë së ligjeve të Kuvendit të Kosovës dhe Rregulloreve të UNMIK-ut. Pos kësaj, nuk ka mekanizëm për garantimin e interpretimit unik të ligjit.

Korniza Kushtetuese parashikon formimin e Kolegjit të Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështjet e Kornizës Kushtetuese (më tutje në tekst: Kolegji i Veçantë për Kornizë Kushtetuese). Lexo KORNIZA KUSHTETUESE § 9.4.11. Kolegji i Veçantë është kompetent për të vendosur "nëse ligjet e miratuara nga Kuvendi nuk janë në pajtim me Kornizën Kushtetuese, përfshirë edhe instrumentet juridike ndërkombëtare të përmendura në kreun 3 mbi të drejtat e njeriut". Id. Kryetari i Kosovës, çdo anëtar i kryesisë së Kuvendit, jo më pak se pesë deputetë të Kuvendit, ose të Qeverisë mund ta bëjnë një kërkesë të tillë. Id. Individit nuk i njihet e drejta për iniciimin e shqyrtimit të kushtetutshmërisë. Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme është gjithashtu kompetent për konfliktet në mes të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, lidhur me veprimet të cilat mund ta cenojnë pavarësinë e organeve të pavarura, dhe është kompetent për të vendosur nëse veprimi i zyrtarit të degës së ekzekutivit apo legjislativit të degëve të IPVQ-ve, përbën aktin zyrtar të përfshirë me imunitet.

Që nga tetori 2004, Kolegji i Veçantë mbi Kornizën Kushtetuese ende nuk është themeluar, megjithëse, Kuvendi ka filluar të punojë në ligje relevante, për shkak se Korniza Kushtetuese nuk e përshkruan strukturën ose procedurën në bazë të së cilës do të funksionojë ky kolegji, Gjykata Supreme ka kërkuar udhëzime nga Zyra e Këshilltarit Juridik të PSSP-së (ZKJ) për këtë çështje dhe diskutimet janë duke vazhduar. Njëkohësisht, gjyqtarët e kanë identifikuar si problem i cili është në rritje e sipër brenda sistemit të drejtësisë, çështjen e mungesës së kolegjit kushtetues

për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet ligjeve. Gjykatës Supreme shpesh i dërgohen lëndë me të cilat kërkohet shqyrtimi i kushtetushmërisë por, ka autorizime të kufizuara të interpretimit. Në veçanti, të anketuarit kanë vërejtur se të dy kodet e reja penale, nuk janë konsistente në disa raste, pastaj kanë kundërrthënje dhe lëshime. Disa të anketuar kanë deklaruar se janë zhvilluar diskutime me UNMIK-un lidhur me interpretimin ligjor/kushtetues, por kjo “ka bërë që të dyja palët të duken të marrë sepse kjo nuk është detyrë e UNMIK-ut ose palëve tjera, por vetëm e gjykatave”.

Për momentin, vetëm Zyra e Këshilltarit Juridik të PSSP-së është e autorizuar ta shqyrtojë dhe interpretojë legjislacionin e UNMIK-ut/Kornizën Kushtetuese. Shpesh kjo punë i dorëzohet Shërbimit për Politikë Ligjore në kuadër të Departmentit të Drejtësisë. Sipas nenit 2 të Rregullores 1999/24, mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë, gjyqtarët mund të kërkojnë shpjegime të ligjit nga Zyra e Këshilltarit Juridik (ZKJ) por vetëm disa kërkesa të tilla janë bërë deri më tash.

Faktori 6: Mbikqyrja Gjyqësore e Veprimtarisë Administrative

Gjyqësia është kompetente t’i shqyrtojë aktet administrative dhe t’i detyrojë organet qeveritare të veprojnë kur ekziston obligimi ligjor për të vepruar.

| <i>Përfundimi</i> | <i>Korrelacioni: Negativ</i> | <i>Trendi: ↔</i> |
|--|-------------------------------------|-------------------------|
| Gjyqësia është kompetente dhe e autorizuar t’i shqyrtojë aktet administrative të pushtetit vendor, por jo edhe të administratës ndërkombëtare. | | |

Analiza/Sfondi:

Në Kornizën Kushtetuese thuhet se vendimet administrative të nxjerra nga dega e ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës, mund të kundërshtohen në gjykata pas shfrytëzimit të të gjitha mjeteve juridike administrative. KORNIZA KUSHTETUESE, 9.4.2. Gjykatat janë kompetente për shqyrtimin e vendimeve administrative si dhe që t’i anulojnë ose shpallin ato të pavlefshme. *Lexo* LIGJIN MBI KONFLIKTIN ADMINISTRATIV, G.Z. R.S.F.J. 4/77 (më tutje në tekst Ligji mbi Konfliktin Administrativ); LIGJIN MBI PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE, G.Z. R.S.F.J. 585/86. Qytetarët duhet t’i shfrytëzojnë dy shkallët e shqyrtimit administrativ para se të kërkojnë mbrojtje gjyqësore përmes “kërkesës administrative”. *Lexo*: LIGJI MBI KONFLIKTIN ADMINISTRATIV, neni 7. Kolegji administrativ i Gjykatës Supreme “vendosë mbi ligjshmërinë e vendimeve të plotëfuqishme të konfliktit administrativ.” LIGJI MBI GJYKATAT E RREGULLTA, neni 30(5), G.Z. KSAK 21/78, i ndryshuar me G.Z. KSAK nr. 49/79, 44/82, 44/84, 18/87, 14/88, 2/89 [më tutje në tekst LIGJI MBI GJYKATAT E RREGULLTA]. Aktet administrative me të cilat cenohen të drejtat dhe liritë kushtetuese shqyrtohen nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve në gjykatë të qarkut. *Id.* neni 29(8); *gjithashtu lexo* LIGJIN MBI KONFLIKTIN ADMINISTRATIV, nenet 66,70. Gjykata është kompetente t’i detyrojë organet administrative të veprojnë atëherë kur ekziston detyrimi ligjor për të vepruar. *Lexo* p.sh., LIGJI MBI KONFLIKTIN ADMINISTRATIV, nenet 42, 62-65.

Më herët në kolegjin administrativ të Gjykatës Supreme ka shërbyer një gjyqtar i specializuar në çështjet administrative. Mirëpo, që nga vdekja e tij ende nuk është gjetur zëvendësimi. Rastet administrative tani janë duke u shqyrtuar nga gjyqtarët e specializuar në të drejtën civile pranë Gjykatës Supreme. Disa të anketuar janë ankuar se mungesa e specialistit për të drejtën administrative ka rezultuar në grumbullimin e lëndëve të pazgjidhura në Gjykatën Supreme.

Gjykata Supreme tani vonë, e ka ushtruar kompetencën e vet duke e shqyrtuar një akt administrativ, konkretisht vendimin e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës për emërimin e

kandidatit për rektor, i cili është kundërshtuar nga Ministria e Arsimit. Autoritetet e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës kanë deklaruar se emërimi ishte i ligjshëm dhe i rregullt, mirëpo, Ministria e Arsimit, ka deklaruar se emërimi konsiderohet i pavlefshëm dhe duhet të anulohet. Nëse autoritetet e Universitetit të Prishtinës nuk do ta pranojnë kandidatin e rekomanduar nga Ministria e Arsimit, Ministria e Arsimit e ngritë padinë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ky kontest nuk është zgjidhur deri në momentin e publikimit të IRSGJ-së.

Mbrojtja gjyqësore e kufizuar është paraparë për lëminë e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore nga ana e Agjensisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). Në vitin 2002, është themeluar Kolegji i ri në kuadër të Gjykatës Supreme për Çështjet që lidhen me Agjensinë Kosovare të Mirëbesimit (më tutje, Kolegji i Veçantë për Çështjet e AKM-së), me qëllim të shqyrtimit të vendimeve të AKM-së. *Lexo RREGULLOREN E UNMIK-ut 2002/13, mbi Themelimin e Kolegjit të Veçantë të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjensinë Kosovare të Mirëbesimit (më tutje, Rregullorja për Kolegjin e Veçantë për Çështjet e AKM-së).* Edhe pas pezullimit të përkohshëm të procesit të privatizimit prej nëntorit 2003 deri në qershor 2004, Kolegji i Veçantë ka vazhduar të funksionojë dhe i ka regjistruar 95 kërkesa që nga qershori 2004 (norma e punës pritet të rritet tani e tutje). *Lexo Dokumenti Prezantues: i Shtyllës I për Polici dhe Drejtësi – UNMIK, të datës 16 (korrik 2004).* Kolegji i Veçantë për Çështjet e AKM-së vepron si shkallë e parë dhe e fundit gjyqësore dhe përbëhet nga 5 gjyqtarë (tre ndërkombëtare dhe dy kosovarë). Edhe pse është thënë se vepron nën Gjykatën Supreme, Kolegji i Veçantë për Çështjet e AKM-së e ka buxhetin dhe administratën e veçantë. *Lexo URDHËRESËN ADMINISTRATIVE PËR KOLEGJIN E VEÇANTË PËR ÇËSHTJET E AKM-së § 5.1.* Gjersa, Kolegji i Veçantë e ruan të drejtën që kërkesën e caktuar ta përcjellë në kompetencë të gjykatave tjera në Kosovë (*Lexo Rregulloren për Kolegjin e Veçantë për AKM-në § 4.2*), shqyrtimi në shkallë të parë mund të mos ofrojë garancione adekuate procedurale. Por, përgjithësisht, është lavdëruar puna e Kolegjit të Veçantë për Çështjet e AKM-së.

Nuk lejohet shqyrtimi gjyqësor i veprimeve administrative të kryera nga administrata ndërkombëtare. Ligji në fuqi ia siguron imunitetin UNMIK-ut duke theksuar se “UNMIK-u, pasuria, fondet dhe mjetet financiare të tij gëzojnë imunitet ndaj çdo procedure ligjore.” Rregullorja e UNMIK-ut 2000/47 MBI STATUSIN, PRIVILEGJET DHE IMUNITETIN E KFOR-IT DHE UNMIK-UT DHE PERSONELIT TË TYRE NË KOSOVË, § 3.1 [më tutje në tekst “RREGULLORJA MBI IMUNITETIN E KFOR-IT DHE UNMIK-UT]. Ekziston edhe dispozita identike për KFOR-in. *Id.* § 2.1. Shumica e të anketuarve kanë supozuar se imuniteti e përjashton ngritjen e padisë kundër vendimeve administrative të lëshuara nga këto dy subjekte.

Edhe pse UNMIK-u dhe KFOR-i janë të përjashtuar nga përgjegjësia, PSSP-ja dhe komandantët e shteteve kontribuese me trupa në KFOR, mund ta revokojnë imunitetin atëherë kur “imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa paragjykim në interes të UNMIK-ut (ose KFOR-it)”. *Id.* § 6. Prapë, UNMIK-u e ka themeluar Komisionin për Ankesa, i cili në pajtim me Rregulloren 2000/47, ekziston për vendosjen mbi “kërkesat e palës së tretë për humbjen apo dëmtimin dhe për lëndimet personale, sëmundjen apo vdekjen, e cila shkaktohet ose drejtëpërdrejtë i atribuohet ..., UNMIK-ut”. *Id.* § 7. UNMIK-u, vetëm në disa raste të rralla dhe për veprat më të rënda penale e ka hequr imunitetin. Ngjajshëm me këtë edhe KFOR-i në pajtim me rregulloren 2000/47, e ka themeluar Komisionin për Ankesa për t’i shqyrtuar kërkesat për kompensim. Shtabi i KFOR-it por edhe secili shtet kontribues me trupa – 39 prej tyre – i kanë eprorët për shqyrtimin e kërkesave. Përafërsisht nga 10 kërkesa mujore kryesisht trajtojnë aksidentet dhe lëndimet në komunikacion. Për shkak se nuk ka organ të apelit, shqyrtimi nga përfaqësuesi i shtabit të KFOR-it dhe shteti kontribues me trupa në KFOR, është i mundur pas 30 ditëve nga marrja e vendimit nga komisioni. Informimi i publikut për praninë e këtyre mjeteve juridike do kishte mundur të përmirësohej edhe më tej. Shumë prej të anketuarve as që kishin ditur për procedurën e paraqitjes së kërkesës pranë këtyre komisioneve. Ata që dinin për këtë procedurë i kishin shprehur dyshimet serioze lidhur me këto komisione, duke vërejtur se ata shpeshherë e nënvlerësojnë vlerën e objektit të kërkesës, dhe se paraqitësit e kërkesave kanë

shumë pak fuqi të negociimit. Disa të anketuar ishin fare të painformuar për atë se UNMIK-u në fakt ua kishte hequr imunitetin disa të punësuarve të vet për disa raste.

Faktor 7: Juridiksioni Gjyqësor ndaj Lirive Qytetare

Gjykata ka kompetencë (juridiksion) ekskluzive dhe përfundimtare ndaj të gjitha rasteve që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë qytetare.

| Përfundimi | Korrelacioni: Negativ | Trendi: ↔ |
|--|------------------------------|------------------|
| Në përgjithësi, gjykatat janë kompetente për të drejtat civile përveç për veprimet e KFOR-it apo UNMIK-ut. Mirëpo, gjyqësisë ende i mungon njohuria e punës për standardet e aplikueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. | | |

Analiza/Sfondi:

Organet gjyqësore janë kompetente për gjykimin e rasteve të dyshuara për shkelje të lirive civile (qytetare), përveç kur rastet kanë të bëjnë me veprimet e KFOR-it ose UNMIK-ut. Të dyja këto subjekte janë të mbrojtura përmes imunitetit penal-juridik dhe civilo-juridik. *Lexo RREGULLOREN PËR IMUNITETIN E KFOR-it dhe UNMIK-ut.*

Korniza Kushtetuese i ka inkorporuar dhe i ka bërë drejtpërdrejt të aplikueshme në Kosovë të drejtat dhe liritë e shpallura përmes një numri konventash europiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut: *Lexo KORNIZA KUSHTETUSE § 3.2, 3.3.* Ende vazhdon situata ku shumë gjyqtarë kosovarë nuk mbështeten në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut gjatë marrjes së vendimeve. Përkundër pjesëmarrjes së tyre në shumë trajnime dhe seminare për të drejtat e njeriut, gjyqtarëve si duket i'u mungon njohuria e punës për atë se si t'i aplikojnë këto standarde në rastet e tyre konkrete. Trajnimet e mëhershme nuk kanë ofruar udhëzime të mjaftueshme mbi zbatimin praktik të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në veçanti, gjyqtarët nuk e kuptojnë se si aplikohet praktika gjyqësore e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në gjykatat e Kosovës. Avokatët hezitojnë që t'i paraqesin argumentet e bazuara në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, për shkak se, gjyqtarët shpeshherë i refuzojnë argumentet e tilla. Për më shumë, mosqasja në Gjykatën Europiane është faktor dekurajues për gjykatat e Kosovës që ato ta zbatojnë KEDNJ.

Krahas Kornizës Kushtetuese, në shkurt të vitit 2004, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin e ri Kundër Diskriminimit i cili ofron mbrojtje gjyqësore për shkeljet e të drejtave civile. Ky ligj është shpallur në fuqi përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/32 në gusht të vitit 2004. Me këtë ligj, gjykatave i'u ipet kompetenca gjyqësore ndaj padive kundër diskriminimit, me kusht që paditësi paraprakisht t'i ketë përdorur të gjitha mundësitë e ankesës pranë organeve administrative. *Lexo LIGJIN KUNDËR DISKRIMINIMIT neni 7.* Nëse gjykata konstaton se ekziston vepra diskriminuese, ajo mund të shqiptojë sanksione, përfshirë, shpërblimin e dëmit material dhe personal, si dhe, dënimin me gjobë prej 500 euro deri në 10.000 euro, si dhe masën e detyrimit të të paditurit që të ndërmerrë masa për parandalimin e veprimeve të mëtutjeshme diskriminuese. *Id. 9.* Mirëpo, ligji i ri është kritikuar për shkak se, me të parashikohet kompetenca e gjërë për të gjitha gjykatat. Disa të anketuar, kanë rekomanduar që, për shkak të kompleksitetit të rasteve të tilla, ligji të ndryshohet për të parashikuar krijimin e gjykatave të specializuara për këto raste.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, në janar 2005, e ka miratuar Rezolutën dhe rekomandimin për "Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë", ku rekomandohet që UNMIK-u dhe KFOR-i, në bashkëpunim me Këshillin e Europës, ta themelojë Gjykatën për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, e cila do të ishte kompetente për shkeljet e supozuara të të drejtave të garantuara me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollin e saj. UNMIK-u është duke e shqyrtuar këtë rekomandim.

Në procedurë penale, gjyqtari i procedurës parprake ka kompetencë ekskluzive për “marrjen e vendimeve dhe zbatimin e veprimeve dhe masave...me të cilat kufizohen të drejtat dhe liritë themelore të personit”. KODI I PËRKOHSHËM I PROCEDURËS PENALE neni 9(3) (*shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/26*) (më tutje në tekst KPPP). Kur policia e arreston personin ose e privon nga liria përmes ndalimit, vetëm gjykata mund të vendosin për ligjshmërinë e arrestimit, ndalimit ose formave tjera të heqjes së lirisë. *Id.* nenet 211, 13(2). Personat e privuar nga liria, dërgohen menjëherë para gjyqtarit, jo më vonë se brenda 72 orëve nga arresti, në mënyrë që gjyqtari të vendosë për paraburgim të tyre. *Id.* nenet 14(2), 212. Njëra nga çështjet problematike në këtë fushë, ka të bëjë me të metat e vendimeve gjyqësore për urdhërimin e paraburgimit si dhe implikimet që ky problem mund t'i ketë ndaj të drejtës për të qenë i lirë. Shumica e vendimeve për caktimin e paraburgimit të shkruara nga gjyqtarët kosovar, dështojnë për sa i përket, arsyetimit të bazave për shqiptimin e paraburgimit. *Lexo Raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Shqyrtim i Sistemit të Drejtësisë Penale (prill 2003-tetor 2004): Krimi, Paraburgimi dhe Dënimi, me 16-17 (dhjetor 2004)* (më tutje, OSBE –*Krimi, Paraburgimi dhe Dënimi*). Për më tepër, është vërejtur se shkalla e dytë, përfshirë edhe Gjykatën Supreme të Kosovës, shpesh nuk i kanë arsyetuar vendimet e veta për vërtetimin e vendimeve për shqiptimin e paraburgimit. Në vend të kësaj, “është praktikë e zakonshme që gjykatat e shkallës së dytë vetëm “i u japin vulë” vendimeve kundër të cilave është ngritë ankesa, dhe vetëm i përsëritin fazat e njohura stereotipe.”. *Id.* f. 24. Një praktikë e tillë mund t'i kontribuojë marrjes së vendimeve të paarsyetuara dhe të cilat rezultojnë përfundimisht në cënim të të drejtës për liri. *Id.* f. 27. Kodi i Procedurës Penale, përpiket ta rregullojë problemin përmes minimizimit të shfrytëzimit të masës së paraburgimit duke parashikuar një numër masash tjera alternative për sigurimin e pranisë të të pandehurit në procedurë, përfshirë në mes tjerash, dorëzanimin dhe arrestin shtëpiak. *Lexo* nenin 268 të KPPP. Sipas kodit, gjykata mund ta urdhërojë paraburgimin në rrethana të caktuara, dhe vetëm nëse të gjitha masat tjera alternative nuk do të mjaftonin. KPPP neni 281. Ligji kërkon që të gjitha vendimet gjyqësore të kenë arsyetimin e fakteve vendimtare dhe bazën ligjore për paraburgim. *Id.* neni 283(1). Deri në këtë moment, shumë pak ka ndryshuar në praktikën e gjykatave për çështjet që u diskutuan më lartë.

Siç raportohet, gjykatave i u mungon njohuria adekuate për shqyrtimin e kërkesave për *habeas corpus*, për vërtetimin e ligjshmërisë së paraburgimit, kërkesë kjo e cila mund të ngritet në çdo fazë të procedurës parprake ose gjatë shqyrtimit gjyqësor. *Lexo* KPPP neni 286. Edhe pse ka pasur pak raste kur është bërë kërkesa *habeas corpus*, këto raste edhe pse të vogla për nga numri, e ilustrjnë dështimin e gjykatave për shqyrtimin e kërkesës, qoftë për shkak të injorancës ndaj ligjit apo për shkaqe tjera. *Lexo raportin e OSBE-së: Krimi, Paraburgimi dhe Dënimi*, f. 29.

Një nga fushat e shqetësimit është mungesa e shqyrtimit gjyqësor për paraburgimet jashtë gjyqësore të udhëruara nga KFOR-i dhe UNMIK-u. Sipas Rezolutës 1244 të KS të KB-ra, të gjitha paraburgimet e KFOR-it janë të autorizuara jo për t'i shërbyer zbatimit të ligjit, por, më tepër shërbejnë si mjet i jashtëzakonshëm për sigurimin e mjedisit të sigurtë dhe të mbrojtur. KFOR-i aktivizohet atëherë kur kriminaliteti i kalon kufijtë administrativ ose territorial, ose kur situata ngritet sa që Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) ose UNMIK-u nuk mund ta mbajnë nën kontrollë. Vet KFOR-i nuk ofron aq shumë mjete të mbrojtjes juridike për të drejtat e të burgosurve. Komitetit Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq gëzon qasje 24 orëshe te personat e burgosur; pastaj, të burgosurve u lejohet kontakti me avokatë dhe familje. Pas 72 orëve, kolegji vendosë nëse duhet vazhduar paraburgimin. I paraburgosuri mund të mbahet për kohë të pacaktuar por shqyrtimi intern i paraburgimit të tij bëhet çdo 30 ditë.

Sidoqoftë, edhe pse veprimet e KFOR-it dhe UNMIK-ut mbeten jashtë kompetencës gjyqësore, paraburgimet jashtëgjyqësore përdoren tani shumë më rrallë se sa në të kaluarën. Hera e fundit kur KFOR-ia ka paraburgosur ishte me 23 prill 2004, kur 23 persona janë paraburgosur për involvimin e tyre në trazirat e marsit. Shumica e këtyre individëve janë mbajtur më pak se nga një javë me ç'rast ose janë liruar ose i janë transferuar SHPK-së. Para kësaj situatë KFOR-i nuk ka bërë paraburgime gjatë disa muajve paraprak. Ngjajshëm me këtë, paraburgimet ekzekutive të urdhëruara nga PSSP-ja më heret kanë paraqitur probleme por si duket kjo tashmë ka mbetë

vetëm si një e kaluar⁶. Edhe pse asgjë nuk e ndalon PSSP-në ta bëjë një gjë të tillë, që nga viti 2001 nuk është urdhëruar asnjë paraburgim ekzekutiv.

Mungesa e mjetit juridik gjyqësor ngritë shqetësimet në lëndët civile. Ombudspersoni e ka ngritur këtë çështje në lidhje me rastin e shkarkimeve të disa të punësuarve kosovarë nga Hekurudhat e UNMIK-ut. Asnjëri nga të shkarkuarit nuk ka pranuar ndonjë letër me të cilën do të shpjegohej baza e shkarkimit të tyre; mirëpo imuniteti të cilin e gëzon UNMIK-u nuk i lejon ish të punësuarit që ta kontestojnë në gjyq largimin e tyre nga puna.

Faktori 8: Sistemi i Vendosjes Sipas Ankesës (Procedura e Apelit)

Vendimet gjyqësore mund të kthehen vetëm përmes procedurës gjyqësore të ankesës (procedurës së apelit).

| Përfundimi | Korrelacioni: Neutral | Trendi : ↔ |
|--|------------------------------|-------------------|
| Përderisa vendimet gjyqësore kthehen vetëm në procedurën gjyqësore për vendosje sipas ankesës, ende mbetet mundësia për paraburgime jashtëgjyqësore. | | |

Analiza/Sfondi:

Ligji u garanton palëve ose përfaqësuesve të tyre, të drejtën e ankimit kundër secilit aktgjykim të lëshuar nga gjykata e shkallës së parë. Lexo KPPC neni 398; LIGJI I PROCEDURËS CIVILE neni 348 (G.Z. RSFJ, 4/77, e ndryshuar me G.Z. RSFJ nr. 36/80 dhe 69/82) (më tutje në tekst, LPC). Në disa raste, parashikohet edhe e drejta e ankesës ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë. Lexo KPPC neni 430.

Me ligj, gjykatat komunale e kanë kompetencën e përgjithshme të shkallës së parë për shumicën e veprave penale. Kompetencë e gjykatave komunale është, të vendosin në shkallë të parë, për veprat penale për të cilat me ligj është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet, përveç kur ligji e cakton gjykatën e qarkut si kompetente për gjykimin e një shkelje të veçantë. Lexo LIGJIN MBI GJYKATAT E RREGULLTA, nenin 26; KPPP neni 21(1). Gjykatat komunale janë kompetente edhe për gjykimin e shumicës së kontesteve civile juridike, përfshirë, kontestet pronësore juridike, ato nga marrëdhëniet e punës, ushqimit, ruajtjes, mbajtjes ligjore të fëmijëve, kontestet nga kontrata e qirasë, kontestet nga marrëdhëniet banesore dhe trashëgimore. Lexo LIGJIN MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 26. Gjykatat komunale zakonisht gjykojnë në trupe gjyqësore të përbëra nga një gjyqtar profesional dhe dy ndihmësgjyqtarë; mirëpo veprat më të lehta penale (për të cilat parashikohet dënimi me gjobë ose më së shumti tre vjet burgim) dhe disa konteste civile juridike, i gjykon gjyqtari i vetëm. Lexo KPPP neni 22; LPP neni 43.

Kompetencë e gjykatave të qarkut është të vendosin për ankesat kundër vendimeve të gjykatave komunale që janë marrë në shkallë të parë. Lexo LIGJIN MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 29; KPPP neni 23(2). Krahas kësaj, gjykatat e qarkut janë kompetente edhe për zhvillimin e gjykimeve në shkallë të parë për veprat penale, për të cilat parashikohet dënimi më i gjatë se pesë vjet burgim, por edhe për disa çështje civile juridike, siç janë kontestet për vërtetimin e atësisë ose kontestet për nga të drejtat mbi pronën intelektuale. Lexo LIGJIN MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 29; KPPP neni 23 (1). Gjykatat e qarkut, gjykojnë në kolegje me përbërje të ndryshme, varësisht nga lloji i procedurës që zhvillohet (në shkallë të parë ose sipas ankesës). Lexo KPPP neni 24; LPP neni 44.

⁶ Nën ndikimin e Ombudspersonit, PSSP e ka krijuar Komisionin për Shqyrtim të Paraburgimeve Ekzekutive për Shqyrtimin e Paraburgimeve Jashtë Gjyqësore. *Lexo në përgjithësi* Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/18, mbi themelimin e Komisionit për Shqyrtim të Paraburgimeve Jashtë Gjyqësore të bazuara në urdhërat ekzekutiv. Ky komision e ka përfunduar mandatin në nëntor të vitit 2001.

Gjykata Supreme e Kosovës ushtron kompetencën më të lartë gjyqësore në Kosovë. Ajo vendosë për ankesat kundër vendimeve të gjykave të qarkut dhe për vendimet e Gjykatës Ekonomike të Qarkut⁷ që janë marrë në shkallë të parë. Lexo LIGJIN MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 31; KPPP neni 25(1). Gjithashtu kjo gjykatë ushtron kompetencë të kufizuar të shkallës së tretë, për shembull për rastet kur gjykata e qarkut shqipton dënimin me burg afatgjatë (ose e vërteton aktgjykimin e tillë nga gjykata komunale) ose kur gjykata e qarkut e prishë aktgjykimin lirues të gjykatës komunale dhe bjen aktgjykim dënues në vend të tij. Lexo KPPP neni 430. Varësisht nga lloji i kompetencës të cilën e ushtron Gjykata Supreme, ajo vendosë dhe e zhvillon procedurën në kolegje prej tre deri në pesë gjyqtarë profesionistë. Id. neni 26; LPP neni 45.

Kompetencë e gjykatave për kundërvajtje janë veprat penale të cilat e bartin dënimin me burg deri në 60 ditë. Të gjitha rastet i gjykon gjyqtari i vetëm. Gjykata e lartë për kundërvajtje, gjykon në kolegje prej tre gjyqtarëve dhe e ushtron kompetencën ekskluzive dhe përfundimtare të shkallës së dytë.

Në të vërtetë që nga IRSGJ-ja i vitit 2002, në Kosovë, vendimet gjyqësore janë prishur vetëm në procedurën gjyqësore të vendosjes sipas ankesës. Para gjykatave të qarkut janë ngritur ankesa të shumta kundër vendimeve të gjykatave komunale. Së këndejmi, në vitin 2002, përafërsisht ndaj 28% të të gjitha aktgjytimeve civile dhe ndaj 35% të aktgjytimeve penale, që janë marrë nga gjykatat komunale, është ngritur ankesë pranë gjykatave të qarkut. Ngjajshëm me këtë, ndaj një numri të madh të vendimeve të shkallës së parë, që janë marrë nga gjykatat e qarkut në procedurë penale, është ngritur ankesë pranë Gjykatës Supreme (38% në vitin 2002), aq sa është numri i vendimeve që janë marrë nga Gjykata Ekonomike e Qarkut (62% në vitin 2002). Për dallim nga kjo, vetëm ndaj një numri të papërfillshëm të aktgjytimeve civile të Gjykatave të Qarkut, që janë marrë në shkallë të parë, është ngritur ankesa para Gjykatës Supreme (përafërsisht 2%, në vitin 2002), dhe vetëm ndaj një numri të vogël vendimesh që janë marrë nga gjykatat kundërvajtëse është bërë ankesë pranë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje (më pak se 2% në vitin 2002). Lexo *Sistemi Gjyqësor i Kosovës, Vlerësimi dhe Opcionet e Propozuara (2003-2004) faqe 9-31*, nga Këshilli i Evropës dhe Departamenti i Drejtësisë i SHBA-ve, (më tutje në tekst, Sistemi Gjyqësor i Kosovës, KE/DDSHBA). Procedura sipas ankesës në gjykatat e qarkut bën pjesë përafërisht me 30% të punës së përgjithshme (normës së punës). Në Gjykatën Supreme shqyrtimi i ankesave kundër aktgjytimeve penale, civile dhe ekonomike të shkallës së parë bëjnë pjesë me 18.4%, 2.4%, gjegjësisht 8.3% të normës së përgjithshme të punës, ndërsa shqyrtimi në shkallë të tretë i ankesave përbën më pak se 1% të normës së përgjithshme të punës. Id. faqe 30-31.

Nga ana tjetër, ende ekziston mundësia që KFOR-i dhe UNMIK-u t'i ushtrojnë autorizimet e tyre për urdhërimin e paraburgimit jashtëgjyqësor, që efektivisht të vendosin diçka tjetër nga vendimi i plotëfuqishëm i gjykatës. Shih faktorin 7 për hollësi të mëtutjeshme lidhur me urdhërat jashtëgjyqësor për paraburgim. Mirëpo, që nga viti 2001, PSSP-ja nuk ka urdhëruar asnjë paraturim jashtëgjyqësor me të cilin e shfuqizon aktvendimin e gjykatës për lirimin e të dyshuarit nga paraburgimi, ndërsa paraburgimet e KFOR-it asnjëherë nuk i kanë prishur aktgjykimet gjyqësore. Sjellja ngurruese e KFOR-it dhe UNMIK-ut gjatë viteve të kaluara, e sidomos si përgjigje ndaj trazirave të marsit sugjerojnë se këto subjekte janë duke i interpretuar më ngushtë autorizimet e veta.

⁷ Gjykata ekonomike e qarkut është gjykatë e shkallës së parë për të gjitha kontestet ndërmjet personave juridik (ndërmarrjeve ekonomike), si dhe pranë tyre zhvillohet procedura e falimentimit dhe procedura penale për disa delikte ekonomike. Lexo LIGJIN MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 30.

Faktori 9: Mospërfilljet/ Thirrjet/ Ekzekutimet

Gjyqtarët kanë autorizime adekuate për thirrje, qortim për mospërfillje, ose për ekzekutim. Këto autorizime respektohen ose përkrahen nga degët tjera të pushtetit.

| Përfundimi | Korrelacioni: Negativ | Trendi : ↔ |
|--|-----------------------|------------|
| Gjykata ka autorizime të mjaftueshme për thirrje dhe qortim për mospërfillje, por autorizimet për ekzekutim duhet të fuqizohen më shumë. Mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile në veçanti është bërë problem serioz. | | |

Analiza/Sfondi:

Organet gjyqësore të Kosovës kanë autorizime për thirrje, qortim dhe ekzekutim. Kryetari i trupit ka autorizime të kontrolloj procedurën dhe t'i sanksionojë palët, dëshmitarët dhe të tjerët brenda gjykatores. Dëshmitari i cili nuk paraqitet mund të detyrohet të paraqitet dhe mund të gjobitet. Lexo KPPP neni 167; LPP neni 248; URDHËRESA ADMINISTRATIVE PËR KOLEGJIN E VEÇANTË PËR ÇËSHTJET e AKM-së neni 38.7. Për dallim nga ligji i mëparshëm, Kodi i ri i Procedurës Penale parashikon, krahas gjobës, edhe dënimin me burg për dëshmitarin i cili paraqitet por nuk dëshmon. Lexo KPPP neni 167. Mundësia e dënimit me burg për dëshmitarin i cili paraqitet dhe nuk jep dëshmi, parashikohet edhe me Ligjin për Procedurën Kontestimore. Lexon nenin 248. Edhe ekspertët në cilësinë e dëshmitarit, të cilët nuk dëshmojnë mund të detyrohen dhe në disa raste edhe të gjobiten. Lexo KPPP neni 177; LPP neni 255. Zvarritja e qëllimshme e procedurës, është gjithashtu e dënueshme me gjobë. Lexo KPPP neni 146. Gjykata me urdhër gjyqësor, mund të kërkojë nga pala në procedurë ose nga pala e tretë që brenda afatit të caktuar, ta paraqes dokumentin e caktuar në posedim. Lexo LPP nenin 233; URDHËRESËN ADMINISTRATIVE PËR KOLEGJIN E VEÇANTË PËR ÇËSHTJET e AKM-së neni 43.4. Përfundimisht, gjykata është e autorizuar të merr vendim në mungesë, nëse pala e paditur nuk paraqitet në seancë, nuk e pranon kërkesëpadinë, ose nuk e paraqet mbrojtjen kundër padisë. Lexo LPP nenin 332; URDHËRESËN ADMINISTRATIVE PËR KOLEGJIN E VEÇANTË PËR ÇËSHTJET e AKM-së, neni 49.

Kryetari i kolegjit e ka për obligim të sigurojë rend në sallën e gjykimit, gjatë zhvillimit të procedurës. Lexo KPPP neni 335; LPP neni 317. Nëse palët, mbrojtësit, dëshmitarët dhe të tjerët e pengojnë procedurën, kryetari i trupit gjykues mund t'u tërheq vërejtjen, ta largojë nga gjykatorja ose ta dënojë me gjobë deri në 1000 euro, edhe pse sanksionet kundër të akuzuarit janë të kufizuara vetëm në vërejtje dhe largim nga gjykimi. Lexo KPPP neni 336; LPP neni 318; URDHËRESËN ADMINISTRATIVE PËR KOLEGJIN E VEÇANTË PËR ÇËSHTJET E AKM-së §§ 33.3-33.4. Gjyqtari mund t'ia mohojë përfaqësimin avokatit mbrojtës, nëse ky vazhdon ta prishë rendin në gjykatore. Lexo KPPP neni 336. Për sanksionet kundër mbrojtësit ose prokurorit, njoftohet Oda e Avokatëve të Kosovës, respektivisht, prokurori epëror. *Id*; LPP neni 318.

Përkundër këtyre autorizimeve, mosparaqitja e të akuzuarit, dëshmitarëve madje edhe prokurorit në procedurë, rezulton në zvarritjen e gjykimit të rasteve penale. Disa vlerësime theksojnë se afër 30% e gjykimeve shtyhen për këtë arsye, dhe në shumicën e madhe të rasteve, të akuzuarit janë ata të cilët mungojnë vazhdimisht. Lexo raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë: *Shqyrtimi i Sistemit të Drejtësisë Penale: Administrimi i Drejtësisë në Gjykatat Komunale*, 14 (mars 2004) (raporti i OSBE-së për Gjykatat Komunale). Të anketuarit ua kanë mveshur këto zvarritje, problemeve me komunikimin e thirrjeve dhe caktimin e prokurorëve nëpër qendra regjionale dhe jo në gjykatat komunale specifike.

Në shumë komuna, gjykatat janë mbështetur në Shërbimin Policor të Kosovës për t'i detyruar dëshmitarët për t'u paraqitur në gjykatë si dhe për t'i komunikuar thirrjet. Sidoqoftë disa të anketuar kanë deklaruar se policia vetëm formalisht i ndjek shkelësit dhe se angazhimet e policisë nuk janë të sigërtë e as të përpikta. Disa komuna kanë raportuar se nuk është më problem, të komunikohen thirrjet nëpër enklava, dhe se nuk ka nevojë për mbështetje policore në këtë drejtim. Mirëpo, komunat tjera, veçanërisht Mitrovica Veriore paraqet një skenar më të komplikuar për shkak të problemeve të sigurisë dhe tensioneve të shtuara ndëretnike pas dhunës së trazirave të marsit. Vazhdon të ekzistojë problemi i paraqitjes së dëshmitarëve ose të akuzuarve në gjykatë. Të anketuarit deklaruan se problemet e sigurisë shpesh e pengojnë komunikimin për në enklavat serbe, ndërsa shërbimi postar refuzon marrjen e përgjegjësisë për dorëzimin e shkresave nëpër enklava. Si pasojë e kësaj, gjykatat në Mitrovicën Veriore varen nga policia e KB-së për t'i gjetur dëshmitarët dhe komunikuar thirrjet. Kjo zakonisht e prolongon tërë procedurën për shkak se policia e KB -së nuk e njeh terrenin dhe njerëzit. Në disa raste, personi i thirrur i ka mashtruar policinë duke iu thënë atyre për veten se kishte vdekur. Problem tjetër për dorëzimin e thirrjeve është gjetja e adresave për shkak të ndërrimit të tyre pas luftës. Lexo Raportin e OSBE-së “*Shqyrtimi i Sistemit të Drejtësisë Penale*”, faqe 15. Nëse policia e UNMIK-ut nuk është në gjëndje t'i dorëzojë thirrjet, kryetari i gjykatës përmes Gjykatës Supreme mund të kërkojë ndihmë nga Shërbimi Policor i Kosovës.

Nëse i akuzuari kryen vepër penale gjatë seancës kryesore, siç është shpifja ose deklarimi i rrejshëm, sanksioni nuk shqiptohet menjëherë por në një procedurë të veçantë nga një gjyqtar tjetër. Gjykimi mund të shtyhet për ta gjykuar veprën ose gjyqtari do të presë deri në përfundim të seancës kryesore. Lexo KPPP, neni 85, 338. Sipas të anketuarve, gjykatat ngurrojnë t'i shqiptojnë masat e tilla për shkak të ngarkimit të procedurës. Sidoqoftë, të anketuarit kanë deklaruar se shumica e njerëzve sillen dëgjueshëm në gjykatore. Njëri nga të anketuarit ka vlerësuar se ai i ka vërejtur vetëm dy shkelje të tilla brenda periudhës pesëvjeçare.

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale ofron udhëzimet për ekzekutimin e sanksioneve penale. Lexo KPPP nenet 135-41. Nëse gjoba nuk mund të realizohet me mjete tjera, Kodi i Procedurës Penale i referohet neni 39 të Kodit Penal i cili parashikon alternativa të ndryshme për sigurimin e pagesës së gjobës, siç janë pagesa e gjobës me këste, puna në dobi të përgjithshme, ose burgimi – një ditë për secilën shumë prej 15 eurosh të gjobës por jo më gjatë se gjashtë muaj. *Id.* neni 136. Dispozita më të hollësishme për ekzekutimin e sanksioneve penale “do të parashikohen në një ligj tjetër”, *Id.* neni 135. Edhe pse është përgatitur propozim rregullorja për ekzekutimin e sanksioneve penale, deri në shpalljen e saj në fuqi, në zbatim është Ligji Jugosllav për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale⁸...

Përmbartimi i aktgjytimeve civile vazhdon të mbetet problem i madh. Që nga viti 2002, numri i vendimeve të paekzekutuara të lëndëve civile është rritur dhe shndërruar në një krizë të pashmangshme. Gjykatat komunale kryesisht janë kompetente për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile dhe penale, ndërsa Gjykata Ekonomike e Qarkut ka kompetencë ekskluzive për ekzekutimin ndërmjet dy ndërmarrjeve private. Pranë gjykatave komunale është grumbulluar një numër i madh i lëndëve për ekzekutim⁹, me mesataren prej 18% të normës së përgjithshme të punës, edhe pse disa gjyqtarë kanë pohuar se lëndët për ekzekutim marrin deri në 50% të normës

⁸ Veç kësaj, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale – i Kuvendit të Kosovës ka hyrë në fuqi nga UNMIK-u gjatë nëntorit 2004 dhe do të fillojë zbatimin në shkurt 2005.

⁹ Gjykata Ekonomike e Qarkut i ka pranuar 550 lëndë për ekzekutim që nga viti 1999, dhe 197 janë në pritje të ekzekutimit për shkak të vërejtjeve të parashtruara nga debitorët. Lexo NCSF/IFES, *Ekzekutimi i Aktgjytimeve Civile*, faqe 33.

së tyre të punës. Lexo Violaine Autheman, Angana Shah & Keith Henderson, Fondacioni ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES), *Ekzekutimi i Aktgjykimeve Civile në Kosovë, faqe 7* (Qendra Nacionale për Gjykatat Shtetërore, Aktivitetet për Reformimin e Sistemit Gjyqësor në Kosovë, shtator 2004 (NCSC/IFES, *ekzekutimi i aktgjykimeve civile*); gjithashtu lexo OSBE – *Shqyrtimi për Gjykatat Komunale, Aneksi 3, Tabela 4-5.*

NORMA E LËNDËVE PËR EKZEKUTIM NË GJYKATAT KOMUNALE TË KOSOVËS

| | 2002* | 2003 | Q1-2004 |
|--|--------|--------|---------|
| Gjithsejt numri i lëndëve të pakryera | 35.005 | 46.964 | 42.844 |
| Të grumbulluara: numri i lëndëve të pakryera nga vitet e kaluara | 13.135 | 30.896 | 39.304 |
| Numri i lëndëve të paraqitura | 21.870 | 16.068 | ... |
| Numri i lëndëve të kryera | 3.750 | 7.660 | ... |
| Efikasiteti: shkalla e lëndëve të kryera | | | |
| Gjithsejt raste të pakryera | 10.7 | 16.3 | ... |
| Lëndët e paraqitura | 17.1 | 47.7 | ... |

*Këta numra përfshijnë ekzekutimin e aktgjykimeve civile dhe penale

Burimi: OSBE *Shqyrtimi i Gjykatave Komunale, aneksi 3 tabelat 4-5; NCSC/IFES, Ekzekutimi i Aktgjykimeve Civile, faqe 9* (për shënimet e vitit 2004).

Siç mund të shihet më lart, përkundër rritjes së dyfishtë të numrit të përgjithshëm të lëndëve për ekzekutim të kryera në vitin 2003, gjykatat, për një vit, po e kryejnë vetëm një pjesë të vogël të lëndëve për ekzekutim. Të njëjtën kohë, disa gjykata duket se janë më efikase në zgjidhjen e lëndëve për ekzekutim. Për shembull, afërsisht 20% e lëndëve kanë mbetur të pazgjidhura në Gjykatën Komunale të Prishtinës, ndërsa më pak se 5% kanë mbetur në gjykatat komunale të Mitrovicës, respektivisht Gjilanit deri në fund të vitit 2003. Lexo NCSC/IFES, *Ekzekutimi i Aktgjykimeve Civile, faqe 9.*

Të anketuarit e kanë identifikuar problemin si mungesë të kornizës ligjore funksionale e cila e ndërlidhë gjyqtarin ekzekutues me punëdhënësit, bankat dhe kreditorët. Ligji i vjetër i Jugosllavisë, (LPE) i cili e rregullon procedurën e ekzekutimit të vendimeve është i vjetër dhe i kufizon mundësitë e gjyqtarëve për t'i ekzekutuar aktgjykimet civile. LPE fuqimisht e mbron debitorin dhe gjykatave u ofron mjete të kufizuara për sanksionimin e sjelljeve të palëve. Së këndejmi, ky ligj u mundëson debitorëve të paraqesin kundërshtime gjatë secilës fazë të procedurës së ekzekutimit. Lexo LPE nenet 48, 50, (G.Z. RSFJ 20/78, me ndryshimet nga G.Z. RSFJ 6/82 dhe 74/87). Siç raportohet, debitorët shpeshherë e shfrytëzojnë mundësinë e kundërshtimit duke bërë parashtrësia të pavlera dhe të pa baza, shpesh vetëm sa për ta zvarritur ekzekutimin ose deri sa të gjinden paratë për pagesë. Lexo NCSC/IFES, *Ekzekutimi i Aktgjykimeve Civile, faqe 15, 22.* Veç kësaj, LPE edhepse ofron mekanizma të ndryshëm për urdhërimin e konfiskimit të mjeteve monetare, në të nuk ka asgjë lidhur me procedurën e ekzekutimit të urdhërit në praktikë. Për shembull, nuk është e qartë në LPE nëse bankat janë të obliguara ta respektojnë vendimin për ekzekutim për zbulimin e llogarive bankare ose për të ngrirë ato mjete në xhirollogari, për shkak se ligji e parasheh këtë obligim vetëm për Shërbimin aktualisht jo ekzistues të Kontabilitetit Shoqëror. Lexo LPE neni 266(4). Ngjajshëm me këtë nuk ka procedurë ligjore për punëdhënësin që t'i ngrijë rrogat e punëtorëve gjë që në teori LPE e lejon këtë, *Id.* 119.

Krahas zbrastësirave në kornizën ligjore, të anketuarit i kanë identifikuar edhe pengesat tjera në ekzekutimin e aktgjykimeve civile, dhe të cilat janë ripërsëritur edhe në raportin e IFES/NCSC-së. Së pari gjykatave u mungon numri i mjaftueshëm i personelit për t'ia dalë me këtë normë të tejngarkuar. Në vitin 2003, Departamenti i Administratës Gjyqësore (DAGJ) sipas rekomandimit të OSBE-së i ka angazhuar për secilën gjykatë nga një referent për ekzekutime. Para vitit 2003, shumë prej gjykatave nuk kishin referentë të ekzekutimeve. Më pas, shumica e madhe e lëndëve për ekzekutim kanë të bëjnë me ekzekutimin e faturave të ndërmarrjeve për energji elektrike, telefon dhe ujë e që vlerësohet se përbëjnë 60% deri në 80% të normës. Lexo NCSC/IFES, *Ekzekutimi i Aktgjykimeve Civile, faqe 8.* Siç është raportuar, procesi i ekzekutimit të këtyre

rasteve për gjykatat është relativisht i lehtë, duke sugjeruar me këtë se, ndërmarrjet e këtyre shërbimeve mund t'i shfrytëzojnë gjykatat si të jenë shërbim i tyre për mbledhjen e pagesave, në vend që të shfrytëzohen vetëm si mjet i fundit. Studimi i IFES/NCSC ka rekomanduar që ndërmarrjet e shërbimeve komunale ta marrin përgjegjësinë për këto raste për ta lehtësuar barrën e gjykatave, ose që ndërmarrjet t'i dërgojnë disa punëtorë të tyre nëpër gjykata për të shërbyer si referentë të specializuar për sigurimin e pagesave për shërbimet publike. *Id. faqe 38.* Me qëllim të ekzekutimit të aktgjykimeve të mbetura, gjykatat duhet të kenë më shumë automjete për t'iu mundësuar referentëve për ekzekutim të udhëtojnë anekënd Kosovës. Për momentin, janë kreditorët ata që ju ndihmojnë gjykatave duke iu ofruar atyre mjete të transportit. *Id. faqe 40.* Një pengesë tjetër për ekzekutimin e aktgjykimeve është shkëmbimi i dobët i informatave dhe bashkëpunimi i dobët në mes të gjykatave, institucioneve, bankave dhe debitorëve. Në këtë drejtim, derisa bankat ngadalë kanë filluar të implementojnë mekanizma joformal të bashkëpunimit me gjykatat me qëllim të zbatimit të vendimeve për ekzekutim kundër xhironlogarive bankare, një bashkëpunim i tillë nuk ekziston me punëtorët e debitorëve. *Id. f. 18, 24.*

Disa të anketuar besojnë se disa rreze mund të luajnë një rol të pengimit të ekzekutimit të aktgjykimeve. Për shembull, gjyqtarët shpesh janë hezitues për zbatimin e disa masave siç janë ndalimi i ndërtimit të kundërligjshëm, për shkak të rrezikut real dhe të përceptuar nga njerëzit e fuqishëm të involvuar në këtë punë. Siç ka theksuar një i anketuar, "mjafton që gjyqtari të imagjinoj, e nuk ka nevojë që t'i dërgohet letra."

Realizimi i taksave gjyqësore vazhdon të jetë problem për shkak se nuk ka rregullore me të cilën caktohen taksat në mënyrë të unifikuar për tërë Kosovën. Në vend të kësaj, shumica e regjioneve i kanë caktuar skemat e pavarura të taksave (pagesave), pra rregullimit dhe realizimit *ad hoc* të taksave i mungon transparencja, prandaj edhe mbetet fushë potenciale për keqpërdorime. DAGJ-i dhe NCSC-ja janë duke i ndihmuar DD-në në procesin e hartimit të Skemës Uniforme të Taksave.

III. Resurset Financiare

Faktori 10: Të Hyrat Buxhetore

Gjykatat kanë mundësi të ndikimit në sasinë e të hollave që i ndahen asaj nga dega e legjislativit ose ekzekutivit, dhe njëherë pasi t'i ndahen mjetet, gjyqësia mbanë kontroll mbi buxhetin e vet dhe për mënyrën se si shpenzohen ato.

| Përfundimi | Korrelacioni: Negativ | Trendi : ↔ |
|---|------------------------------|-------------------|
| Gjyqësia ka ndikim të kufizuar në procesin buxhetor dhe nuk ka kontroll të drejtpërdrejtë ndaj mjeteve të alokuara (ndara). | | |

Analiza/Sfondi:

Gjyqësori i ka tejet të kufizuara mundësitë e ndikimit në ndarjet buxhetore dhe nuk ka kontroll ndaj shpenzimeve të veta pasi t'i ndahen mjetet. Disa të anketuar janë deklaruar se përjashtimi i tyre efektiv nga çështjet buxhetore rezulton në një kontroll të padrejtë të ekzekutivit mbi gjyqësorin.

Janë dy buxhete të ndara për gjyqësinë, një i përgatitur për Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut (DD-së) dhe një për Departamentin e Administratës Gjyqësore (DAGJ). Buxheti i DD-së, si kompetencë e PSSP-së përgatitet nga administrata e UNMIK-ut pa u konsultuar fare gjyqësori. Buxheti i DD-së i mbulon rrogat e gjyqtarëve ndërkombëtarë, të punësuarve në DD dhe rrogat e

disa të punësuarve në DAGJ, ndërsa buxhetin e DAGJ-it e përgatitë DD-ja. Së pari, sektori i financave të DAGJ-it e përgatitë planin për nevojat e gjyqësisë në bashkëveprim me kryetarët e gjykatave dhe administratorët e gjykatave. Ky plan i dërgohet DD-së, i cili mund ta ndryshojë vlerën e kërkuar. Më pas, DD-ja ia përcjell kërkesën Ministrisë së Financave, e cila ose e aprovon ose e zvoglon vlerën e kërkuar.

Në vitin 2004, vlera e përgjithshme buxhetore për gjykatat e Kosovës ishte 17.3 milion euro, ose përafërsisht 2.1% e buxhetit të përgjithshëm për vitin 2004. Sipas përfaqësuesve të intervistuar të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, kishte pasur propozim që buxheti i gjykatave të shkurtohet për 1 milion euro për vitin 2005. Në përgjithësi, buxheti i DAGJ-it i mbulon shpenzimet e gjyqësisë vendëse.

Në përgjithësi buxheti i DAGJ-it i mbulon shpenzimet lidhur me gjyqësorin vendor. Ky përbëhet nga tri komponenta kryesore: pagat, mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale. Bazuar në kompetencat e transferuara në IPVQ, DAGJ-i tani është përgjegjës për realizimin e buxhetit për administrimin e gjyqësisë vendëse. Sidoçoftë, UNMIK-u e ka ruajtur një formë të kontrollit ndaj administrimit të buxhetit të DAGJ-it. Shefi kosovar i DAGJ-it e mbikqyrë administrimin e buxhetit, mirëpo, shpenzimet duhet të autorizohen nga Zyrtari Ndërkombëtar i Financave të DAGJ-it. Arsyet e dhëna për ruajtjen e kësaj shkalle të mbikqyrjes ndërkombëtare ishin shqetësimet për ndikimet politike në vendimet buxhetore.

Në praktikë, shumë të anketuar kanë deklaruar se shumë pak konsultime përbajtësore bëhen me gjyqtarë në lidhje me krijimin ose administrimin e buxhetit, edhe pse DAGJ-i është konsultuar me secilin kryetar dhe administrator të gjykatave për të shpjeguar buxhetin e ri të hartuar për vitin 2005. Për shembull, gjykatat pohojnë se buxheti duhet të përfshijë më shumë vende pune në gjykata. Shumë gjyqtarë e kanë komentuar joefikasitetin në administrimin e buxhetit, që ka rezultuar me periudha të gjata të pritjes për furnizime, për shkak se të gjitha kërkesat e gjykatave për fonde, tani i proceson drejtpërdrejtë DAGJ. Pagesat për ndihmësgjyqtarë, avokatët e caktuar sipas detyrës zyrtare dhe ekspertëve të thirrur nga gjykatat, siç dihet kanë qenë jashtëzakonisht të ngadalshme dhe në disa raste nuk janë paguar fare, duke rezultuar me probleme në procedimin e lëndëve (p.sh., ekspertët mund të mos i dorëzojnë raportet deri sa mos të paguhen). Disa ekspertë kanë refuzuar të punojnë për gjykatat për shkak të mospagesës. Si reagim ndaj kësaj situatë, DAGJ-i ka ndërmarrë hapa për përsheptimin e procesit dhe kjo është bërë, kështu që, tani pagesat transferohen më shpejtë.

Një problem tjetër është mungesa e skemës së standardizuar të tarifave gjyqësore. Në disa regjione janë bërë nisma drejt krijimit të tarifave të standardizuara regjionale, përndryshe këto tarifa dallojnë në nivel të Kosovës. Për momentin, ekziston një diferencë e konsiderueshme e tarifave në mes gjykatave. Pagesa minimale sillet prej 5 euro deri në 25 eur. *Lexo NCSC/IFES, Ekzekutimi i Aktgjykimeve Civile, faqe 40.* Momentalisht NCSC-ja është duke punuar me DAGJ-in për ta zhvilluar një skemë të Unisuar Tarifore. Për momentin, gjyqësia nuk i mbanë pagesat; të gjitha pagesat e mbledhura i përcillen thesarit të UNMIK-ut.

Një kritikë tjetër të strukturës së tanishme buxhetore i është bërë edhe qeverisjes së dyfishtë të gjykatave. DD-ja i zhvillon politikat gjyqësore, ndërsa DAGJ-i e bartë përgjegjësinë për administrimin e politikave për shkak se kjo i përket gjyqësisë vendore. Në praktikë kjo ndarje e detyrave ka hasë edhe në ndarje të vullnetit (gatishmërisë) ku dora administruese nuk është gjithmonë në të njëjtën vijë me krahun e politikave. Për shembull, administratori i gjykatës dhe personeli tjetër administrativ i përgjigjen DAGJ-it, por kryetari i gjykatës, *de jure* autoriteti më i lartë, i përgjigjet DD-së. Për shkak se DAGJ-i udhëhiqet nga një parti e caktuar politike, personeli i punësuar nga DAGJ konsiderohen si i "punësuar politik", të cilët varen nga vullneti politik. Kur interesat e partisë politike kanë ndryshuar nga ato politika të DD/KB-së, atëherë kanë pasuar përplasjet.

Një shqetësim tjetër është mungesa e koordinimit në mes të donatorëve dhe hartuesve të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Për shkak se donatorët kryesisht nuk konsultohen me

përpiluesit e buxhetit, projektet mund të mos jenë të qëndrueshme pasi që fondet e donatorëve të jenë përdorur.

IPVQ-ja e Kosovës, eventualisht do t'i merr përgjegjësitë për përgatitjen dhe administrimin e procesit buxhetor. Në diskutim e sipër janë bartjet e mëtutjeshme të kompetencave nga DD-ja tek IPVQ-ja, përfshirë këtu edhe përgjegjësitë buxhetore. Pa marrë parasysh formën të cilën e merr pranim-dorëzimi, përpiluesit e BKK-së duhet t'i nënshtrohen trajnimit për hartimin e buxhetit të organeve gjyqësore.

Faktori 11: Mjaftueshmëria e Pagave të Gjyqësorit

Rrogat e gjyqësisë kryesisht janë të mjaftueshme për të tërhequr dhe mbajtur gjyqtarë të kualifikuar, duke iu mundësuar atyre mbajtjen e familjeve të tyre dhe të jetojnë në një ambient të sigurtë dhe pa pasë nevojë t'u drejtohen burimeve tjera të të ardhurave.

| Përfundimi | Korrelacioni: Negativ | Trendi : ↔ |
|---|------------------------------|-------------------|
| Rrogat në gjyqësi janë jashtëzakonisht të ulëta dhe nuk janë të mjaftueshme për t'i tërhequr ose mbajtur gjyqtarët e kualifikuar ose t'i përkrahin familjet e tyre. Rrogat e ulëta shpiejnë në dobësim të moralit dhe i hapin rrugë korrupsionit. | | |

Analiza/Sfondi:

Rrogat e gjyqtarëve në Kosovë mbeten të ulëta dhe të pamjaftueshme për t'ju mundësuar atyre përkrahjen e familjeve të tyre pa ndonjë burim tjetër të të ardhurave. Rrogat nuk janë rritur që nga viti 2002, me ç'rast ishte autorizuar rritja prej 5%. Gjatë vitit 2004, rrogat mujore të gjyqtarëve varësisht nga shkalla ku ata janë të angazhuar, sillet prej 420 euro, për gjyqtarët e gjykatave kundërvajtëse dhe 666 euro për kryetarin e Gjykatës Supreme. Në veçanti, gjyqtarët e gjykatave komunale marrin 471 euro për një muaj, ndërsa gjyqtarët e gjykatave të qarkut i marrin nga 549 euro për një muaj, kurse gjyqtarët e Gjykatës Supreme i marrin nga 627 euro. Kryetarët e gjykatave i marrin rrogat pak diçka më të larta. Pagesa aktuale mbetet edhe më e vogël pas reduktimeve të tatimit në të hyra dhe tatimit për pension. Tani në përgatitje e sipër është ligji për miratim nga Kuvendi i Kosovës me të cilin parashikohet rritja e shkallës së pagesës për nëpunësit civil e cila do t'i përmirësonte edhe rrogat e gjyqtarëve.

Edhe pse rrogat e gjyqësisë janë nominalisht të krahasueshme me (ose edhe i tejkalojnë) ato të punonjësve të shërbimit civil të të njëjtës pozitë, gjyqtarët mbështeten në faktin se nëpunësit tjerë civil potencialisht kanë më shumë të ardhura sepse ata mund të angazhohen edhe në punë tjera shtesë. Ndërsa sipas Kodit të etikës për gjyqtarë, këta e kanë të ndaluar, të marrin shpërblim tjetër përveç rrogës së tyre, përveç në rastet e shpërblimit simbolik për ndonjë ligjeratë të dhënë, dhe të autorizuar nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës. Përveç rrogës gjyqtarët nuk kanë beneficione tjera plotësuese.

Në raportin më të ri të përgatitur nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e SHBA-ve në Prishtinë, janë bërë krahasimet e rrogave të gjyqtarëve dhe kategorive tjera të të punësuarve dhe udhëheqësve më të lartë të pushtetit. Është arritur përfundimi se megjithëse rrogat në gjyqësor janë konsiderueshëm më të larta se "shumica e kategorive të zyrtarëve dhe të punësuarve qeveritarë", prapë, "ka dallime dramatike në nivelin e pagave të udhëheqësve të lartë qeveritarë". Lexo KE/DDSHBA, *Vlerësimi i Sistemit Gjyqësor të Kosovës, faqe, 258*. Prandaj, rroga e kryetarit të Gjykatës Supreme është e barabartë me 45% të rrogës së kryetarit të Kuvendit të Kosovës. Në raport thuhet si në vijim, "shpërblimi i kryetarit të Gjykatës Supreme, me më pak se gjysmën e rrogës së kryetarit të Kuvendit, tregon për dallimet themelore në atë se si dhe sa vlerësohet pushteti legjislativ dhe gjyqësor, varësisht nga roli i tyre në Kosovë dhe tregon për pozitë të subordinuar të pushtetit gjyqësor ndaj atij legjislativ."/d. faqe 258-259. Në raport më tutje konkludohet se, bazuar në nivelin e tanishëm të pagave, gjyqtarët mund t'i mbajnë familjet e tyre,

por ata nuk mund të kursejnë sa për t'i mbuluar shpenzimet e papritura ose për t'ju shërbyer për pension. *Id. f. 89.*

Çështja e rrogave është përmendur si një problem i rëndësishëm pothuajse nga secili person i anketuar. Shumica e vendeve të lira janë plotësuar por si problem i vazhdueshëm mbetet mbajtja e gjyqtarëve. Shpesh gjyqtarët e braktisin detyrën për të punuar si avokatë ose për organizata ndërkombëtare ku zakonisht rroga është më e lartë se në gjyqësi.

Të anketuarit kanë bërë komente se rrogat e ulëta jo vetëm se ndikojnë në mbajtjen e gjyqtarëve në punë por edhe në moralin e atyre të cilët mbeten në gjyqësi. Gjyqtarët janë më pak efikas dhe japin rezultate të ulëta të punës për shkak të rrogave të tyre të ulëta. Edhe pse të anketuarit nuk mendojnë se korrupcioni është një faktor aq i madh në gjyqësi, ata e kanë përmendur se rrogat më të larta do ta zvogëlonin mundësinë për të parë raste të dhënjes së mitos. Siç ka theksuar një i anketuar, “rrogat e ulëta e ftojnë miton”. Një shqetësim tjetër ishte se rrogat e ulëta krijojnë përshtypjen tek qytetarët se gjyqtarët kanë vlerë dhe status më pak të vlefshëm krahasuar me qeverinë.

Rrogat e ulëta gjithashtu ndikojnë në punësimin dhe mbajtjen e gjyqtarëve serbë të Kosovës. Gjyqtarët serbë të Kosovës janë më të stimuluar të punojnë në gjykatat paralele ose në Serbi për shkak se qeveria e Serbisë paguan rroga më të larta se UNMIK-u.

Faktori 12: Ndërtesat (Objektet) e Gjykatave

Ndërtesat e gjykatave janë të vendosura në vende të volitshme dhe të lehta për tu gjetur, dhe ofrojnë një ambient të respektueshëm për ndarjen e drejtësisë me një infrastrukturë adekuate.

| Përfundimi | Korrelacioni: Neutral | Trendi : ↔ |
|--|------------------------------|-------------------|
| Ndërtesat e gjykatave janë të vendosura në vende të volitshme dhe janë të lehta për t'u gjetur. Mirëpo, kushtet brenda ndërtesave e bëjnë ambientin joadekuat. | | |

Analiza/Sfondi:

Në përgjithësi, ndërtesat e gjykatave janë të vendosura në vende të përshtatshme dhe është lehtë për t'i gjetur. Edhe pse për pakicat kjo qasje në gjykatat e UNMIK-ut është përsëritur (rishfaqur), UNMIK-u ka bërë përpjekje që këtë problem ta rregullojë duke hapur gjykata në Leposavic, Zubin Potok dhe Gracanicë.

Krahas kësaj, në janar të vitit 2003, Shërbimi për Integrim Gjyqësor i DD-së, e ka hapur Zyrën Gjyqësore Ndërlidhëse (ZGJN) në enklavën serbe të Gracanicës (Rajoni i Prishtinës) me qëllim të lehtësimit të qasjes në gjykata për pjesëtarët e pakicave. Kjo zyrë ofron këshilla, përkrahje të përgjithshme gjatë dëgjimeve, shërbime pa pagesë të transportit për në gjykatat e Prishtinës, ndihmon në paraqitjen e dokumentave në gjykata dhe në gjetjen e kërkesave të vjetra nëpër arkivat gjyqësore dhe shërben si ndërlidhje në mes të banorëve të Gracanicës dhe gjykatave të Prishtinës. Gjatë vitit të parë të punës, ZGJN ka pranuar gjithsej 1.656 kërkesa për ndihmë, si nga pakicat me banim në Kosovë, ashtu edhe nga Serbia. Duke pasur parasysh kërkesën e madhe për shërbimet e ZGJN-së, DD-ja i ka hapur zyrat plotësuese edhe në enklavat sikur Novobërda (regjioni i Gjilanit) dhe Gorazhdevc (regjioni i Pejës), dhe është duke e shqyrtuar mundësinë e zgjerimit të këtij modeli edhe në enklavat tjera. Edhe pse këto zyra i kufizuan shërbimet e tyre menjëherë pas trazirave të marsit, ato megjithatë kanë vazhduar t'ju ndihmojnë pakicave duke ua dorëzuar kërkesat gjykatave dhe duke kërkuar dokumenta në emër të palëve.

Mirëpo, shërbimi i autobusit i ZGJN-së punon vetëm për rastet urgjente dhe shfrytëzohet për momentin minimalisht. Për shkak të shqetësimeve të sigurisë, policia e KB-së duhet ta përcjellë stafin e kësaj zyre gjatë të gjitha udhëtimeve që i marrin ata.

Për shqiptarët që jetojnë nëpër rajonet kryesisht të banuara nga serbët, vlejné të njëjtat çështje të sigurisë dhe qasjes. Në këtë drejtim, enklava serbe e Zubin Potokut ofron transport për në gjykatë për shqiptarët që jetojnë në fshatrat e afërta.

Të anketuarit e kanë kritikuar fuqishëm ambientin punues nëpër gjykatore. Me disa përjashtime, të anketuarit janë shprehur të pakënaqur me kushtet e punës dhe e kanë identifikuar ambientin e papërshtatshëm si një prej arsyeve për uljen e respektit për gjyqësinë por edhe ka ndikuar negativisht në moralin e gjyqtarëve.

Mungesa e hapësirës është ranguar nga të anketuarit si problemi kryesor. Shumica e ndërtesave nuk kanë numër të mjaftueshëm të sallave të gjyqimit. Për shembull, ndërtesa e gjykatës në Mitrovicë, në të cilën punojnë si gjykata e qarkut, ajo komunale dhe kundërvajtëse, duhet disi t'i akomodojë gjykimet e përditshme të mbajtura nga pesëmbëdhjetë gjyqtarë në gjithsejt tre salla të gjyqimit. Gjykata Komunale e Prishtinës e ka vetëm një sallë të gjyqimit, ndërsa ndërtesa e gjykatës në Prizren, shfrytëzohet bashkarisht nga gjykata komunale dhe ajo e qarkut dhe e ka vetëm një sallë të gjyqimit. *Lexo KE/DDSHBA, Vlerësimi i Sistemit Gjyqësor të Kosovës, faqe 138.* Rrjedhimisht, shumë gjyqtarë i zhvillojnë gjykimet ose pjesë tjera të procedurës nëpër zyret e tyre. Zyret zakonisht janë të vogla dhe nuk kanë ulëse të mjaftueshme për të gjitha palët, ndihësgjyqtarët, mediat dhe publikun. Për shkak të hapësirës së kufizuar, është vështirë të veçohen, palët dhe ndihmësgjyqtarët. Në gjykatat tjera shpesh gjyqtarët i shfrytëzojnë zyret me ndërrime ose vonohen në mbajtjen e seancave të caktuara. Gjykata Komunale e Rahovecit ka qenë e detyruar që arkivën e vet ta bartë në një ndërtesë tjetër për ta bërë një sallë të re të gjyqimit. *Id. f. 89, 138, 198.* Në disa vende, gjyqtarët punojnë në të njëjtën ndërtesë edhe me prokurorinë edhe nga të anketuarit kjo nuk u paraqit si problematike përkundrazi disa kanë vërejtur se kjo e lehtëson punën.

Vetëm një nga gjykatat e vëzhguara, Dragashi, kishte zyre të ndara për avokatë dhe klientë për tu takuar. Në disa rajone, avokatët takohen me klientët nëpër korridoret e gjykatave ose nëpër zyret e policisë. Në gjykatat tjera, gjyqtarët i braktisin zyret e veta për t'ua mundësuar takimin avokatëve me klientët e vet.

Në fund, sipas disa të anketuarve, shumë ndërtesa të gjykatave kanë nevojë për riparime dhe mirëmbajtje më të mirë. Një i anketuar ka dhënë vërejtjet se për shkak të gjëndjes aq të keqe të ndërtesës, pajisjet e zyrës dhe pajisjet elektrike kanë pësuar dëme të mëdha për shkak të pikjes së strehës. Ndërtesa e re është premtuar por projekti ende nuk ka filluar.

Faktori 13: Siguria e Gjyqësorit

Resurse të mjaftueshme janë alokuar për mbrojtjen e gjyqtarëve nga kërcënimet siç janë, ngacmimet, sulmet dhe vrasjet.

| <i>Përfundimi</i> | <i>Korrelacioni: Neutral</i> | <i>Trendi: ↑</i> |
|--|-------------------------------------|-------------------------|
| Edhe pse Departamenti i Administratës Gjyqësore, me disa përjashtime, ka mundur ta mbrojë sigurinë e ndërtesave të gjykatave, prapë nuk janë alokuar resurse të mjaftueshme për mbrojtjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga kërcënimet ose dhuna. | | |

Analiza/Sfondi:

Shumica e të anketuarve janë të kënaqur me sigurinë në ndërtesën e gjykatës por nuk ndihen personalisht të sigurtë jashtë ndërtesës. DAGJ-i është përgjegjës për sigurimin e ndërtesës, me ç'rast është vendosur që këto objekte të sigurohen mirë dhe se hyrjet dhe daljet kontrollohen gjatë orarit të punës. Kur mbahen gjykime të profililit të lartë dhe sensitive me përfshirjen e gjyqtarëve ndërkombëtarë atëherë rritet shkalla e sigurisë.

Si përjashtim ndaj gjendjes së kënaqshme të sigurisë është ndërtesa e gjykatës në Mitrovicë, e vendosur në pjesën veriore të Mitrovicës. Për shkak të shqetësimeve të sigurisë, gjykata mbyllet në ora 3:00 pasdite deri në mëngjes. Është ironik fakti se kjo ndërtesë nuk ruhet gjatë kohës kur nuk punon “për shkaqe sigurie”. Të anketuarit e kanë sqaruar këtë situatë si të “rrezikshme për rojet e sigurisë”. Kryetari i gjykatës ka kërkuar që policia të patrollojë në atë zonë por policia e ka refuzuar kërkesën. Në janar të vitit 2004, kjo gjykatë ishte ndezur pjesërisht dhe disa pajisje janë vjedhur për shkak të mungesës së masave të sigurisë.

Në gusht të vitit 2002, gjykata në komunën e Vitisë ishte sulmuar gjithashtu. Sikurse në Mitrovicë, kjo ndërtesë gjatë asaj kohe nuk ishte duke u ruajtur nga rojet e sigurisë. Rrjedhimisht janë vendosur rojet e sigurisë dhe ndriçimi i jashtëm.

Siguria fizike e gjyqtarëve mbetet një shqetësim i konsiderueshëm. Për shembull, gjatë gjykimit të ish-udhëheqësve të UÇK-së, ka pasur protesta nëpër rrugë. Gjyqtarët e intervistuar e kanë përshkruar si “ të pakëndëshëm ballafaqimin në rrugë me masën e njerëzve” gjatë protestave. Praktikisht në secilin regjion ka pasë probleme me kërcënime dhe dhunë të ushtruar ndaj gjyqtarëve. Mirëpo, madje edhe në ato pak vendndodhje ku është shfaqur dhuna, gjyqtarët e konsiderojnë si joadekuate shkallën e sigurisë për gjyqtarët. Në disa vende sikurse është Prizreni, gjyqtarët kanë përjetuar probleme të shumfishta, duke u nisur nga veprat penale kundër pasurisë së tyre deri tek rrahjet e rënda. Edhe pse qëndrimi i përgjithshëm për bashkëpunimin me SHPK-në duket se është i favorshëm, reagimi i policisë në ndjekjen e rasteve të tilla të kërcënimit dhe dhunës kundër gjyqtarëve, nuk është parë gjithmonë si i përshatshëm. Disa të anketuar mendojnë se duhet të ketë njësi speciale për mbikqyrjen e rasteve të kërcënimit dhe dhunës kundër gjyqtarëve. Disa kryetarë të gjykatave kanë kërkuar nga policia që t'i përcjellë gjyqtarët e kërcënuar nëpër shtëpitë e tyre. Disa gjyqtarë punojnë në regjion tjetër nga ai i vendbanimit kështu që ata duhet të udhëtojnë distanca të gjata pa përcjellje. Shumë të anketuar janë shprehur se kjo situatë mund të përmirësohet duke e shtuar numrin e policëve në rroba civile si vëzhgues. Të anketuarit gjithashtu e kanë përmendur rrezikun e perceptuar nga presioni i ushtruar nga palët ose personat juridik për zgjidhjen e rasteve më shpejtë.

Në vitin 2001, disa prej gjyqtarëve që kanë shprehur dëshirën, u janë dhënë armë për një periudhë gjashtëmujore, por pas skadimit të lejes UNMIK-u nuk ua ka ripërritur lejen për armëmbajtje. Shumica e të anketuarve që punojnë në gjyqësi mendojnë se gjyqtarëve duhet t'u lejohet bartja e armëve për vetëmbrojtje. Megjithëse shumica prej tyre e kanë pranuar se kjo “nuk është në natyrën e gjyqtarit”, ata megjithatë besonin se bartja e armës do t'i frikësonte sulmuesit potencial. Shumica prej tyre kanë përmendur se tani gjyqtarët janë duke shqyrtuar lëndë që janë më të rrezikshme, siç janë ato për trafikim dhe krim të organizuar. Për më shumë, çështjet pronësore janë bërë mjaft të ndieshme, dhe vlerat e involvuara në ato raste vetëm sa e shtojnë rrezikun e gjyqtarëve nga palët. Pas luftës shumë njerëz të cilëve u janë ndezur shtëpitë apo shkatërruar ndryshe, i kanë uzurpuar banesat e braktisura. Zgjidhja e këtyre çështjeve është rënduar për së tepërmi për shkak se palët e involvuara mund të mos kenë vend për të jetuar dhe mund të ndihen se për të dytën herë janë duke pësuar të keqen. Në rastet tjera, palët e kanë uzurpuar pasurinë afariste dhe e kanë rrezikuar një sasi të konsiderueshme të parave me zgjidhjen e rastit. Në ato raste palët mund ta kërcënojnë gjyqtarin drejtëpërdrejtë ose të bëjnë presion në të duke i bërë thirrje të pandërprera telefonike apo duke i dërguar letra kërcënuese. Për ta komplikuar këtë çështje edhe mëtej, gjyqtarët shpesh gjinden në situata të konfliktit të interesave gjatë gjykimit të lëndëve të caktuara pasurore juridike. Për shembull, një gjyqtar, shtëpia e të cilit ishte djegur gjatë luftës, ka jetuar në një banesë e cila nuk ishte e tij, ndërsa në të njëjtën kohë ai gjykonte lëndët pronësore në të cilat shqyrtoheshin faktet e ngjashme.

Të anketuarit janë në dijeni të plotë se gjyqtarëve të paktë ndërkombëtarë u ofrohet siguri nga Njësi të Mbrojtje të Afërt, përderisa gjyqtarëve nga Kosova jo. Mirëpo për shumë gjyqtarë nga Kosova kjo situatë është e pranueshme për shkak se nuk dëshirojnë të paraqiten më superior ndaj popullatës. Në anën tjetër ata gjithashtu e pranojnë se gjyqtarët e vendit janë më të kufizuar në vendosje sepse këta duhet të jetojnë me komunitetin. Mbrojtja e afërt i ofrohet gjyqtarëve ndërkombëtarë pasi që ata marrin rastet më të rrezikshme. Sidoqoftë, gjykatësit kosovar dhe prokurorët gjithashtu kanë nevojë për mbrojtje.

IV. Masat Mbrojtëse Strukturale

Faktori 14: Mandati i Garantuar

Gjyqtarët e lartë emërohen për kohë të pacaktuar që ofron mandat të garantuar dhe të mbrojtur deri në moshën për pension ose deri në skadim të mandatit afatgjatë.

| Përfundimi | Korrelacioni: Neutral | Trendi : ↔ |
|---|------------------------------|-------------------|
| Gjyqtarët e kanë mandatin e garantuar por për periudhë kohore të pacaktuar. | | |

Analiza/Sfondi:

Rregulloret e UNMIK-ut, ose legjislacini tjetër, nuk e rregullojnë mandatin gjyqësor, ndërsa caktimi i kohëzgjatjes duket se është çështje e diskrecionit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së. Në fillim të misionit të UNMIK-ut, gjyqtarët janë emëruar për mandat tremujor, gjashtëmujor dhe nëntëmujor me kontratë me mundësi vazhdimi. Në dhjetor 2001, pas rekomandimeve të KGJPK-së, emërimet në gjyqësor i ka zgjatur PSSP-ja deri në përfundim të administratës së UNMIK-ut. Vazhdimi i mandatit deri në përfundim të administrimit të UNMIK-ut në Kosovë është deklaruar në kontratën e shërbimit në gjyqësi, e nënshkruar nga zëvendësi i PSSP-së. Mandati i UNMIK-ut është i padefinuar kështu që kjo reflektohet edhe në mandatin e funksionit gjyqësor. Mandati gjyqësor gjatë kësaj periudhe është i garantuar por mund të ndërpritet për shkak të shkeljeve disiplinore. Lexo RREGULLOREN MBI KGJPK-në; *lexo gjithashtu* Faktorin 17 për diskutimin lidhur me shkarkimin e gjyqtarëve. Kohëzgjatja e mandatit gjithashtu lidhet me dispozitat për moshën e obliguar për pension që është 65 vjet, por disa gjyqtarë dëshirojnë ta shtyejnë deri në moshën 70 vjeçare që është në pajtim me praktikat në regjionin e Ballkanit dhe Evropës Perendimore.

Sipas shumicës së të anketuarve kohëzgjatja e kufizuar e funksioneve gjyqësore e ka krijuar një ambient të pasigurisë për të ardhmën e anëtarëve të gjyqësisë.

Gjyqtarët ndërkombëtarë kanë kontrata gjashtëmujore me mundësi zgjatjeje pas aprovimit nga UNMIK-u. Propozimet e fundit për kalimin e sistemit gjyqësor nga ndërkombëtarët tek kosovarët me gjasë do t'i eliminonte shumë pozita të gjyqtarëve ndërkombëtarë, por koha kur kjo do të ndodhte është e paqartë. Disa të anketuar kanë pohuar që kontratat afatshkurtëra të gjyqësorit ndikojnë në pavarësinë e gjyqësorit që është në shkelje me Standardet e aplikueshme Europiane.

Faktori 15: Kriteret Objektive për Avansim (në punë) në Gjyqësi

Gjyqtarët avansohen në sistemin gjyqësor bazuar në kriteret objektive siç janë, zotësia, integriteti dhe përvoja.

| Përfundimi | Korrelacioni: Neutral | Trendi : ↔ |
|--|------------------------------|-------------------|
| Në përgjithësi, gjyqtarët avansohen bazuar në kriteret objektive, megjithëse procesi mund të mos jetë tërësisht transparent. | | |

Analiza/Sfondi:

URDHËRESA ADMINISTRATIVE 2001/17, për *Implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/8 PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT GJYQËSOR DHE PROKURORIAL* (më tutje në tekst URDHËRESA ADMINISTRATIVE PËR VLERËSIMET NË GJYQËSOR) përcakton sistemin vlerësues me të cilin informohet PSSP-ja për qëllime të avancimeve në gjyqësi. Siç përcaktohet në rregullore, sistemi dy shkallësh i sistemit vlerësues përbëhet nga faza fillestare dhe ajo finale. Id. § 1.1. Kryetari i gjykatës e kryen vlerësimin fillestar të gjyqtarit të rregullt, ndërsa kryetari i gjykatës më të lartë e vlerëson kryetarin e gjykatës. Id. § 1.1(c). Kryetari i gjykatës drejtpërdrejtë më të lartë e kryen vlerësimin final për gjyqtarin e rregullt, ndërsa kryetari i Gjykatës Supreme e vlerëson kryetarin e gjykatës komunale. Id. § 1.1(d). Kryetari i Gjykatës Supreme e bënë vlerësimin fillestar dhe përfundimtar për kryetarët e gjykatave të qarkut dhe për kryetarin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut, si dhe për të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme, ndërsa gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje të dyja vlerësimet ua kryen kryetari i gjykatës së tyre. Id. § 1.2. Kryetari i Gjykatës Supreme dhe kryetari i Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje nuk vlerësohen fare në bazë të kësaj kornize. Id. § 3.4.

Për vlerësimin fillestar, vlerësuesi e zhvillon një bisedë duke e shfrytëzuar formularin enkas të përgatitur për këtë vlerësim, ndërsa gjyqtari i vlerësuar ka mundësi të jepë komentet me shkrim. Id. § 3. Pastaj, vlerësimi dhe komentet i dorëzohen vlerësuesit final, i cili e plotëson formën e veçantë dhe në raste të caktuara mund të kërkojë mendimin edhe të palës së tretë që ka njohuri në këtë fushë, të intervistojë gjyqtarin e gjykatës së njëjtë dhe nëse është e përshtatshme ta intervistojë vlerësuesin fillestar dhe gjyqtarin e vlerësuar. Id. § 4. Vlerësimin final mund ta vërtetojë ose modifikojë vlerësimin fillestar por vlerësuesi final vlerësimin e modifikuar ia dërgon gjyqtarit të vlerësuar, vlerësuesit fillestar dhe KGJPK. Id. § 4.5. Vlerësimet kryhen çdo vit, por mund të kryhen edhe vlerësime plotësuese nëse gjyqtari ose kryetari konsiderohet për promovim ose nëse i nënshtrohet hetimeve disiplinore, dhe nëse kanë kaluar më shumë se 3 muaj që nga vlerësimi i fundit vjetor. Id. § 5.

Të anketuarit besojnë se nuk janë respektuar kriteret në mënyrë strikte për shkak të numrit të vogël të aplikuesve të kualifikuar. Mirëpo gjyqtarët nuk dukej se ishin tepër kritik ndaj kësaj praktike për shkak se i kuptojnë mundësitë e vogla të zgjedhjes. Në fund, disa të anketuar janë ankuar se procesi i avansimit në gjyqësi nuk është transparent për shkak se gjyqtarët nuk konsultohen fare.

Faktori 16: Imuniteti i Gjyqtarëve për Veprimet Zyrtare

Gjyqtarët kanë imunitet për veprimet e kryera me detyrë zyrtare.

| <i>Përfundimi</i> | <i>Korrelacioni: Neutral</i> | <i>Trendi : ↔</i> |
|---|-------------------------------------|--------------------------|
| Bazuar në burime të ndryshme juridike, ekziston një imunitet i kufizuar për veprimet në kryerje të detyrës zyrtare. | | |

Analiza/Sfondi:

Rrjedhimisht, çështja e imunitetit gjyqësor rregullohet vetëm me Ligji mbi Gjykatat e Rregullta, i cili thekson se “gjyqtari dhe ndihmësgjyqtari nuk mund të thirren në përgjegjësi për shkak të dhënjes së mendimit gjatë marrjes së vendimit gjyqësor.” LIGJI MBI GJYKTAT E RREGULLTA neni 11. më tej thekson se gjyqtarët nuk mund të paraburgosen për veprën penale të kryer në detyrë zyrtare, “pa aprovimin e kuvendit të bashkësisë shoqërore politike e cila e ka emëruar.” Id. Kjo dispozitë tani nuk zbatohet për shkak se nuk ekzistojnë më ato kuvende të cilave u referohet ligji.

Korniza Kushtetuese nuk e përsërit imunitetin gjyqësor, edhe pse e përsërit një imunitet të kufizuar për zyrtarët e organeve të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ 9.1.24; s.9.2.6; s.9.3.19. Nuk ekziston Rregullore e UNMIK-ut e cila e rregullon imunitetin gjyqësor.

Kodi i ri i Përkohshëm Penal përmbanë dispozita të ngjajshme me ato të Ligjit të mëhershëm Penal, lidhur me imunitetin gjyqësor. Përderisa në kod nuk përshkruhet veçanërisht imuniteti gjyqësor, në të përshkruhen veprat për të cilat gjyqtarët janë përgjegjës. Kreu 29 mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare i ndalon veprimet siç janë, keqpërdorimi i autorizimeve dhe mitoja. Neni 346 i Kodit Penal i sanksionon gjyqtarët profesionistë dhe ndihmësgjyqtarët të cilët lëshojnë vendime të kundërligjshme me qëllim të përfitimit pasuror ose me qëllim të dëmtimit të tjetrit, me heqje lirie prej gjashtë muaj deri në pesë vjet. Kodi Penal më tutje i parashikon veprat penale të kryera nga “personi zyrtar”, siç janë keqpërdorimi i detyrës zyrtare, mashtrimi ose dhënja/marrja e mitos. Lexo KPP nenet 339-351. Gjyqtari është “person zyrtar” sipas kuptimit të nenit 107(1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Asnjë nga të anketuarit nuk kishte dijeni për rastet në të cilat gjyqtarët janë ndjekur penalisht për shkeljet e detyrës zyrtare për marrjen e vendimeve politikisht jo të pëlqyera.

Faktori 17: Shkarkimi dhe Disiplina për Gjyqtarë

Gjyqtarët mund të shkarkohen nga detyra ose të ndëshkohen vetëm për sjellje të konsideruara si të pahijshme dhe përmes një procesi transparent dhe të udhëhequr nga krietere objektive.

| <i>Përfundimi</i> | <i>Korrelacioni: Neutral</i> | <i>Trendi : ↔</i> |
|--|-------------------------------------|--------------------------|
| Procedurat disiplinore për shkelje disiplinore nga gjyqtarët vendës udhëhiqen nga krietere objektive. Mirëpo, gjyqtarët ndërkombëtarë i nënshtrohen vetëm disiplinimit diskrecional nga PSSP-ja. | | |

Analiza/Sfondi:

Korniza Kushtetuese, i lejon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP-së) shkarkimin e gjyqtarëve sipas rekomandimeve të dhëna nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës (KGJPK), dhe vetëm “përjashtimisht, me vetiniciativë”. Lexo Kornizën Kushtetuese § 8.1.g. Më pas, me ligj thotë se KGJPK-ja mund ta rekomandojë shkarkimin e gjyqtarit vetëm si rezultat i procedurës disiplinore dhe nuk parashikohen baza tjera për shkarkimin nga detyra.

Procedura disiplinore për veprime të pahijshme zyrtare udhëhiqet nga Rregullorja për KGJPK-në. Sipas Rregullores, KGJPK-ja është përgjegjëse për procedurën disiplinore së bashku me Shërbimin e Inspektionit Gjyqësor (SHIGJ), të Departamentit të Drejtësisë (DD). KGJPK-ja definohet si organ nëntë-antëtarësh dhe shumetnik, i përbërë nga profesionistë të shquar të drejtësisë, ndërkombëtarë dhe vendorë, nga fusha të ndryshme të drejtësisë, përfshirë ish gjyqtarë dhe prokurorë, avokatë ose profesorë të së drejtës, dhe të cilët i plotësojnë “standardet më të larta të efikasitetit, kompetencës dhe integritetit”. Lexo RREGULLOREN MBI KGJPK § 2.1. Edhe pse me ligj nuk përcaktohet proporcioni në mes të ndërkombëtarëve dhe vendorëve, tani së voni, kosovarët e përbëjnë shumicën në KGJPK.

Rregullorja mbi KGJPK-në e përkufizon sjelljen e pahijshme si në vijim:

- (a) kryerja e një vepre penale;
- (b) mosprëfillja e funksioneve gjyqësore;
- (c) veprimi që është i papajtueshëm me detyrën e një gjyqtari për të qenë i pavarur dhe i paanshëm;
- (ç) vënia në pozitë, për shkak të sjelljes personale ose ndonjë shkakut tjetër, që është e papajtueshme me kryerjen e detyrës së tij; ose
- (d) shkelja e kodit të etikës profesionale.

Lexo id. § 7.11.

Urdhëresa Administrative 2001/4 për Zbatimin e Rregullores 2000/15 MBI THEMELIMIN E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV TË DREJTËSISË (më tutje, URDHËRESA ADMINISTRATIVE MBI SHIGJ) e themelon SHIGJ-në, i cili ekziston për hetimin e pohimeve për sjelljet e pahijshme nga gjyqtarët, ndihmësgjyqtarët dhe prokurorët dhe për të kryer një auditim gjyqësor.¹⁰ Ligji thot se vetëm PSSP-ja dhe bashkëudhëheqësit e DD-së mund të ngrisin ankesën pranë KGJPK-së. (Edhe pse pozitat e përmendura nuk ekzistojnë më, Zyra e Këshilltarit Ligjor nuk e ka ndryshur Rregulloren). Lexo RREGULLOREN MBI KGJPK, § 7.2. Mirëpo në praktikë, SHIGJ i pranon ankesat nga çdo kush, përfshirë edhe ato të dërguara në anonimitet. Kryetarët e gjykatave janë të obliguar t’i raportojnë ankesat, megjithatë të anketuarit kanë spekuluar për numrin e ankesave të pa raportuara.

Procesi hetues i SHIGJ-së përfshinë intervistat dhe inspektimin e shkresave të lëndës. Nëse SHIGJ-ja vendosë të mos e hetojë rastin duhet t’ia dërgojë shpjegimin Drejtorit të DD-së. Për ta mbrojtur pavarësinë e gjykatave, SHIGJ-ja e ka të ndaluar ta pranohet ankesën nëse për këtë gjë ekziston mjeti juridik përkatës. Gjyqtari nën hetime, mund të suspendohet nga detyra në pritje të hetimeve dhe procedurës disiplinore, me kusht që ky suspendim të “mirret vetëm nëse këtë e kërkon interesi i drejtësisë dhe ai duhet të jetë i përkohshëm, të mos publikohet dhe gjyqtari mos të privohet nga marrja e rrogës së tij”, dhe ndërpritet automatikisht brenda 90 ditëve. Lexo RREGULLOREN MBI KGJPK, § 7.15-7.16. SHIGJ ia dorëzon rezultatet e hetimeve KGJPK-së i cili pastaj vendosë nëse do të hapë procedurën disiplinore apo jo.

¹⁰ Njësia për Auditim e SHIGJ-së nuk është në veprim ende por, NCSC-ja është duke e ndihmuar zhvillimin e saj. Njësia për auditim do ta analizojë efikasitetin e gjykatave dhe propozojë reformat, veçanërisht në lidhje me numrat dhe shpërndarjen e lëndëve dhe gjyqtarëve.

Me rastin e fillimit të procedurës disiplinore, KGJPK duhet ta informojë gjyqtarin nën hetime për akuzat, arsyet që e kanë nxitur hetimin dhe të drejtat e tij apo saj për qasje në dosjen e rastit gjatë tërë procesit. *Lexo RREGULLOREN MBI KGJPK, § 7.3, 7.7.* Gjatë procedurës, gjyqtari në fjalë gëzon të drejtën e përfaqësimit nga kolegu ose nga avokati, dhe të paraqitet personalisht në seancë, por mosparaqitja e tij/saj, edhe pse i/e thirrur me rregull, nuk e pengon KGJPK-në që ta shqyrtojë rastin. *Id. § § 7.6, 7.8.* Procedura disiplinore përfshinë dëgjimin e deklaratave nga përfaqësuesit e SHIGJ-së, raportuesve të KGJPK-së dhe gjyqtarit nën hetime ose avokatit të tij, shikimin e shkresave të lëndës dhe dhënjen e vendimit të plotëfuqishëm. Nëse konstatohet shkelja, KGJPK-ja shqipton sanksionet, p.sh, qortimin, qortimin me vërejtje, ose suspendim gjashtëmuor. *Id. § § 7.10(a)-(c).* KGJPK-ja si alternativë, gjithashtu mund t'ia rekomandojë PSSP-së edhe shkarkimin e gjyqtarit nga detyra. *Id. § § 7.1 (d)-(e).* Çdo sanksion i propozuar nga KGJPK-ja duhet të jetë proporcional me peshën e shkeljes së kryer nga gjyqtari. *Id. § 7.13.* Në krijimin e procedurës disiplinore Zyra e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut, e ka lënë anash parashikimin e shkallës së dytë, ose të vendosjes sipas ankesës, edhe pse vetëm pak gjyqtarë të dënuar e kanë kërkuar të drejtën e ankesës. Njësia për Zhvillim Profesional e DD-së është duke punuar në ndryshimin e Rregullores mbi KGJPK-në për ta plotësuar këtë mangësi procedurale dhe e ka miratuar një proces i cili ende nuk është aprovuar nga PSSP-ja.

Deri në nëntor të vitit 2004, në SHIGJ janë paraqitur 624 ankesa. SHIGJ-ja i ka refuzuar 196 ankesa si të pabaza pas shqyrtimit të parë të tyre. Në 269 raste, SHIGJ-ja ka konstatuar pas shiqimit të provave se nuk ka baza për mbështetjen e sjelljes së pahijshme, ndërsa 41 raste i janë përcjellur KGJPK-së për procedurë disiplinore (hetimet janë në zhvillim e sipër për 103 rastet e mbetura). KGJPK-ja e ka kryer procedurën disiplinore për 34 nga këto raste dhe nuk ka pasur mundësi të gjejë prova për sjellje të pahijshme ose baza të mjaftueshme për të proceduar me 17 prej këtyre rasteve. Për ankesat e mbetura, KGJPK-ja ka shqiptuar tri qortime dhe katër qortime me vërejtje, ndërsa PSSP-së i ka rekomanduar shkarkimin e 10 gjyqtarëve. Llojet e sjelljeve të pahijshme ishin: mospërfillje e detyrës së gjyqtarit (13 raste); vënie në pozitë, për shkak të sjelljes personale ose ndonjë shkaku tjetër, që është e papajtueshme me kryerjen e detyrës, (8 raste); veprim që është i papajtueshëm me detyrën e një gjyqtari për të qenë i pavarur dhe i paanshëm dhe shkelje e kodit të etikës profesionale (nga 7 raste – secili veprim); dhe kryerje e veprës penale (6 raste). *Lexo Raportin Javor të Departamentit të Drejtësisë – UNMIK: java 12 -13 e tetorit 2004; gjithashtu lexo: John Furnari, Shërbimi i Inspektionit Gjyqësor: Mbrojtja e Gjyqësisë së Kosovës, BULETIN I SHOQATËS SË GJYQTARËVE TË KOSOVËS, edicioni i 3, faqe 4 (tetor 2004).*

Në përgjithësi, KGJPK-ja i mbanë seancat e hapura për publikun por, komisioni gëzon të drejtën që ta kufizojë pjesëmarrjen për të lejuar vetëm palët e involvuara, “nëse këtë e kërkon interesi i drejtësisë”. RREGULLORJA MBI KGJPK-në § 7.9. Vendimet e KGJPK-së i ipen gjyqtarit në fjalë por nuk i vëhen në dispozicion publikut. Kjo ndalesë zgjerohet edhe në Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK), e cila ishte kritikuar për ofrim të anëtarësisë gjyqtarëve të shkarkuar. Të anketuarit kanë shpjeguar se pa vendimin e KGJPK-së, OAK-ja nuk ka baza ligjore t'ua mohojë anëtarësinë gjyqtarëve të shkarkuar. Megjithatë, sipas KGJPK-së, ky i fundit së voni ka vendosur që pala ankuese në një procedurë disiplinore të jetë e autorizuar të informohet për rezultatet e procedurës, edhe në ato situata kur veprimi disiplinor besohet të jetë e dhënë private dhe jo-publike. Këshilli më pastaj ka vendosur që procedurat disiplinore të cilat rezultojnë në shkarkimin e një gjykatësi apo prokurori të jenë publike nëse, në rastet kur PSSP-ja vepron sipas rekomandimit të duhur për shkarkim të shkelësit nga detyra.

Shumica e të anketuarve i kanë njohur të arriturat e SHIGJ-së dhe KGJPK-së, por edhe i kanë shprehur disa kritika. Hetimet e prolonguara, nganjëherë duke e kaluar një vit, shkaktojnë presion të jashtëzakonshëm në gjyqtarin nën hetime. Numri i vogël i stafit të SHIGJ-së duket se është arsyeja kryesore për zgjatjen e hetimeve. Shumë të anketuar janë shprehur të bindur se hetuesve të SHIGJ-së u mungojnë kualifikimet profesionale dhe shpeshherë përqendrohen në gjëra të imëta, në dëm të rasteve serioze. Shumë besojnë se individët vetëm e keqpërdorin procedurën ankimore për t'ju hakmarrë personalisht për rastin e humbur. Në disa raste, të anketuarit kanë vërejtur se gjyqtarët hetohen për shkak të vonësive në procedurën gjyqësore, përkundër

pengesave të mirënjohura për zgjidhjen e rasteve, siç është rasti me numrin e madh të lëndëve të vjetra deri në dy vite. Krahas kësaj, të anketuarit kanë deklaruar se mënyra e hetimit nga hetuesit e SHIGJ-së krijon një ambient të pritjes dhe mosbesimit nga gjyqësia.

Një kritikë tjetër kishte të bënte me transparencën e procedurës së SHIGJ-së. Rregullat interne të SHIGJ-së të cilat e rregullojnë hetimin parashikojnë edhe masa mbrojtëse për jetën private të gjyqtarëve të hetuar. Ironike është se shumë të anketuar i kanë bërë vërejtje procesit të mbyllur, për shkak se ngritë dyshimet për parregullësi. Në një rast, një i anketuar ka shkuar aq larg, për të thënë se kryetari i gjykatës duhet të informohet kur gjyqtari i gjykatës së tij gjendet nën hetime. Në anën tjetër disa të anketuar do të preferonin një masë edhe më të lartë të konfidencialitetit gjatë hetimeve. Të anketuarit shprehën shqetësime të mëdha lidhur me fuqinë e SHIGJ-së për të ndikuar në reputacionin e gjyqtarit, veçanërisht kur Kosova ka një popullatë të vogël dhe me lidhje të fuqishme fafëfisnore. Disa të anketuar i kanë bërë vërejtje vendosjes së SHIGJ-së në kuadër të ekzekutivit, duke cituar ndikimin e mundshëm nga PSSP-ja në procesin disiplinor dhe hetimor. Shumë kanë sugjeruar që KGJPK-ja, ose sikurse në të kaluarën, kryetarët e gjykatave t'i nisin hetimet. Gjersa hetimet e inicuar nga kryetari i gjykatës do të mund ta eliminonin ndikimin e PSSP-së, ky proces do të ngriste shqetësime tjera të ndikimit të brendshëm.

Shumica e të anketuarve janë të mendimit se KGJPK-ja duhet të transformohet, por nuk kishin mendime të njëjta lidhur me mënyrën e transformimit. Të anketuarit kosovarë janë të prirur të mendojnë se shumica e anëtarëve të KGJPK-së duhet të jenë gjyqtarë të gjykatave të larta të vendit, me përfshirjen edhe të juristëve tjerë profesionistë, siç do të ishte përfaqësuesi i përhershëm nga Oda e Avokatëve. Për dallim nga kjo që u tha më sipër, të anketuarit ndërkombëtar kanë preferuar situatën ekzistuese të shumicës ndërkombëtare, duke i bërë vërejtje kohës, kur këshilli e kishte pasur shumicën kosovare, por kur nuk i ka respektuar rregullat procedurale. Si kosovarët ashtu edhe ndërkombëtarët, janë të pajtimit se numri i madh i ndërkombëtarëve ka shkaktuar pengesa dhe shpesh ka rezultuar në shtyerje të mbledhjeve për shkak të mungesës së kuorumit. Përbërja e KGJPK-së tanimë është ndryshuar dhe një gjyqtar ndërkombëtar është vendosur si kryesues i përhershëm i KGJPK-së.

Janë duke u shqyrtuar propozime të ndryshme për rolin e KGJPK-së dhe SHIGJ-së për transformimin e kompetencave të DD-së në IPVQ. Në mesin e propozimeve më të popullarizuara dhe të njohura është ndarja e KGJPK-së në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Edhe pse KGJPK-ja momentalisht e ka statusin e pavarur, ende vazhdon ta ndajë stafin administrativ me Seksionin për Zhvillim Profesional të DD-së. Pas tranzicionit të paraparë për fundin e vitit 2005, KGJPK-ja do ta ketë stafin e vet administrativ. Në propozimet e ndryshme, SHIGJ-ja do të vazhdojë të punojë nën kulmin e DD-së, të bëhet pjesë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ose të bëhet subjekt i pavarur.

Faktori 18: Caktimi i Lëndës

Gjyqtarëve i'u caktohen lëndët nëpërmjet një metode objektive, siç është lotaria (shorti), apo në bazë të fushave të tyre përkatëse të ekspertizës dhe mund t'ju merret lënda vetëm me arsye të fortë, siç është konflikti i interesave apo norma e madhe dhe jo e duhur e punës.

| Përfundim | Korrelacioni: Negativ | Trendi: ↔ |
|---|------------------------------|------------------|
| Kryetarët e gjykatave, vazhdojnë të gëzojnë një diskrecion të gjerë në caktimin e rasteve gjyqtarëve vendor dhe në përzgjedhjen e gjyqtarëve porotë për gjykime. Nuk ekziston ndonjë sistem për caktimin e rastësishëm të lëndëve për gjykatësit ndërkombëtarë. | | |

Analiza/Sfondi:

Metodat e caktimit të lëndëve dallojnë nga gjykata në gjykatë mirëpo, asnjëra nga to nuk është objektive. Kryetari i gjykatës zakonisht e bën caktimin e lëndëve në bazë të një sistemi të numërimit. Çdo lëndë i caktohet një numër i cili i përgjigjet një gjykatësi. Disa të anketuar u ankuan se kryetarët e gjykatave, në raste të caktuara, nuk ua caktojnë numrat lëndëve të reja, në bazë të arsytimit se lëndët e vjetra kanë prioritet. Në situatat e tilla, të anketuarit shpjeguan se përgjegjësia profesionale nuk kishte lënë kurrfarë alternative tjetër, përpos se t'i luten kryetarit të gjykatës që t'ia caktojë numrin lëndës përkatëse.

Sistemi i numërimit për caktimin e lëndëve, në praktikë nuk është gjithmonë objektiv. Për shembull, gjykata komunale në Prizren ka vetëm dy gjyqtarë civil, kështu që, kryetari i gjykatës thjeshtë i shkruan inicialet e njërit nga dy gjyqtarët në lëndët gjegjëse. Mirëpo, megjithatë të anketuarit janë përgjigjur se metoda objektive e caktimit të lëndëve është më e mirë, së paku në teori.

Të anketuarit e identifikuan çështjen e vonesës në caktimin e lëndëve si një problem të rëndësishëm. Vonesa në bazë të të anketuarve i atribuohet kryesisht numrit të madh të rasteve që nuk është në përpjestim me numrin e gjyqtarëve. Shumë më shumë lëndë paraqiten në gjykatë, se sa që zgjidhen, kështu që numri i lëndëve akumulohet shumë shpejtë. *Lexo* faktorin 27 (si më poshtë) për më shumë informata mbi vonesat në gjyqësinë e Kosovës.

Rregullat procedurale përshkruajnë renditjen në bazë të të cilës gjyqtarët duhet t'i marrin lëndët. Në përgjithësi, gjyqtarët vet i klasifikojnë lëndët "në pajtim me vlerën e tyre dhe karakterin urgjent" dhe vendosin se sipas cilës renditje do të merren në shqyrtim. *Lexo* RREGULLAT E BRENDSHME TË PUNËS SË GJYKATAVE, neni 178 (G.Z. KSAK 7/81 (më tutje në tekst RREGULLAT E BRENDSHME TË GJYKATAVE). Kategori të caktuara të rasteve, siç janë lëndët e marrëdhënies së punës përkufizohen me ligj si "urgjente", për shkak të pasojave të mundshme financiare (materiale) në paditësin, që nënkupton se ato kanë prioritet. Krahas kësaj, avokatët shpeshherë paraqesin kërkesa me shkrim gjykatës, duke kërkuar prioritet në zgjidhjen e lëndëve "urgjente". Megjithatë, në praktikë, gjyqtarët vetë pranojnë se shpeshherë duhet të improvizojnë metoda për t'u përballur me normën e madhe të punës. Një rast i ri mund të zgjedhet shumë më shpejtë, përderisa rasti i vjetër pret zgjidhjen dhe anasjelltas. Për më tepër, të anketuarit janë ankuar se ngarkesa me lëndë paraqet një mundësi për të qenë pre i korrupsionit. Në bazë të intervistave, palët dhe avokatët shpeshherë shkojnë te referenti dhe paraqesin kërkesa të pavend që ai të përshpejtojë rastet.

Pas kërkesës së parashtruar nga palët apo gjyqtari në fjalë, kryetari i gjykatës ka autoritet të largojë gjyqtarin profesionist apo atë porot nga rasti nën rrethana të caktuara si, konflikti i interesave, anshmëria, presioni i jashtëm, marrëdhëniet familjare apo për t'ju shmangur vonesës jo të duhur. KPPP Neni 40, KPP Neni 71. Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, gjithashtu kërkon përjashtimin e gjyqtarit nga procedura nëse ai/ajo ka marrë pjesë në cilëndo fazë të procedurës për të njëjtin rast ose për rastin tjetër me të njëjtin të pandehur. *Lexo* KPPP neni 40(2). Me fjalë tjera, Kodi kërkon që të jetë tjetër gjyqtarë ai i cili e udhëron paraburgimin, konfirmon aktakuzën dhe vendosë në shqyrtimin kryesor. Shumë të anketuar janë ankuar se këto dispozita të reja janë jopraktike për shkak se shumica e gjykatave nuk kanë mjaft gjyqtarë për t'i përmbushur këto kushte. Për më tepër, gjyqtarët dhe palët duhet ta informojnë kryetarin e gjykatës kur të fitojnë dijeni mbi rrethanat që domosdo kërkojnë largimin e gjyqtarit nga rasti. *Lexo id.neni 41; KPP neni 72*. Asnjë nga të anketuarit nuk ka konsideruar se kjo është një fushë problematike.

Caktimi i lëndëve për gjyqtarët ndërkombëtar është edhe më pak objektiv. Ekzistojnë disa kufizime të përgjithshme sa i përket juridiksionit territorial dhe atij lëndor që vlejnë për gjyqtarët ndërkombëtar, mirëpo ata vetë përcaktojnë nëse një lëndë bie në kuadër të parametrave të caktuar juridiksional. Lënda mund t'i transferohet kolegjit tre anëtarësh (me së paku dy gjyqtarë ndërkombëtarë) kur transferi është "i domosdoshëm për sigurimin e pavarësisë dhe paanësisë gjyqësore, ose për administrim të duhur të drejtësisë". Mirëpo, një transfer i tillë nuk është i

mundur nëse ka filluar gjykimi ose seanca për vendosje në shkallë të dytë. Lexo Rregulloren 2000/46 të UNMIK-ut mbi ÇAKTIMIN E GJYQTARËVE/PROKURORËVE NDËRKOMBËTARË DHE NDËRRIMIN E VENDIT TË GJYKIMIT. Në përgjithësi, shumica e rasteve të profilit të lartë dhe rasteve të ndieshme, tani gjykohen nga kolegjet e përbëra në pajtim me këtë rregullore. Edhe pse gjyqtarët ndërkombëtar duhet të punojnë në rastet vetëm në kuadër të rajoneve të caktuara, numri i vogël i tyre shpeshherë kërkon që këto lëndë të barten prej një rajoni në tjetrin.

Faktori 19: Shoqatat e Gjyqtarëve

Shoqata, qëllimi i vetëm i së cilës është të mbrohen dhe promovohen interesat e gjyqësisë, ekziston dhe është aktive.

| Përfundim | Korrelacioni: Neutral | Trendi: ↔ |
|---|------------------------------|------------------|
| Një shoqatë gjyqësore ekziston për të mbrojtur dhe promovuar interesat e gjyqësisë dhe kjo organizatë është duke u bërë gjithnjë e më aktive. | | |

Analiza/sfondi:

Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës (SHGJK) është themeluar më 11 maj 2001 në pajtim me statutin e SHGJK-së. Ekzistojnë pesë degë të cilat përfaqësojnë rajonet kryesore, Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjilan dhe Mitrovicë. SHGJK-ja vepron me kuvendin dhe bordin menaxhues dhe e njëjta strukturë përsëritet në secilin rajon. Detyrat e degëve rajonale kryesisht punojnë në mbledhjen e pagesave të anëtarësisë dhe i ndihmojnë bordit dhe organizatave ndërkombëtare për dhënje të asistencës teknike, në organizimin e ngjarjeve në rajonet gjegjëse. Disa partnerë ndërkombëtarë, rregullisht marrin pjesë në takimet e bordit menaxhues dhe shpesh konsultohen për çështjet lidhur me implementimin e projekteve të tyre.

Të gjithë gjyqtarët aktiv në Kosovë, pavarësisht përkatësisë etnike kanë të drejtë për anëtarësim në kuadër të SHGJK-së. Lexo STATUTI I SHGJK-së, neni 11, paragrafi 1. Edhe pse anëtarësia bëhet në baza vullnetare, (*lexo id. 2*), thuajse të gjithë gjyqtarët kosovarë janë anëtarë të shoqatës. Në kuadër të anëtarëve të SHGJK-së ka edhe gjyqtarë serb, turq, boshnjak dhe romë. Për t'u bërë anëtar i SHGJK-së, një gjyqtar, duhet të nënshkruajë formularin për anëtarësim, ku ceket se gjyqtari i pranon përgjegjësitë dhe gëzon beneficionet e parashikuara me statutin e SHGJK-së dhe dokumentet tjera bazë të SHGJK-së. Bordi menaxhues mëpastaj e pranon apo e hedh poshtë kërkesën. Lexo *id.* neni 11. Pagesa e anëtarësisë është 2.5 euro për muaj.

Në dhjetor 2004, të gjithë 15 gjyqtarët ndërkombëtar që punojnë në Kosovë, janë ftuar që të anëtarësohen në SHGJK. Edhe pse bordi menaxhues i SHGJK-së dëshiron që t'i përfshijë ata në kuadër të SHGJK-së, si anëtarë të barabartë, paraprakisht duhet të qartësohen disa çështje, p.sh., se a do të jenë anëtar të rregullt apo anëtarë bashkëpunëtor, sa do të jetë shuma e pagesës për anëtarësi dhe a do të kenë të drejtë për të shërbyer në kuadër të organeve menaxhuese apo grupeve punuese të SHGJK-së.

Që nga themelimi, SHGJK-ja është angazhuar në aktivitete të ndryshme, përfshirë këtu, seminarët mbi planifikimin dhe udhëheqjen strategjike, përpilimin e projekteve dhe mbledhjen e fondeve dhe kodin e etikës, të cilat seminare janë realizuar me ndihmë të ABA/CEELI-t. Krahas kësaj, SHGJK-ja e ka filluar një program gjyqësor për praktikantë (të mbështetur nga USAID-i dhe ABA/CEELI) për të përzgjedhur dhe mbështetur të diplomuarit e fakultetit juridik në kryerjen e praktikës një vjeçare në gjykatë. Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së, është pajtuar t'i përfshijë pjesëmarrësit e programit për praktikantë gjyqësor në trajnimet dhe seminarët të cilat i sponzoron për praktikantët e Odës së Avokatëve të Kosovës. Në vitin 2003, SHGJK-së i është dhënë një grant prej 5.000 Eurosh, nga Fondi për Shoqëri të Hapur, për Themelimin e Bibliotekës

Profesionale të Shoqatës. Në fund, shoqata publikon një gazetë tre-mujorsh për anëtarët e vet. Gjer më tani, SHGJK-ja ka publikuar tri botime të buletinit.

Të anketuarit kanë dhënë mendime të ndryshme në lidhje me SHGJK-në. Përderisa disa anëtarë janë shprehur për një të ardhme pozitive të kësaj organizate, të tjerët deklaruan se organizata duhet të përfshihet më shumë në promovimin e çështjeve me rëndësi për gjyqësinë. Tani për tani, aktivitetet nga degët rajonale përfshijnë ofrimin e ndihmës financiare për gjyqtarët e sëmurë dhe inicimin e koleksioneve të vogla të bibliotekave. Për më tepër, bazuar në të gjitha paramentrat, dega rajonale e Prishtinës nuk është aktive. Kryesuesi rajonal i Prishtinës ishte shkarkuar nga funksioni i kryetarit të gjykatës nga ana e KGJPK-së. Edhe pse ai nominalisht vazhdon ta kryejë punën e kryesuesit rajonal, të anketuarit e përshkruan degën e Prishtinës si një degë të cilës i mungon udhëheqësia.

V. Përgjegjshmëria dhe Transparenca

Faktori 20: Vendimet Gjyqësore dhe Ndikimi jo i Duhur

Vendimet gjyqësore bazohen kryesisht në fakte dhe ligj pa ndonjë ndikim jo të duhur nga gjyqtarët e rangut më të lartë (p.sh kryetarët e gjykatës), interesat private apo degët tjera të qeverisë.

| Përfundim | Korrelacioni: Negativ | Trendi: ↔ |
|--|------------------------------|------------------|
| Gjyqësia e Kosovës është objekt i ndikimeve të jashtme, kryesisht nga interesat private. | | |

Analiza/Sfondi:

Ligji mbi Gjykatat e Rregullta thekson se “gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor, gjykatat janë të pavarura dhe vendimet e tyre i marrin bazuar në ligjin në fuqi”. Lexo nenin 6. Kjo dispozitë është ripërsëritur edhe në ligjet tjera procedurale në fuqi. Lexo KPPP neni 8; LPP, neni 7.

Në praktikë, shumica e gjyqtarëve të Kosovës, megjithatë janë objekt i ndikimit të jashtëm nga një numër burimesh, por kryesisht nga interesat private. Për pjesën më të madhe të gjyqtarëve, ata nuk kanë hetuar ose ndier ndonjë presion nga gjyqtarët tjerë ose nga zyrtarët qeveritarë apo institucionet. Të anketuarit nuk ishin të qartë sa i përket ndikimit që ushtrojnë mediat në gjyqtarë mirëpo, besojnë se mediat nuk janë një burim i qëndrueshëm që publiku të mësojë për gjyqësinë.

Shumica e të anketuarve pranuan faktin se gjyqësia është e ndjeshme ndaj presioneve shoqërore nga miqtë, familja dhe komuniteti. Kosova është një vend i vogël me lidhje të forta familjare dhe shoqërore. Ndonjëherë gjyqtarët janë viktima të dhunës, pranojnë kërcënime direkte apo mund të jenë objekt i frikësimeve edhe më të ndjeshme nëpërmjet thirrjeve të përsëritura telefonike apo letrave. Disa të anketuar mendojnë se shkalla e rrezikut nga ndikimet e jashtme është rritur për shkak të faktit se gjyqtarët kanë filluar të merren me raste të krimit të organizuar. Gjyqësia vendore mund të kërkojë nga gjyqtarët ndërkombëtar që t'i lirojnë ata nga kjo barrë duke i marrë përsipër këto raste. Shumë të anketuar pranojnë rolin e rëndësishëm që mund të luajë gjyqësia ndërkombëtare. Megjithatë, të anketuarit theksuan se është bërë shumë pak për të adresuar çështjen e ndikimit të jashtëm, edhe pse gjyqtarët kanë ngritur këtë çështje në forume të ndryshme.

Shumica e të anketuarve u pajtuan se gjyqësia nuk i është nënshtruar në dozë të madhe korrupsionit përkundër pagave të ulëta. Përkundër kësaj, sipas një sondazhi të bërë nga mediat

kohëve të fundit, është bërë me dije perceptimi i dobët nga publikut për gjyqësinë – publiku e rangoi gjyqësinë si institucionin qeveritar të tretë nga fundi në besimin publik.

Të anketuarit dhanë përgjigje të ndryshme përkitazi me pavarësinë e gjyqësisë ndërkombëtare. Disa besuan se gjyqtarët ndërkombëtar veprojnë në mënyrë të pavarur nga ndikimi i UNMIK-ut. Të tjerët besojnë se politika e KB-së ndikon në vendimet për të ndjekur penalisht njerëzit e caktuar dhe se kjo politikë bartet edhe në kuadër të gjyqësisë ndërkombëtare të angazhuar nga KB-të. Përmendet edhe një rast në të cilin, siç pohohet administrata ndërkombëtare ka shpërdorur pushtetin e vet duke mos zgjatur kontratën për një gjyqtar ndërkombëtar i cili, në një vendim të vetin nuk i është përmbajtur kërkesës së administratës ndërkombëtare. Disa të anketuar cituan disa shembuj të ndikimit të UNMIK-ut ku, gjyqtarët ndërkombëtar kishin pranuar thirrje telefonike nga zyrtarë të UNMIK-ut gjatë punës së tyre në kolegji gjyqësor, edhe pse disa të anketuar të tjerë i kundërshtuan këta shembuj. Ende ekziston një përshtypje në mesin e të anketuarve se gjyqtarët ndërkombëtar shfaqin një butësi më të madhe në rastet e shqiptimit të dënimeve. Në veçanti disa të anketuar vërejtën se gjyqtarët ndërkombëtar shumë rrallë rekomandojnë shqiptimin e masës së paraburgimit për të pandehurit serb, edhe pse pjesëtarët e pakicave tjera nuk përfitojnë në të njëjtën mënyrë. Të anketuarit i'a atribuojnë këtë butësi politikës *ditore*. ABA/CEELI nuk e ka verifikuar nëse faktet e mbështesin këtë përshtypje.

Faktori 21: Kodi i Etikës

Kodi gjyqësor i etikës ekziston për të adresuar çështjet madhore siç janë, konflikti i interesave, komunikimi ex parte, dhe aktiviteti politik jo i duhur dhe nga gjyqtarët kërkohet që t'i nënshtrohen trajnimit përkitazi me këtë kod, si para ashtu edhe gjatë realizimit të funksionit të gjyqtarit.

| Përfundim | Korrelacioni: Neutral | Trendi: ↔ |
|--|------------------------------|------------------|
| Kodi gjithëpërfshirës i etikës profesionale për gjyqtarë dhe kodi i etikës profesionale për gjyqtarë porotë (ndihmësgjyqëtarë) ekziston, mirëpo, nga gjyqtarët nuk kërkohet t'i nënshtrohen trajnimit në lidhje me të. | | |

Analiza/Sfondi:

Në Kosovë ekzistojnë dy kode gjyqësore të etikës me titujt “Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë”(më tutje KODI I ETIKËS PËR GJYQTARË) dhe “Kodi i Etikës dhe Sjelljes për Gjyqtarët Porotë”(më tutje KODI I ETIKËS PËR GJYQTARË POROTË). Në vitin 2001, këto kode i ka aprovuar Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës (KGJPK). Që nga ajo kohë, përmbajtja e kodeve mbetet e pandryshuar. Nga gjyqtarët kërkohet që në kryerjen e detyrave të veta, të veprojnë me integritet, paanshmëri, objektivitet, të pavarur, me zellshmëri si gjatë mandatit në kuadër të detyrave, ashtu edhe jashtë mandatit të tyre gjyqësor. Ata duhet t'i bazojnë vendimet e tyre në faktet e rastit dhe në ligjin në fuqi, të lirë nga ndikimet, presionet ose kërcënimet dhe duhet t'i shmangen konfliktit të interesave. *Lexo KODIN E ETIKËS PËR GJYQTARË*, neni II. A. 3; *KODI I ETIKËS PËR POROTË*, neni. II. A. 3. Aktivitetet jashtë gjyqësore kufizohen në fjalime, shkrime, ligjërata, mësimdhënje dhe pjesëmarrje në aktivitetet që kanë të bëjnë me “ligjet, sistemin juridik dhe administrimin e drejtësisë”, si dhe në “aktivitetet sociale, rekreative dhe bëmirëse”. *Lexo KODIN E ETIKËS PËR GJYQTARË* neni II.B.1. Shprehimisht ndalohet përfshirja e gjyqtarëve në aktivitetet politike ose në organizatat diskriminuese. *Id. neni II.B.2-3; KODI I ETIKËS PËR GJYQTARË II.B.2-3*. Përfundimisht, gjyqtarët profesionistë duhet “t'i shmangen ose ta dekurajojnë komunikimin *ex parte*”, përveç në rastet e parashikuara me ligj, dhe bisedën e zhvilluar gjatë atij komunikimi duhet ta zbulojë menjëherë edhe për palët tjera. *KODI I ETIKËS PËR GJYQTARË* neni III.A.7.

Në teori, kodet vlejné njësoj si për gjyqtarët vendor ashtu edhe për ndërkombëtar në Kosovë, por nuk ekziston ndonjë organ i posaçëm i cili do të kishte pushtet për të hetuar shkeljet etike të gjyqtarëve ndërkombëtar. Për dallim nga kjo, KGJPK-ja në bashkëpunim me NIGJ-në e DD-së, rregullisht i heton dhe shqyrton shkeljet etike të gjyqtarëve të Kosovës. Që nga tetori 2004, KGJPK-ja, për shtatë raste të shkeljes së Kodit të Etikës, ka shqiptuar sanksione përkatëse. Lexo Raportin Javor të Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut: java e 12 – 18 tetorit 2004.

Disa çështje të rëndësishme etike, siç janë, konflikti i interesave dhe ndalimi i angazhimit në aktivitete jashtë gjyqësore të papërshtatshme, gjithashtu rregullohen me një numër rregulloresh të UNMIK-ut dhe Ligjin mbi Gjykatat e Rregullta. Në përgjithësi ligji në fuqi ua ndalon gjyqtarëve angazhimin në aktivitete të cilat mund të ndikojnë në objektivitetin e tyre, në pavarësinë ose reputacionin e tyre në shoqëri, ose që në mënyrë tjetër, nuk janë të përshtatshme për funksionin e gjyqtarit, përfshirë këtu, mbajtjen e funksioneve tjera administrative, angazhimin në ndonjë profesion tjetër me pagesë ose pa pagesë dhe angazhimin në aktivitete politike. Lexo LIGJIN MBI GJYKATAT E RREGULLTA, neni 12, 74; RREGULLORJA MBI KGJPK, §§ 5.5-5.6; RREGULLORJA MBI EMËRIMIN DHE SHKARKIMIN E GJYQTARËVE NDËRKOMBËTARË § 4.2; URDHËRESA ADMINISTRATIVE MBI KOLEGJIN E VEÇANTË PËR ÇËSHTJET E AKM-së § 4.1. Në të njëjtën kohë, KGJPK-ja mund ta autorizojë gjyqtarin të merret me aktivitete të jashtme siç janë, dhënja e ligjëratave ose kryerjen e funksionit në kuadër të kompetencave të tij, nëse këto “nuk ndikojnë në pavarësinë dhe dinjitetin” e funksionit të gjyqtarit. Lexo RREGULLOREN MBI KGJPK-në § 5.5.

Nga gjyqtarët nuk kërkohet t’ju nënshtrohen trajnimeve mbi etikën para dhe gjatë kryerjes së funksionit të gjyqtarit. Megjithatë, gjatë kryerjes së kursit obligativ fillestar në IGJK, gjyqtarëve u ipen udhëzime mbi kodin e etikës gjyqësore. Krahas kësaj, IGJK-ja dhe organizatat tjera mbajnë seminare periodike përkitazi me etikën gjyqësore. Në vitin 2003, IGJK-ja ka mbajtur katër seminare dy-ditore mbi etikën gjyqësore. Duke marrë pjesë në këto seminare dhe në kursin fillestar, shumica e gjyqtarëve duhet ta kenë marrë nga një kopje të Kodi të Etikës për Gjyqtarë. Krahas kësaj në korrik 2004, në Buletinin e Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës është publikuar një artikull mbi “Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë”.

Projekti për Reformën Gjyqësore i udhëhequr nga Qendra Nacionale për Gjykatat Shtetërore (NCSC), në mes tjerash, fokusohet edhe në etikën gjyqësore. Së pari, sipas projektit kërkohet që të themelohet një Organ Auditor në kuadër të Shërbimit për Inspektim Gjyqësor, siç parashihet me Urdhëresën Administrative mbi SHIGJ-në për të shqyrtuar rezultatet e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për të vlerësuar sistemin e tanishëm të etikës/disiplinës, për të identifikuar nevojat për trajnim dhe për të ndihmuar trajnimet për çështjet e etikës.” Krahas kësaj NCSC-ja do t’i ndihmojë IGJK-së në organizimin e trajnimeve mbi etikën gjyqësore.

Disa të anketuar rekomanduan që Kodi i Etikës për Gjyqtarë dhe ai për Porotë të botohet dhe t’i shpërndahet secilit person që punon në kuadër të sistemit gjyqësor, filluar nga kryetari i gjykatës e deri te pastruesi. Të anketuarit theksuan rëndësinë që i gjithë stafi i gjykatës, e jo vetëm gjyqtarët, ta kuptojnë se si etika gjyqësore mund të ndikojë në përgjegjësitë e tyre të punësimit.

Faktori 22: Procesi i Paraqitjes së Ankesës ndaj Sjelljeve Gjyqësore

Një proces kuptimplotë ekziston në bazë të të cilit gjyqtarët, juristët dhe publiku mund të paraqesin ankesa përkitazi me ndonjë sjellje të caktuar gjyqësore.

| | | |
|--|------------------------------|------------------|
| Përfundim | Korrelacioni: Neutral | Trendi: ↔ |
| <p>Ekziston një proces kuptimplotë i ankesave në bazë të të cilit gjyqtarët, avokatët dhe publiku mund të paraqesin ankesë përkitazi me ndonjë sjellje të caktuar gjyqësore. Publiku është i informuar mirë për këtë proces, edhe pse gjyqtarët e kritikojnë mënyrën se si kryhen hetimet.</p> | | |

Analiza/Sfondi:

Një proces kuptimplotë i ankesave ekziston në bazë të të cilit gjyqtarët, juristët dhe publiku mund të paraqesin ankesë përkitazi me ndonjë sjellje të caktuar gjyqësore dhe është i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut mbi KGJPK-në dhe Urdhëresën Administrative mbi SHIGJ-në. Me Urdhëresën Administrative, themelohet Shërbimi për Inspektim Gjyqësor në kuadër të Departamentit të Drejtësisë, për të hetuar pohimet për sjellje të pahijshme nga ana e gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe prokurorëve si dhe për kryerjen e auditimeve gjyqësore. Siç përshkruhet në Faktorin 17 më lartë, SHIGJ i pranon ankesat nga çdokush përfshirë edhe personat anonim. Bazuar në pohimet e ankesës, SHIGJ i zhvillon hetimet dhe rezultatet e hetimeve ia prezenton Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, i cili e shqyrton dosjen dhe përcakton nëse shkelja në të vërtetë ka ndodhur dhe e përcakton sanksionin e duhur. Lexo Faktorin 17 për më shumë hollësi lidhur me këtë procedurë dhe statistikën.

Publiku i Kosovës duket të jetë i informuar mirë për procesin ankimor gjyqësor. Në të njëjtën kohë, shumë të anketuar nuk ishin të kënaqur me mënyrën e veprimit të SHIGJ-së. Ata mendonin se procesi ishte i manipuluar nga individët që dëshirojnë të kryejnë hakmarrje personale kundër gjyqtarëve apo nga individët të cilët kanë e keqkuptuar rolin e SHIGJ-së si një vend tjetër ku mund të ankohen. Në bazë të të anketuarve palët ndonjëherë i kërcënojnë gjyqtarët duke bërë ankesa formale në SHIGJ. Për shembull, në një rast, një palë i kishte dërguar letër një gjyqtari duke e kërcënuar atë se do të ankohet kundër tij në OSBE dhe UNMIK, nëse gjyqtari nuk e përshpejton rastin. Në këtë drejtim të anketuarit deklaruan se SHIGJ duhet të bëjë dallim se cilat raste do t'i përzgjedh për procedim.

Faktori 23: Qasja e Publikut dhe Mediave në Procedurë

Procedurat në gjykatore janë të hapura dhe mund të akomodojnë si publikun ashtu edhe mediat.

| | | |
|---|------------------------------|------------------|
| Përfundim | Korrelacioni: Pozitiv | Trendi: ↔ |
| <p>Në përgjithësi, gjykatoret janë të hapura për publikun dhe mediat. Megjithatë gjykatoreve i'u mungon hapësirë e mjaftueshme për të gjetur vend për secilin që dëshiron t'i përcjellë gjykimet.</p> | | |

Analiza/Sfondi:

Në bazë të ligjeve të aplikueshme procedurale, gjykimet janë të hapura për publikun. Lexo KPPP, neni 328; LPP neni 306. Megjithatë trupi gjykues mund të përjashtojë publikun me propozim të palëve apo sipas detyrës zyrtare pas dëgjimit të palëve. Lexo KPPP neni 329; LPP neni 307. Publiku mund të përjashtohet me qëllim të mbrojtjes së sekretit, moralit publik, interesit të personit të mitur ose interesave të caktuara. Lexo LIGJIN MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 7; LPP neni 307. Arsyet e mundshme për përjashtim janë: mbrojtja e sekretit zyrtar; mbrojtja e informatave të fshehta; rendi dhe ligji; mbrojtja e jetës personale të palëve; interesat e fëmijëve apo mbrojtja e palëve të dëmtuara dhe të dëshmitarëve. Lexo KPPP nenin 329. Në gjykimet jopublike gjyqtari mund të bëjë përjashtim për disa zyrtarë të caktuar, akademikë, figura publike apo anëtar të familjes. Lexo KPPP nenin 330(2); LPP neni 308. Në të njëjtën kohë, me ligj

ndalohet “fotografimi, filmimi, transmetimi televiziv ose inçizimet tjera me pajisje teknike, të seancës për konfirmim ose të shqyrtimit gjyqësor”, edhapse kryetari i gjykatës ose Kryetari i Gjykatës Supreme, përjashtimisht mund ta autorizojnë inçizimin e shqyrtimit gjyqësor. *Lexo* KPPP neni 93(2)-(3). Është e dukshme që shumë gazetarë dhe gjyqtarë nuk janë në dijeni për këtë ndalëse.

Antarët e gjyqësisë në përgjithësi pohuan se, edhapse seancat janë të hapura për publikun në bazë të ligjit, hapësira e pamjaftueshme si në aspektin e numrit të vogël të gjykatoreve gjithashtu edhe për shkak të madhësisë së tyre të vogël, e pengon pjesëmarrjen e publikut dhe mediave në seancat gjyqësore. Shumica e gjykimeve mbahen në zyret e gjyqtarëve, të cilat janë tejet të vogla për të ofruar hapësirë të mjaftueshme për publikun dhe mediat për të marrë pjesë në to. Në rastet sensitive me më shumë të pandehur, gjykimet shpeshherë zhvendosen në ndonjë vend tjetër për të akomoduar anëtarët e familjes dhe mediat. Për shembull, gjykimet e rasteve të Dukagjinit dhe Llapit, që kishin të bënin me ish pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) të akuzuar për krime të luftës, ishin zhvendosur për t’u mbajtur në një auditorium jashtë objektit të gjykatës, për ta akomoduar një numër të madh të vizitorëve të cilët dëshironin të merrnin pjesë në gjykim. Në rastet tjera, gjykata mund ta kufizojë pjesëmarrjen e personave të cilët nuk janë pjesëmarrës në procedurë ose nuk janë anëtarë të familjes.

Të anketuarit gjithashtu komentuan se gjyqtarët janë të hutuar për atë se cilat seanca duhet të jenë të hapura për publikun dhe mediat. Në disa raste gjyqtari nuk ka mundësi t’iu ofrojë gazetarëve udhëzime në lidhje me atë se a duhet të zbulohet identiteti i dëshmitarit apo viktimës. Sipas OSBE-së gjyqtarët e Kosovës nuk informojnë në mënyrë konsistente publikun në lidhje me datat, kohën dhe vendin ku do të mbahen gjykimet, duke rezultuar kështu në pengesa të mëdha për sigurimin e informatave dhe duke e penguar efektivisht parimin e publicitetit të gjykimit. *Lexo gjithashtu Shqyrtimin e OSBE- mbi Gjykatat Komunale, faqe 25-26.* Në shkurt 2004, Departamenti i Drejtësisë e ka nxjerrë Qarkoren e Drejtësisë 2003/7, mbi qasjen e publikut në drejtësi, duke e shtyer Departamentin e Administratës Gjyqësore që ta sigurojë qasjen e publikut në gjykime. *Id. f. 26.*

Të anketuarit nga radhët e mediave deklaruan se pengesa kryesore me të cilën përballen në realizimin e qasjes në gjykime, është hapësira e vogël në gjykatore. Të anketuarit shtuan se policia ndërkombëtare e cila është përgjegjëse për mbajtjen e rendit në gjykatore, shpeshherë e keqpërdor hapësirën e vogël për t’i përjashtuar mediat. Të anketuarit më tutje kishin vërejtur se, kur gazetarët e kritikonin policinë nëpër gazeta, policia ndërkombëtare përgjigjej ndaj këtyre kritikave duke i përjashtuar mediat nga gjyktorja dhe duke ua mbajtur armët afër gazetarëve për t’i bërë ata që të mos ndihen komfor.

Të anketuarit deklaruan se gazetarët e mediave transmetuese përballen me shumicën e barrierave gjatë qasjes së tyre në gjykatore. Kodi Penal kërkon që gazetarët e mediave transmetuese të kërkojnë leje nga Gjykata Supreme për të fituar qasje. *Lexo* nenet 93. 335, ku kjo, sipas të anketuarve shpeshherë e refuzon kërkesën e tyre. Kodi i Përkohshëm Penal, neni 93 dhe 335. Gazetarët u ankuan se ata nuk kanë mundësi për t’u ankuar kundër vendimit për refuzim. Për më tepër, sipas të anketuarve, disa gjyqtarë e tejkalojnë pushtetin e tyre duke e zgjeruar kushtin për leje pranë Gjykatës Supreme edhe për gazetarët e mediave të shtypura, duke kërkuar që edhe këta të fundit ta sigurojnë lejen për të fituar të drejtën e hyrjes në gjykatore.

Në disa raste sensitive gjyqtarët ndërkombëtar mund t’i përjashtojnë përfaqësuesit e mediave nga gjyktorja. Të anketuarit shpjeguan se përjashtimi i mediave nga gjykimi siguron që mediat ta paraqesin vetëm njërën anë dhe atë të personit i cili ishte më i lehtë që mediat t’i qasen, në këtë rast, pra të avokatit mbrojtës.

Faktori 24: Publikimi i Vendimeve Gjyqësore

Vendimet gjyqësore janë dokumente zyrtare kështuqë madje edhe vetë vendimet e rëndësishme që jepen në instancën e apelit, publikohen dhe janë të hapura për shqyrtim akademik dhe publik.

| Përfundim | Korrelacioni: Negativ | Trendi: ↔ |
|---|------------------------------|------------------|
| Vendimet gjyqësore nuk vihen në dispozicion për publikun, por vendimet finale në përgjithësi janë në dispozicion të palëve të përfshira në rast dhe të palëve tjera të interesuara. Shumë vendime të instancës së apelit nuk janë bërë publike ende për shqyrtim akademik dhe publik. | | |

Analiza/Sfondi:

Ligji mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare, i përcakton rregullat sipas të cilave “çdo banor i përhershëm i Kosovës”, dhe “cilido person fizik ose juridik që banon ose zyra e të cilit është regjistruar në Kosovë”, të ketë të drejtë të qasjes në dokumentet zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes. *Lexo në përgjithësi, LIGJIN E KUVENDIT TË KOSOVËS, Nr. 2003/12, MBI QASJEN NË DOKUMENTET ZYRTARE (të shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr.2003/32(më tutje në tekst, LIGJI MBI QASJEN NË DOKUMENTET ZYRTARE).* Këto rregulla” vlejnë për të gjitha dokumentet që mbahen në një institucion, të hartuara apo të pranuar nga institucioni dhe që janë në pronësi të tij,” *Id. § 3.3.* “Dokumentet” janë identifikuar si “çdo përmbajtje pavarësisht nga forma...lidhur me politikën, aktivitetet dhe vendimet që i takojnë sferës së përgjigjesisë së institucionit”. *Id. § 2(b).* Prandaj, vendimet gjyqësore, parimisht do të duhej të klasifikoheshin si “dokumente zyrtare” sipas këtij ligji. Sipas Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare, “dokumentet janë të hapura për publikun ose në bazë të kërkesës së bërë me shkrim ose në bazë të kërkesës së drejtpërdrejtë, në formë elektronike apo përmes regjistrit.” *Id. § 3.4.* Qasja e publikut në dokumentet zyrtare mund të refuzohet vetëm në rrethanat e caktuara, me ç’rast zbulimi i dokumenteve do të mund të ndikonte negativisht në mbrojtjen e intersit publik që ka të bëjë me sigurinë publike, mbrojtjen dhe çështjet ushtarake, marrëdhëniet ndërkombëtare, si dhe në interesat private dhe integritetin e individit. Më tej, institucionet mund ta refuzojnë qasjen në dokumente, bërja publike e të cilave do të rrezikonte mbrojtjen e interesave komercial të personave fizik apo juridik (përfshirë pronën intelektuale), procedurave gjyqësore apo këshillimit ligjor, përveç nëse ekziston interesi qenësor publik për hapjen e tyre. *Id. §§ 4.1-4.2.*

Në të njëjtën kohë, ligjet procedurale në fuqi përmbajnë dispozita të ndryshme lidhur me qasjen e publikut në vendimet gjyqësore. Vendimet gjyqësore nuk publikohen për publikun e përgjithshëm, mirëpo ato shkruhen dhe vihen në dispozicion të palëve të lëndës dhe palëve tjera të interesuara. *Lexo KPPP nenet 89, 123, 395; LPP nenet 150, 337.* Nga kjo bëjnë përjashtim vendimet e lëshuara nga Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme për Çështjet e AKM-së, për të cilat, krahas komunikimit të tyre palëve, ato gjithashtu duhet të jenë të hapura për publikun. *Lexo Rregulloren për Kolegjin e Veçantë për Çështjet e AKM-së §§ 9.4-9.5.* Kategoria “palë e interesuar” është e përkufizuar me ligj, mirëpo përcaktimin përfundimtar se kush është palë e interesuar e bën kryetari i trupit gjykues, gjyqtari i procedurës paraprake apo prokurori varësisht nga lloji i procedurës.

Qendra Juridike e Kosovës (QJK), ka publikuar dy botime të Buletinit të Gjykatës Supreme, ku janë shtypur ekstraktet nga vendimet e lëshuara. Buletini i parë mbulon periudhën prej 1999-2002, ndërsa i dyti periudhën prej 2002-2004. QJK-ja ka fonde për publikimin edhe të dy botimeve të buletineve tjera dhe do të përpiqet ta vazhdojë publikimin. QJK-ja do të përpiqet që në të ardhmen të përfshijë edhe vendimet e gjykatave të qarkut. Edhe pse janë të publikuara vendimet e Gjykatës Supreme të lëshuara para vitit 1989, ato nuk janë në dispozicion të gjerë. Shumë të anketuar mendojnë se në veçanti, vendimet e Gjykatës Supreme duhet të vihen në

dispozicion të publikut. Një i anketuar e ka përshkruar me vend qasjen, si një formë e arsimimit të vazhdueshëm ligjor për avokatë dhe gjyqtarë, si dhe për publikun në mënyrë që të jenë në gjendje të parashikojnë se si Gjykata Supreme do të vendos në rastet e ngjashme. Të anketuarit deklaruan se do të ishte e përshtatshme që të shlyhen emrat e palëve nga vendimet, dhe se koleksioni i vendimeve gjyqësore, që do të shërbente për referim, do të luante një rol të rëndësishëm për edukimin e publikut në lidhje me sundimin e ligjit.

Rritja e qasjes së publikut në vendimet gjyqësore, është përmendur si një nga aktivitetet e projektit për reformimin e gjyqësisë së Kosovës, të udhëhequr nga Qendra Kombëtare për Gjykatat Shtetërore (NCSC). Veçanërisht ky projekt do të “krijojë programin për shtypjen dhe azhurimin e verzioneve momentale të ligjeve, rregulloreve dhe precedentit gjyqësor. Këto koleksione do të ipen në dispozicion në shumë gjuhë, të organizuar dhe të rënditura sipas lëndës, dhe do t’i shpërndahen gjykatave dhe komunitetit ligjor. Së dyti, ky projekt do të angazhohet në zhvillimin e kapaciteteve të gjykatave, me qëllim të plotësimit të nevojave të publikut për informim.”

Faktori 25: Mirëmbajtja e Procesverbalit Gjyqësor

Procesverbali dhe shkresat tjera të procedurës gjyqësore mirëmbahen dhe janë në dispozicion të publikut.

| Përfundim | Korrelacioni: Negativ | Trendi: ↔ |
|---|------------------------------|------------------|
| Gjykatat nuk përpilojnë procesverbale fjalë për fjalë dhe shkresat e lëndës nuk mund të merren lirshëm nga publiku. | | |

Analiza/Sfondi:

Gjykatat nuk përpilojnë procesverbale fjalë për fjalë. Zakonisht procesverbali bazohet në përmbledhjen gojore të gjyqtarit, edhe pse ligji parashikon edhe regjistrimin me stenogram dhe metoda tjera të video-audio inçizimeve. Lexo KPPP, nenet 86, 90, 92, 348; LPP neni 126; RREGULLAT E BRENDSHME TË GJYKATAVE, nenet 182-86. Në disa raste, kryetari i trupit gjykues, mund të urdhërojë që pjesë të caktuara të procedurës (p.sh., deklarata) të regjistrohen tekstualisht (fjalë për fjalë). Lexo KPPP, neni 349. Për dallim nga IRGJ e Kosovës - 2002, shumë të anketuar nuk ishin të kënaqur me cilësinë e procesverbaleve. Sipas të anketuarve, procesi i parafrazimit gjyqësor i nështrohet gabimeve, përveç kur avokati e dëgjon me kujdes diktimin e gjyqtarit dhe i jep vërejtjet sipas nevojës. Shumë të anketuar mendojnë se duhet të përdoren makinat stenografike apo ndonjë mjet tjetër, për inçizimin fjalë për fjalë të procesverbalit.

Për dallim nga kjo, procesverbalet e gjyqtarëve ndërkombëtar ishin lavdëruar për shkak se ishin të përpiluara fjalë për fjalë (tekstualisht). Disa gjyqtarë kosovar kanë filluar ta ndjekin këtë shembull dhe herë pas here kërkojnë nga avokatët që ta përsërisin atë çka kanë thënë, në mënyrë që të regjistrohen deklaratat me saktësi.

Si rregull publiku i përgjithshëm nuk ka qasje në kopjet ose procesverbalet gjyqësore. Përndryshe vetëm palët në procedurë kanë qasje direkte në to, ndërsa palët e interesuara mund të fitojnë qasje vetëm me lejen e kryetarit të gjykatës. Lexo LIGJIN MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 113; KPPP neni 89(1), 350; LPP neni 150. Për më tepër, edhe përkundër rregullave, disa gjyqtarë refuzojnë t’u japin kopjet e procesverbalit avokatëve. Me rastin e refuzimit të dhënjes së procesverbalit, avokati duhet t’ia bëjë një kërkesë me shkrim kryetarit të gjykatës, i cili e detyron gjyqtarin, që avokatit t’i jap dokumentet e kërkuara. Kur avokati është i caktuar sipas detyrës zyrtare nga gjykata, gjykata zakonisht ia ofron materialet avokatit, mirëpo mbetet të përmirësohet shpejtësia e këtij procesi. Për shkak se gjuhë zyrtare e procedurës, në rastet në të cilat kryetar i

trupit gjykues është gjyqtari ndërkombëtar, është gjuha angleze (*lexo në përgjithësi RREGULLOREN E UNMIK-UT NR. 2000/46 MBI PËRDORIMIN E GJUHËVE NË PROCEDURAT GJYQËSORE NË TË CILAT MARRIN PJESË GJYQTARËT DHE PROKURORËT NDËRKOMBËTAR*), vonesat zakonisht lindin për shkak të nevojës për përkthim.

Qendra Nacionale për Gjykatat Shtetërore (NCSC) është duke i ndihmuar Departamentit për Administratë Gjyqësore (DAGJ) për implementimin e disa projekteve për përmirësimin e cilësisë së procesverbaleve gjyqësore. Për shembull, një nga projektet ka të bëjë me instalimin e pajisjeve audioinçizuese në dhjetë gjykata eksperimentale, në pajtim me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale. Kompletimi i këtij audio projekti pritet të realizohet deri në fillim të vitit 2005. Një aktivitet tjetër i NCSC-së është projekti i menaxhimit të procesverbaleve (shkresave) për të përmirësuar ruatjen (arkivimin) e procesverbaleve. Për momentin, DAGJ është duke vlerësuar dosjet në arkivë për të përcaktuar se cilat dosje duhet shkatërruar.

VI. Efikasiteti

Faktori 26: Stafi Ndhmës i Gjykatës

Çdo gjyqtar ka përkrahje të nevojshme me resurse njerëzore, për ta kryer punën e tij apo saj, p,sh numër të mjaftueshëm dhe kualitativ të stafit ndihmës, për rregullimin e dokumentacionit dhe hulumtim ligjor.

| Përfundim | Korrelacioni: Negativ | Trendi: ↔ |
|--|------------------------------|------------------|
| Gjyqtarët nuk posedojnë numër të mjaftueshëm dhe kualitativ të stafit ndihmës, për ta ndihmuar gjyqtarin në kryerjen e detyrave administrative dhe substantive. Struktura e stafit ndihmës dallon prej gjykatave në gjykatë. | | |

Analiza/Sfondi:

Në përgjithësi të anketuarit janë shprehur të pakënaqur sa i përket stafit të tanishëm ndihmës me të cilin posedojnë, përzgjedhja e të cilit është kompetencë e DAGJ-së dhe pa kontribut efektiv të gjyqësisë. Madje edhe tabela e sistematizimit të vendeve të punës është përpiluar pa kontributin e gjyqësisë. Të anketuarit deklaruan se nevojitet një numër më i madh i stafit të gjykatës për të ndihmuar gjyqtarët në normën e madhe të tyre të punës. Me sygjerim të OSBE-së, DAGJ-i ka filluar ta adresojë këtë nevojë duke ia shtuar gjykatave nga një referent për ekzekutim.

Në vlerësimin e sistemit gjyqësor të Kosovës, të përgatitur nga Këshilli i Europës dhe Zyrës së SHBA-ve në Prishtinë, janë futur të dhënat nga viti 2003 lidhur me numrin e stafit ndihmës të cilët shërbejnë në secilën instancë gjyqësore.

NUMRI I STAFIT NDIHMËS NË GJYKATAT E KOSOVËS

| Shkalla e gjykatës | Stafi administrativ | Stafi i sekretarisë | Stafi teknik | Stafi i përkthyesve | Stafi shtesë | Gjithsejt: |
|--------------------|---------------------|---------------------|--------------|---------------------|--------------|------------|
| Kundërvajtje | 154 | 92 | 26 | 27 | 125 | 424 |
| GJLKundërv. | 5 | 4 | 1 | 1 | 3 | 14 |
| Komunale | 209 | 131 | 51 | 29 | 201 | 621 |
| E qarkut | 41 | 43 | 22 | 10 | 51 | 167 |
| Ekonomike | 7 | 10 | 3 | 1 | 9 | 30 |
| Gj.Supreme | 6 | 7 | 7 | 1 | 3 | 24 |
| Gjithsejt | 422 | 284 | 110 | 69 | 392 | 1280 |

Nxjerrë nga: Vlerësimi i Sistemit Gjyqësor të Kosovës, nga KE/DD,

Këto të dhëna sygjerorinë që mesatarisht se sistemi gjyqësor e ka të punësuar përafërsisht një nëpunës në cilësinë e ndihmësit, për një gjyqtar. Përafërsisht janë shtatë pozita të stafit administrativ (p.sh., administrator të gjykatës, referentë, referent për ekzekutim, arkatarë) për një gjykatë, dhe një numër pak më i vogël i stafit shtesë (psh., shtëpiakë, korier (lajmëtarë), roje të sigurisë, pastrues dhe vozitës). Në të njëjtën kohë, numri i stafit të sekretarisë është pak më i vogël se numri i tanishëm i gjyqtarëve, që domethënë se, gjyqtarët janë të detyruar kryejnë edhe punë të administratës të cilat më mirë do t'i kishin kryer stafi ndihmës. Mirëpo, e dhëna më shqetësuese është fakti se mesatarja e stafit teknik të gjykatave (bashkëpunëtorët profesional dhe praktikantët) është 0.35 për një gjyqtar, që nënkupton se, mesatarisht, një jurist ose praktikant është i angazhuar për tre gjyqtarë në detyrë. Mungesa e stafit ndihmës ligjor të trajnuar, i kontribuon produktivitetit më të ulët dhe efikasitetit më të dobët të gjykatave. Praktikantët dhe bashkëpunëtorët profesional mund të bëjnë hulumtime dhe t'i hartojnë aktgjykimet me shkrim, gjë që do ta shpejtonte në mënyrë të konsiderueshme procedimin e lëndëve. Këto pika janë ripërsëritur në raportin e sipërpërmendur të Këshillit të Europës dhe Zyrës së SHBA-ve në Prishtinë. *Lexo id. f. 89, 137, 198.*

Për më tepër, gjyqësia jep një kontribut vetëm formal në përzgjedhjen e stafit të gjykatës. Standardet dhe parimet për procesin e selektimit të stafit gjyqësor, udhëhiqen nga RREGULLORJA E UNMIK-UT Nr. 2001/36, për SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS, dhe NGA URDHËRESA ADMINISTRATIVE NR. 2003/2, për zbatimin e rregullores së lartpërmendur. Procesi i përzgjedhjes realizohet nëpërmjet Komisionit prej pesë personave i përbërë nga tre përfaqësues të DAGJ-së dhe dy përfaqësues të gjykatave të qarkut të cilat i kanë shpallur vendet e lira. Shumë të anketuar mendojnë se përbërja e Komisionit të Punësimit e bënë kontributin e gjyqësisë në procesin e punësimit si të pavlerë. Sidomos, të anketuarit pohuan se përfaqësuesit e gjykatave të qarkut zakonisht mbivotohen dhe si rrjedhojë e kësaj metodat e komisionit për punësim japin një përshtypje se DAGJ-i i ka përcaktuar paraprakisht kandidatët dhe kryesisht i përmbahen formalisht kërkesave të intervistës. Së këndejmi, anëtarët e gjyqësisë e shohin DAGJ-i si pjesë të degës së ekzekutivit dhe rolin e tij në punësimin e stafit të gjykatës, si cenim të pavarësisë së gjykatës.

Të anketuarit deklaruan se, si rezultat i pjesëmarrjes së kufizuar të gjyqësisë në procesin e përzgjedhjes së stafit gjyqësor, stafi i përzgjedhur i gjykatës është shpeshherë i pakualifikuar, jo i rregullt dhe i pa përgatitur për pozitat e tyre. Një përshtypje e përgjithshme është se nepotizmi dhe bindjet politike, luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e DAGJ-it për përzgjedhjen dhe punësimin e stafit gjyqësor. Për më tepër, të anketuarit besojnë se stafi ekzistues ka nevojë për trajnim më të mirë veçanërisht në përdorimin e kompjutorëve.

Të anketuarit tërhoqën vëmendjen përkitazi me rëndësinë e rolit të administratorit të gjykatës në funksionimin e lehtë të gjykatave. Administratori i gjykatës, në secilën gjykatë është *de facto* përgjigjës për administrimin dhe menaxhimin e tërësishëm të gjykatës (edhe pse në teori, ligji të gjitha këto funksione ia jepë kryetarit të gjykatës – *lexo* LIGJIN MBI GJYKATAT E RREGULLTA neni 55-56). Për momentin shumica e administratorëve të gjykatës kanë vetëm arsimim të mesëm dhe kanë nevojë për trajnim në menaxhimin modern dhe teknikat organizative si dhe shkathtësitë profesionale. Shumë administratorë me diplomë të fakultetit juridik, e kanë lënë punën me qëllim për t'u bërë gjyqtarë apo prokurorë. Të anketuarit i'a atribuojnë problemin e *ekzodurit* të administratorëve, pagave të ulëta dhe vetëbesimit të ulët për funksionin në fjalë. Për ta adresuar këtë problem, Qendra Nacionale për Gjykatat Shtetërore (NCSC) është duke planifikuar të ofrojë programe trajnuese dhe të themelojë Shoqatën e Administratorëve të Gjykatave të Kosovës.

Të anketuarit dhanë mendime të ndryshme përkitazi me faktin se a është stafi i gjykatës i përfshirë në korrupsion. Disa prej tyre deklaruan se stafi është përballur me disa mundësi për t'u përfshirë në korrupsion, përderisa të tjerët thanë se pozita e referentit nuk jepte mundësi të tilla. Pozita e referentit është e ngjashme me nëpunësin për pranimin e lëndëve. Referenti ia bashkangjet numrat kronologjik lëndëve dhe ua shërndanë gjyqtarëve sipas udhëzimeve të

kryetarit të gjykatës. Së këndejmi, duke vendosur për renditjen në bazë të të cilës lëndët do të dëgjohen, referenti ka mundësi që ta vonojë një lëndë ose që ta përshpejtojë. Palët janë të vetëdijshme për detyrat që i ka referenti dhe shumë lehtë mund t'i afrohen referentit për "intervenim." Të anketuarit theksuan se pagat duhet të rriten për të zvogëluar mundësinë e joshjes nga korrupsioni.

Si vërejtje e fundit funksioni i policisë gjyqësore i paraparë me Kodin e Përkohshëm Penal ende nuk është zhvilluar. Duket se ekziston huti në lidhje me atë se a do të përshpëtojë më mirë policia gjyqësore në kuadër të shërbimit policor apo në gjyqësi. Përkohësisht, UNMIK-u i'a ka dhënë pushtetin e policisë gjyqësore njërive hetuese të stacioneve të ndryshme policore, për të vepruar në bashkëpunim me prokurorin publik.

Faktori 27: Pozitat Gjyqësore

Ekziston sistemi i tillë ashtuqë pozitat e reja gjyqësore të kenë mundësi të krijohen sipas nevojës.

| Përfundim | Korrelacioni: Neutral | Trendi: ↔ |
|---|------------------------------|------------------|
| Nuk ekziston kurrfarë sistemi për krijimin e pozitave gjyqësore sipas nevojës. Megjithatë numri i pozitave për momentin është objekt i revidimit. | | |

Analiza/Sfondi:

Nuk ekziston kurrfarë sistemi për krijimin e pozitave gjyqësore sipas kërkesës. Departamenti i Drejtësisë (DD-ja) dhe Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës (KGJPK-ja) janë përgjegjës për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve. Edhe pse norma e punës është rritur shumë, numri i anëtarëve të gjyqësisë nuk është rritur përshtatshëm.

Që nga tetori 2004, në detyrë ishin 313 gjyqtarë në Kosovë, krahasuar me numrin prej 363 të paraparë me buxhet. Prej tyre, 14 gjyqtarë shërbejnë në Gjykatën Supreme, pesë në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje, 46 në gjykatat e qarkut, nëntë në Gjykatën Ekonomike të Qarkut, 139 në gjykatat komunale, dhe 100 gjyqtarë në gjykatat për kundërvajtje. Prandaj, përafërsisht 14% e pozitave gjyqësore kanë mbetur të paplotësuara. Numri më i madh i vendeve të lira është regjistruar në gjykatat komunale (26 vende të lira) dhe gjykatat për kundërvajtje (18 vende të lira); ndërsa në gjykatat e qarkut, gjykatën ekonomike dhe Gjykatën Supreme, secila prej tyre i kishte nga dy vende të lira. Në të njëjtën kohë, të gjitha pozitat në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje ishin plotësuar. *Lexo Raportin Javor të Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut: java 12-18 tetor 2004.* Disa gjykata kanë më pak gjyqtarë në detyrë se sa para njëzet viteve. Sa për krahasim, në vitin 1989, vetëm në gjykatat komunale në Kosovë kanë qenë të angazhuar gjithsej 185 gjyqtarë, gjë që sugjeron për një zbritje prej 20% të numrit të gjyqtarëve të gjykatave komunale. Gjykatat komunale në Mitrovicë dhe Prizren kanë përjetuar uljen më drastike të numrit të gjyqtarëve (47%, respektivisht 38%). *Lexo Shqyrtimin e OSBE-së për Gjykatat Komunale, f. 10.* Gjykata e Qarkut në Prizren kishte 17 gjyqtarë përderisa sot kjo gjykatë ka vetëm tetë.

Në raportin e përgatitur sipas kërkesës së PSSP-së, nga Këshilli i Europës (KE) dhe Zyra Amerikane në Prishtinë, është konkluduar se nuk ka ndonjë metodë të saktë për analizën dhe përcaktimin e numrit të duhur të gjyqtarëve për administrimin efektiv të gjyqësisë në Kosovë. Mungesa e një formule të tillë ka rezultuar që, në shumicën e gjykatave të ketë numër të vogël të gjyqtarëve, ndërsa në tjerat të ketë numër të tepërt. Bazuar në analizën e normës së tanishme të punës nëpër gjykata, pastaj numrin e lëndëve të kryera dhe disa faktorë tjerë, ky raport i ka identifikuar disa metoda për vlerësimin e numrit të pozitave për gjyqtarë për secilën gjykatë. Përveç kësaj, është rekomanduar që në rastet e gjykatave me më tepër punëtorë, KGJPK-ja do

të duhej ose ta zvogëlojë numrin e gjyqtarëve ose t'i transferojë ata në gjykatat tjera ose që disa gjykata komunale t'i konsolidojë në një të tillë. Në rastet e gjykatave me numër të pamjaftueshëm, është rekomanduar që KGJPK-ja, ose duhet ta rrisë numrin e gjyqtarëve ose ta ndajë gjykatën në nëndegë dhe t'i shpërndajë ato në lokacione tjera dhe për ato nëndegë të angazhojë numër plotësues me gjyqtarë. *Lexo KE/DD, Vlerësimi i Ssistemit Gjyqësor të Kosovës, f. 266.*

Numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve në Kosovë, është shkaku kryesor për zvarritjet e konsiderueshme për kryerjen e lëndëve dhe rritjen e numrit të madh të lëndëve të pakryera.

NORMA E PUNËS E GJYKATAVE KOMUNALE TË KOSOVËS

| | 2002* | 2003 |
|--|---------|---------|
| Gjithsejt numri i lëndëve të pakryera | 190.083 | 249.695 |
| Të grumbulluara: numri i lëndëve të pakryera nga vitet e kaluara | 33.538 | 61.713 |
| Numri i lëndëve të paraqitura | 156.545 | 187.982 |
| Numri i lëndëve të kryera | 127.913 | 167.795 |
| Efikasiteti: shkalla e lëndëve të kryera | | |
| Gjithsejt rasteve të pakryera | 67.2 | 68.9 |
| Lëndët e paraqitura | 81.7 | 89.3 |

Nxjerrë nga: Shqyrtimi i Gjykatave Komunale OSBE, aneksi 2 tabelat 2-3.

Rrjedhimisht, gjykatat i zgjidhin më pak lëndë se sa që i pranojnë, duke rezultuar kështu me rritjen e numrit të lëndëve të grumbulluara. Siç mund të llogaritet, bazuar në tabelën e mësipërme, numri i lëndëve të grumbulluara në fillim të vitit 2004 ka arritur në 81.900 lëndë, 2.5 herë më shumë se sa në vitin 2002. Veç kësaj, gjykatat me numrin më të madh të lëndëve të grumbulluara, duket se janë ato që e kanë shkallën më të ulët të efikasitetit. Nga kjo, Gjykata Komunale e Prishtinës, në vitin 2003 i ka pasur 44.459 të lëndëve të pakryera (përfshirë 32.055 të paraqitura po atë vit); i ka zgjidhur vetëm 58% të gjithsejt numrit të lëndëve (rreth 80% prej të cilave të paraqitura po atë vit). *Lexo id. aneksin 2 tabelën 2.* Për dallim nga kjo, tetë gjykata me krahasimisht numër më të vogël të lëndëve (p.sh., Gjykata Komunale e Dragashit) i kishte zgjidhur 98% ose më shumë se numrin e përgjithshëm të lëndëve që u ishin paraqitur gjatë vitit 2003 (edhe pse disa lëndë, prap se prapë, ishin bartur në vitin 2004). *Id.* Gjykatat e instancave më të larta duket se kanë shkallë edhe më të vogël të efikasitetit nga aspekti i zgjidhjes së lëndëve. Prandaj, në vitin 2002, gjykatat e qarkut i kishin përfunduar rreth 59% të numrit të përgjithshëm të lëndëve (74% të lëndëve të paraqitura po atë vit), përderisa Gjykata Supreme i ka përmbyllur 61% të numrit të përgjithshëm të rasteve të pazgjidhura (73% të rasteve të paraqitura atë vit). *Lexo KE/DD, Vlerësimi i Sistemit Gjyqësor të Kosovës, f. 30, 31.*

Shumica e të anketuarve theksuan se nevojiten më shumë gjyqtarë për të adresuar problemin e numrit të madh të lëndëve dhe gjyqësia ka kërkuar nga DD-ja që ta rrisë numrin e gjyqtarëve, por pa sukses. Të anketuarit u ankuan se konkurset e tejzgjatura për pozitat e gjyqtarëve profesionistë dhe atyre porotë, që ndonjëherë zgjasin më shumë se dy vjet, kanë ashpërsuar edhe më shumë problemin e normës së madhe të punës. Shpesh seancat gjyqësore shtyhen dhe rastet e ndryshme vonohen për shkak se nuk ka mjaft gjyqtarë porotë. Për më tepër, të anketuarit kanë vërejtur se nuk ekziston numri i mjaftueshëm i gjyqtarëve profesionistë, për ta realizuar mandatin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, neni 40(2), me të cilin parashihen gjyqtarë të ndryshëm për fazat e ndryshme të procedurës.

Në bazë të të anketuarve, barra e lindur nga numri i madh i lëndëve mund të zbutet me angazhimin e gjyqtarëve shtesë dhe shpërndarjen e gjyqtarëve të tanishëm. Në disa vende, gjyqtarët janë të stërngarkuar me lëndë, siç është rasti i një gjyqtari nga Prizreni i ngarkuar me 2000 lëndë civile, përderisa në vendet tjera, siç u cek nga një i anketuar, "jemi duke i pritur lëndët." Sipas OSBE-së, se në vitin 2003 "shtatë gjykata (komunale) i kishin pranuar rreth 300

lëndë për një gjyqtar; përderisa minimumi tjetër është që shtatë gjykatat kishin pranuar më pak se rreth 150 lëndë për një gjyqtar.” Norma individuale për një gjyqtarë ishte mesatarisht 265.4 lëndë dhe sillej prej 62.8 në Gjykatën Komunale të Dragashit, deri në 427.1 në Gjykatën Komunale të Prizrenit, dhe prej 1.063 në Gjykatën Komunale të Kaçanikut me vetëm një gjyqtar¹¹. Lexo, OSBE, *Shqyrtimi i Gjykatave Komunale*, f11 & Aneksin 5 Tabela 9. Mospërputhje të ngjajshme mund të vërehen edhe në normën e lëndëve për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje. Përderisa shumica e gjykatave e kishin normën prej 800-1.600 lëndë për një gjyqtar, Gjykata për Kundërvajtje e Dragashit e kishte normën 418, ndërsa ajo e Gjilanit shkonte në 3.316 lëndë për një gjyqtar. Lexo KE/DD, *Vlerësimi i Sistemit Gjyqësor të Kosovës*, f. 29. Shpërndarja e normës për një gjyqtar është më pak e shpërputhur në shkallën e gjykatave të qarkut, duke u sillur prej 210 lëndëve për Gjykatën e Qarkut të Gjilanit, në vitin 2002, e deri në 235 lëndë për gjyqtar në Mitrovicë, 338 lëndë në Prizren, 340 lëndë në Prishtinë dhe 384 lëndë për Gjykatën e Qarkut të Pejës. *Id.* f. 30. Rishpërndarja e gjyqtarëve mund të rezultojë në një normë më të realizueshme të punës. Disa të anketuar potencuan se metodat joefikase të punës së gjyqtarëve janë një faktor kontribues për rritjen e stërngarkesës me lëndë.

Pas raportit të përgatitur nga Këshilli i Europës dhe Zyra e SHBA-ve në Prishtinë, disa nga hartuesit e raportit janë duke punuar në projektin për përcaktimin dhe azhurimin e numrave të nevojshëm për gjyqtarë për secilën gjykatë. Më tej, DD-ja ka filluar t’i plotësojë pozitat e lira për gjyqtarë porotë me betimin e organizuar në tetor 2004, për 169 porotë të rinjë, 78 prej të cilëve do të angazhohen në gjykatat komunale dhe 91 në gjykatat e qarkut, duke e rrumbullaksuar numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve porotë në 543 syresh për gjykatat e Kosovës. Lexo Komunikatën për Shtyp të UNMIK-ut nr. 1238, *para PSSP-së e japin betimin 169 Gjyqtarë Porotë për Gjykatat e Kosovës* (6 tetor 2004).

Faktori 28: Sistemi i Regjistrimit dhe Evidentimit të Lëndëve

Sistemi gjyqësor mirëmban një sistem të regjistrimit dhe evidentimit të lëndëve që siguron që lëndët dëgjohen në mënyrë efikase.

| Përfundim | Korrelacioni: Neutral | Trendi: ↔ |
|--|------------------------------|------------------|
| Sistemi i regjistrimit dhe evidentimit të lëndëve realizohet në mënyrë manuale. Procesi i hapësirë edhe për palët dhe personat tjerë që kanë interes për lëndën, që ta përcaktojnë renditjen e lëndëve që duhet të dëgjohen. | | |

Analiza/Sfondi:

Regjistrimi dhe evidentimi i lëndëve realizohet në mënyrë manuale. Zyra administrative në secilën gjykatë është pranues i shkresave të lëndës edhe pse shkresat e lëndës qëndrojnë në zyrën e gjyqtarit gjatë procedurës. Sa herë që dosja e lëndës merret jashtë zyrës administrative, duhet të shënohet në regjistër vendi, por shënimi i tillë në regjistër nuk është i nevojshëm për lëvizjen e lëndës brenda zyrës (p.sh., për fotokopjim). Lexo RREGULLAT E BRENDSHME TË GJYKATËS nenet 243, 252. Pasi që kryetari i trupit gjykues t’ia caktojë lëndën gjykatësit, lënda pastaj shkon te referenti i cili i’a cakton një numër lëndës për të përcaktuar renditjen në bazë të së cilës rastet

¹¹ Këto shënime statistikore mbulojnë vetëm të ashtuquajturat “lëndë komplekse” ku hynë hetimet, veprat penale, lëndet me të mitur, lëndët civile, trashëgimitë dhe lëndët në procedurë jokonstestimore. Bazuar në numrin e përgjithshëm të lëndëve në listën e gjykatave, në vitin 2002 gjashtë gjykata komunale i kanë pranuar më pak se 800 lëndë për një gjyqtar, përderisa katër gjykata komunale i kanë pranuar më shumë se 2000 lëndë për një gjyqtar; norma për një gjyqtar individual sillej prej 475 në Gjykatën komunale të Dragashit, deri në 3902 në atë të Kaçanikut. Lexo KE/DD, *Vlerësimi i Sistemit Gjyqësor të Kosovës* f. 30.

do të dëgjohen. Procesi i caktimit të lëndëve tek referenti bëhet me diskrecion të kryetarit të gjykatës, mirëpo rasteve zakonisht i'u caktohen numrat në mënyrë kronologjike sipas kohës së pranimit të tyre. Lëndët mbahen në dosje sipas numrave të caktuar për ato lëndë dhe dokumentet në secilën dosje regjistrohen me kode për të caktuar kategorinë e secilit dokument. Nganjëherë, shkresat e lëndës mund të vendosen gabimisht. Për më tepër, procesi manual i caktimit të gjyqtarëve dhe numrave për lëndët përkatëse i'u lejon palëve dhe të tjerëve që të ndikojnë në mënyrë jo të duhur dhe ndërhyjnë në punën e personelit gjyqësor të përfshirë në një rast.

Departamenti i Administratës Gjyqësore dhe Agjensioni Europian për Rindërtim, janë duke bashkëpunuar në një projekt të ndërtimit të një Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve, të një baze të sofistikuar të shënimeve moderne për evidentimin e lëndëve, për kryerjen e regjistrimit të lëndëve, përcjelljen, renditjen kalendarike dhe që do të ketë funksione të gjenerimit (prodhimit) të dokumenteve. Pilot-projekti trefazësh, përqëndrohet në përmirësimin e menaxhimit të lëndëve duke implementuar një softver për evidentimin e lëndëve. Duhet cekur se projekti ka ngecur pak për shkak të nxjerrjes të Kodit të ri të Përkohshëm Penal dhe atij të Procedurës Penale Softveri i dizajnuar paraprakisht për evidentim, është duke i'u nënshtruar revidimeve për të inkorporuar ndryshimet procedurale dhe terminologjike që kanë lindur si rrjedhojë e kodeve të përkohshme. Faza e parë kufizohet në evidentimin e lëndëve penale në disa nga gjykatat e qarkut. Në fazën e dytë, projekti do të zgjerohet për të përfshirë të gjitha gjykatat e qarkut dhe në fazën përfundimtare projekti do të zgjerohet në të gjitha gjykatat si dhe do të përfshijë si lëndët penale ashtu edhe ato civile. Qëllimi i projektit është të përmirësohet përgjegjshmëria dhe konfidencialiteti, përderisa në të njëjtën kohë të zvogëlohet puna me dokumente. Qasja në bazën e shënimeve do të jetë e rezervuar për gjyqtarët dhe stafin gjyqësor relevant.

Faktori 29: Kompjuterët dhe Pajisjet për Zyrë

Sistemi gjyqësor vepron me një numër të mjaftueshëm të kompjuterëve dhe pajisjeve tjera për të mundësuar që norma e punës të realizohet në mënyrë efikase.

| Përfundim | Korrelacioni: Neutral | Trendi: ↔ |
|--|------------------------------|------------------|
| Gjyqësia posedon një numër të mjaftueshëm të kompjuterëve dhe pajisjeve për zyrë mirëpo asaj i mungon njohuria për përdorimin efektiv të tyre. | | |

Analiza/Sfondi:

Të anketuarit e kanë pranuar se ekziston qasje adekuate në kompjuterë dhe pajisje tjera. Megjithatë, ka pasur përgjigje thujse unanime se gjyqësisë i mungon njohuria në përdorimin e kompjuterëve, për diçka më shumë se vetëm procesimi elementar me ëord, ndërsa disa gjyqtarëve tjerë i'u mungojnë madje edhe ato shkathtësi minimale. Ngashëm, shumë anëtarëve të stafit të gjykatës i'u mungojnë shkathtësitë kompjuterike dhe për shkak të kësaj, nuk janë në gjendje t'i'u ndihmojnë gjyqtarëve.

Në disa gjykata, të anketuarit deklaruan se kompjuterët janë të vjetër dhe të prishur. Në një rast, pajisjet ishin dëmtuar si rezultat i defekteve strukturore në gjykatore, siç është pikja ujit nga pullazi dhe instalimet e dobëta të rrymës.

Në shumë gjykatore, Departamenti i Administratës Gjyqësore e ka përgatitur infrastrukturën e nevojshme për lidhje të internetit, mirëpo pashpjegueshëm ende nuk është duke funksionuar. Trajnimi i posaçëm i gjyqësisë mbi hulumtimet nëpërmjet internetit, kyçjen në internet, do të ndihmonte në gjetjen e rregulloreve të UNMIK-ut dhe ligjeve tjera.

Faktori 30: Shpërndarja dhe Përmbledhja (Katalogimi) e Ligjeve të Tanishme

Sistemi ekziston në bazë të të cilit, të gjithë gjyqtarët i pranojnë ligjet e tanishme dhe jurisprudencën vendore me kohë, dhe ekziston një sistem i pranuar kombëtar për identifikimin dhe organizimin e ndryshimeve në ligj.

| Përfundim | Korrelacioni: Neutral | Trendi: ↑ |
|---|-----------------------|-----------|
| Ekziston një sistem i kufizuar për shpërndarjen e ligjeve mirëpo gjyqtarët nuk i pranojnë ligjet me kohë dhe nuk ekziston ndonjë sistem i pranuar kombëtar për identifikimin dhe organizimin e ndryshimeve në ligj. | | |

Analiza/Sfondi:

Sistemi ekzistues për shpërndarjen e ligjeve nëpër gjykata ka defekte dhe gjyqtarët ankohen se ligjet shpeshherë pranohen me vonesë. Megjithatë, të anketuarit u pajtuan në mënyrë unanime se shpërndarja e ligjeve nëpër gjykata është përmirësuar dukshëm që nga viti 2002.

Sistemi i tanishëm i shpërndarjes funksionon si në vijim. DD-ja i dërgon rregulloret e reja të UNMIK-ut kryetarëve të gjykatave të cilët mëpastaj janë të obliguar të bëjnë kopje të tyre dhe t'ua shpërndajnë ato gjyqtarëve. Rregulloret e UNMIK-ut gjithashtu botohen në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në Gazetën Zyrtare të UNMIK-ut dhe vonohet për disa muaj para publikimit dhe pranimi të tyre nga gjykata, si dhe publikohen në faqen e internetit të UNMIK-ut (<http://www.unmikonline.org/regulations/index.htm>), gjë që bëhet shumë më shpejtë por prapë se prapë, përkthimet vonohen. Rregulloret publikohen sipas renditjes kronologjike, por nuk ka sistem të kodifikimit ose të përmbledhjeve të ligjeve bazuar në temat që i mbulojnë. Jashtë kësaj, DAGJ-ja secilës gjykatë në veçanti ua ka shpërndarë kopjet e Kodeve të reja të Përkohshme Penale. Për momentin, nuk ekziston ndonjë zyrë përgjegjëse për publikimin dhe shpërndarjen e ligjeve të Kuvendit të Kosovës dhe Akteve Nënligjore, megjithëse faqja e internetit e Gazetës Zyrtare të UNMIK-ut ka filluar t'i vendosë disa nga këto ligje në faqen e internetit. Në proces e sipër është hartimi i një Ligji për Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe për themelimin e një zyre e cila do të jetë përgjegjëse për publikimin e ligjeve të kuvendit.

Nisma e ABA/CEELI-it ka shpër në hartimin, publikimin dhe shpërndarjen, për komunitetin ligjor, të indeksit të dokumenteve ligjore të KB-së që janë në fuqi në Kosovë. Ky indeks do të mund të përdorej për të gjetur më lehtë ndryshimet në rregulloret dhe urdhëresat administrative të UNMIK-ut dhe për të identifikuar aktet e tilla në bazë të temës. Ky indeks është botuar në baza tremujorshe që nga viti 2002. Veç kësaj, CD-ROM-i, i publikuar nga ABA/CEELI është gjithashtu në dispozicion dhe i cili përmban indeksin themelor të të gjitha ligjeve në fuqi në Kosovë, me sistemin "link", i cili e ndërlidhë tekstin me ligjet përkatëse.

Gjyqtarët gjithashtu pranojnë ligjet dhe materialet tjera ligjore gjatë pjesëmarrjes pjesë në seminarët dhe trajnimet e ndryshme. Për shembull, kursi fillestar i Institutit Gjyqësor të Kosovës, për gjyqtarët e sapo emëruar ofron materiale informative ku përfshihen rregulloret e UNMIK-ut, tekstet e ligjeve penale në fuqi, standardet dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe tekste bazë për të drejtat pronësore dhe banesore. Lexo Raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës: 1999-2004, f. 2 (shtator 2004).

Për shkak se gjuha angleze është gjuhë zyrtare për aktet ligjore të UNMIK-ut, atëherë verzioni në gjuhën angleze mbizotëron. Gjithsesi, kjo nuk është aq e dobishme për ata gjyqtarë të cilët nuk janë në gjendje ta kuptojnë gjuhën angleze. Sido që të jetë, cilësia e përkthimit në gjuhën shqipe dhe serbe mbetet ende problem. Në shkurt të vitit 2004, dy rregullore të UNMIK-ut është dashur të publikohen sërish, për shkak të revidimeve të përkthimeve paraprake.

Si pjesë e përpjekjeve për të përmirësuar punën e gjykatave, Qendra Nacionale për Gjykatat Shtetërore duke punuar së bashku me palët tjera të interesuara, përfshirë këtu ABA/CEELI-n, për të ndërtuar një program të shtypjes së akteve ligjore për t'i ofruar komunitetit ligjor të gjitha burimet e ligjit në fuqi në Kosovë. Lexo Faktorin 24 për informata plotësuese lidhur me këtë projekt. Krahas kësaj, janë zhvilluar dy faqe të internetit për përmirësimin e qasjes në lëndë. Faqja e parë është "KSLEX", një faqe e orientuar kah gjyqësori i Kosovës, e cila do të përfshinte të gjitha ligjet në fuqi, precedentin gjyqësor dhe standardet për të drejtat e njeriut. Edhe Kabineti i Kryeministrit është duke e zhvilluar faqen e orientuar kah zyrtarët publik, e cila do të përfshinte materiale të ngjashme. Pritjet janë se të dyja faqet e internetit do të ofrojnë qasje për publikun dhe për një numër të madh të burimeve juridike. Megjithatë, nga këndi më pak optimist, publikimet elektronike tani për tani janë të padobishme kur është fjala te gjyqësia. Ndërtesat e gjykatave nuk janë të pajisura me lidhje të internetit, edhe pse një numër syresh e kanë të gatshëm rrjetin, dhe vetëm nevojitet të aktivizohet interneti. Pavarësisht nga kjo, vetëm një numër i vogël i gjyqtarëve posedon me shkathtësitë e nevojshme kompjuterike për shfrytëzimin e veglave për hulumtim ligjor online (të kyçur), pasi të bëhet i mundur.